



**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK ME OBJEKT
“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E
VITIT 2023 (Gjashtë mujori i parë)”**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK
“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET
E VITIT 2023 (Gjashtë mujori i parë)”**

PRILL 2024

Përmbajtja

faqe

PËRMBLEDHJE.....	3
I/1 HYRJA	4
I/2. OBJEKTI AUDITIMIT	4
I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:.....	4
I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT	4
I/5. KONKLZIONI:	4
II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.	5
1. AUDITIM I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE NË SUBJEKTIN SHOQËRINË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A	5
2. AUDITIM I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE NË SUBJEKTIN AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR	23
3. AUDITIM I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE NË SUBJEKTIN AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR PËR PROJEKTIN “MIRËMBAJTJE DHE SIGURI RRUGORE BAZUAR NË REZULTATE”.....	51
4. AUDITIM I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE NË SUBJEKTIN UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A	64
5. AUDITIM I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE NË SUBJEKTIN PORTI DETAR SARANDË SH.A ..	102
III. KONKLIZIONE DHE REKOMANDIME.....	116
ANEKSE.....	121

PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim me objekt “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023 (Gjashtë mujori i parë)*”, në subjektet: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime SHA, Durrës; Autoriteti Rrugor Sqiptar dhe Drejtoritë Rajonale; Shoqëria Ujësjellës Kanalizime SHA Tiranë; Shoqëria Porti Detar SHA Sarandë.

Cështjet kryesore që janë trajtuar gjatë auditimit janë verifikimi i hartimit nga subjekti të programeve (plan veprimeve), vlerësimi i ecurisë dhe i nivelit të zbatimit të rekomandimeve, përcaktimi i statusit të tyre, rikërkimi për zbatim i rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshejtimi i punës për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi. Gjithashtu është trajtuar nxjerrja nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

- a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
- b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
- c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e për të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, për 4 subjekte të audituara, rezulton se:

a. Janë rekomanduar 102 masa organizative nga të cilat janë pranuar 102 masa ose në masën 100%.

Statusi i zbatimit:

31 masa janë zbatuar plotësisht ose në masën 30%;

60 masa janë në proces zbatimi ose në masën 58.8%;

5 masa janë zbatuar pjesërisht ose në masën 4.9%;

6 masa nuk janë zbatuar ose në masën 5.9% të masave të rekomanduara.

b. Janë rekomanduar 18 masa për shpërblim dëmi, prej të cilave 16 në vlerën 80,007 mijë lekë dhe 2 me vlerën 68,960 euro, nga të cilat janë pranuar 17 masa ose në masën 95.5% dhe nuk është pranuar 1 prej tyre në vlerën 10,490 mijë lekë, ose 4.5% e masave të rekomanduara si numër (ose 7% e vlerës së rekomanduar);

Statusi i zbatimit:

7 masa të zbatuara në vlerën 4,603 mijë lekë ose në masën 41.2%;

1 masë është në proces zbatimi në vlerën 405 mijë lekë ose në masën 5.9%;

1 masa është zbatuar pjesërisht në vlerën 1,545 mijë lekë ose në masën 5.9%;

6 masa të pa zbatuara në vlerën 62,294 mijë lekë dhe 2 me vlerën 68,960 Euro ose 47%;

c. Janë rekomanduar 20 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencës dhe efektivitetit nga këto 18 në shumën 530,477 mijë lekë dhe 2 në shumën 783,875 Euro, nga të cilat janë pranuar 20 masa ose 100%.

Statusi i zbatimit:

6 masa të zbatuara në vlerën 414,228.6 mijë lekë ose në masën 30%;

14 masa në proces zbatimi ku nga të cilat 12 masa në vlerën 23,781 mijë lekë dhe 2 masa në vlerën 783,875 Euro ose në masën 70%;

d. Janë rekomanduar 14 masa disiplinore të cilat janë pranuar 14 masa, ose 100%.

Statusi i zbatimit: 13 masa të zbatuara ose në masën 92.8%, 1 masë e pa zbatuara ose në masën 7.2% të masave të rekomanduara.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, si dhe manualit “*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve*”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 1047/1, prot., datë 29.12.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. S. H. (*Përgjegjës grupi*)
2. E. K.
3. E. S.
4. J. M.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresat përkatëse së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit të trajtuara përgjatë materialit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

a. Janë rekomanduar 102 masa organizative nga të cilat janë pranuar 102 masa ose 100%, statusi i zbatimit të tyre është: 31 masa janë zbatuar plotësisht ose 30%, 60 masa janë në proces zbatimi ose 58.8%, 5 masa janë zbatuar pjesërisht ose 4.9% dhe 6 masa nuk janë zbatuar ose 5.9%;

b. Janë rekomanduar 18 masa për shpërblim dëmi, 16 në vlerën 80,007 mijë lekë dhe 2 me vlerën 68,960 Euro nga të cilat janë pranuar 17 masa ose 95.5% dhe nuk është pranuar 1 prej tyre në vlerë 10,490 mijë lekë ose 4.5%; statusi i zbatimit të tyre është 7 masa të zbatuara në vlerën 4,603 mijë lekë ose 41.2%, 1 masë është në proces zbatimi në vlerën 405 mijë lekë ose 5.9%, 1 masa është zbatuar pjesërisht në vlerën 1,545 mijë lekë ose 5.9% dhe 6 masa të pa zbatuara në vlerën 62,294 mijë lekë dhe 2 me vlerën 68,960 Euro ose 47%;

c. Janë rekomanduar 20 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitetit nga këto 18 në shumën 530,477 mijë lekë dhe 2 në shumën 783,875 Euro, nga të cilat janë pranuar 20 masa ose 100%, statusi i zbatimit të tyre është 6 masa të zbatuara në vlerën 414,228 mijë lekë ose 30%, 14 masa në proces ku nga këto 12 masa në vlerën 23,781 mijë lekë dhe 2 masa në vlerën 783,875 Euro ose 70%;

d. Janë rekomanduar 14 masa disiplinore të cilat janë pranuar 14 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 13 masa të zbatuara ose 92.8%, 0 masa në proces ose 0% dhe 1 masë e pa zbatuara ose 7.2%.

II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.

1. AUDITIM I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE NË SUBJEKTIN SHOQËRINË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në subjektin **Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime SHA, Durrës Sh.A** me objekt “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023*” për auditimin e kryer në vitin 2023, për periudhën objekt auditimi 01.04.2018 – 31.10.2022, të përcjella nga KLSH me shkresën Nr.825/15 Prot. datë 03.05.2023.

Çështjet kryesore që janë trajtuar gjatë auditimit janë verifikimi i hartimit nga subjekti të programeve (plan veprimeve), vlerësimi i ecurisë dhe i nivelit të zbatimit të rekomandimeve, përcaktimi i statusit të tyre, rikërkimi për zbatim i rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimi i punës për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi. Gjithashtu është trajtuar nxjerrja nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

- a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
- b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
- c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e për të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjekt u mbajt Akt Verifikimi nr. 1, datë 31.01.2024, administruar në Shoqëria Rajonal Ujësjiellës Kanalizime Durrës me nr. 32/1 prot. datë 31.01.2024, për të cilin nuk është paraqitur observacion nga ana e subjektit. Pas dërgimit të Projektraportit të Auditimit, nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observacione.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, UK Durrës SHA ka respektuar këtë afat duke kthyer përgjigje sipas shkresës së administruar në institucion me Nr.184/74 Prot. datë 23.05.2023.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr.825/15 Prot. datë 03.05.2023, janë rekomanduar gjithsej:

- a. 10 masa organizative;
- b. 3 masa për shpërblim dëmi në vlerën 790,655 lekë;
- c. 4 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe përmirësimin me ekonomikitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike, në shumën 30,789,449 lekë;

d. 11 masa disiplinore.

IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr.447/13Prot. datë 03.05.2023, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar (nga UK Durrës)	Pa pranuar
1	Organizative	10 masa	10 masa	-
2	Shpërblim dëmi	3 masa 790,655 lekë	3 masa 790,655 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	4 masa 30,789,449 lekë	4 masa 30,789,449 lekë	-
4	Masa Disiplinore	11	11	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	10 masa	1	3	3	3
2	Shpërblim dëmi	3 masa 790,655 lekë	2 masa 385,755 lekë	-	1 masë 404,900 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	4 masa 30,789,449 lekë	3 masa 29,389,649 lekë	-	1 masë 1,339,800 lekë	-
4	Masa Disiplinore	11	11	-	-	-

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 1047/1 Prot. datë 29.12.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. S. H. (Përgjegjës grupi)
2. E. K.
3. E. S.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr.825/15 Prot. datë 03.05.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Ujësjetës Kanalizime SHA, Durrës, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr.825/15Prot. datë 03.05.2023, rezulton se nga **28** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi dhe 3-E, Disiplinore*), janë pranuar nga subjekti **28** masa ose në masën 100 %. **Nga të pranuarat (28):** janë zbatuar plotësisht **17**, ose 61 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht **3** masë ose 11 % e tyre, janë në proces zbatimi **5** masa ose 18 % dhe nuk janë zbatuar **3** masa ose 10 % tyre.

Nga sa shikohet niveli i realizimit është sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	10 masa	1	3	3	3
2	Shpërblim dëmi	3 masa 790,655 lekë	2 masa 385,755 lekë		1 masë 404.900 lekë	
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	4 masa 30,789,449 lekë	3 masa 29,389,649 lekë		1 masë 1,339,800 lekë	
4	Masa Disiplinore	11	11			
5	Gjithsej	28 masa 31,580,104 lekë	17	3	5	3

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit plotësisht të rekomandimeve është në masën 61%, nivele këto të cila tregojnë vlerësimin jo si duhet të këtij procesi si dhe domosdoshmërinë që ka ndjekja e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, përfundimi i atyre në proces si dhe nisja e hapave të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, UK Durrës SHA, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën Nr.184/74 Prot, datë 23.05.2023 por nuk ka plotësuar kërkesën për hartimin e planit të veprimit, të parashikuar në nenin 15, shkronja (j) të Ligjit Nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

III/3. *Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i mëparshëm në Ujësjetllës Kanalizime Durrës SHA, nuk është respektuar afati ligjor prej 6 muajsh nga data e njoftimit të Raportit të Auditimit, në lidhje me raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

1.1 Rekomandimi: Shoqëria të marrë masa për njoftimin e KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, me qëllim përmirësimin e funksionimit të shoqërisë.

Në vijimësi

Komenti i Subjektit: Masat organizative 1.1 dhe 2.1 tashmë nuk mund të merren më nga ish UKD sh.a pasi nuk ekziston më si shoqëri. *Ndaj mendojmë se këto rekomandime quhen të zbatuara plotësisht.*

Qëndrimi i audituesve: Në zbatim të VKM Nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikën kombëtare për riorganizimin sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” ish shoqëria UKD SHA, nga operacioni i bashkimit me ish-shoqëritë UK Krujë, UK Rrogozhinë dhe UK Kavajë, nga data 01.01.2023 funksionon si Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.a (SHRUKD).

Operacioni i bashkimit përmban detyrimisht transferimin e përgjithshëm të pasurisë, që janë aktivet dhe detyrimet të shoqërisë së përthithur tek shoqëria përthithëse, apo tek shoqëria e re e dalë nga bashkimi.

Në operacionet e bashkimit, ndarjes, etj., në fushën e së drejtës të shoqërive tregtare kuadri ligjor dhe rregullator synon jo vetëm realizimin e operacioneve të ristrukturimit të shoqërive tregtare, por edhe ruajtjen e sigurisë juridike të këtyre operacioneve.

Rrjedhojat juridike të këtyre operacioneve, si transferimi i pasurisë, prishja e shoqërive, kontributet, raportet e shkëmbimit të aksioneve, marrëdhëniet e punës, etj., të cilat janë të garantuara nga kuadri ligjor në fuqi, nuk kanë lidhje me KLSH.

Veprimtaria e shoqërisë së dalë nga ristrukturimi (bashkimi), ka vazhduar normalisht me të njëjtin objekt veprimtarie, me të njëjtën seli, dhe me të njëjtin grup të menaxhimit të lartë.

Për sa më sipër, me anë të shkresës me nr.184/77 Prot, datë 13.12.2023 është dërguar nga ana e shoqërisë SHRUKD ecuria e zbatimit të rekomandimeve për masat e marra për rekomandimet “masa për shpërblim dëmi”.

Por, nga ana tjetër, nuk është zbatuar afati i parashikuar në pikën 2, neni 30, të Ligjit Nr.154/2014 datë 27.11.2014. Informacioni është dhënë 39 ditë përtej afatit 6 mujor nga data e njoftimit të raportit përfundimtar të auditimit nr.825/15, datë 04.05.2023.

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet ***i zbatuar pjesërisht***.

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Ujësjetllës Kanalizime Durrës SHA administruar në KLSH me nr.520/56 Prot., datë 04.12.2020, janë rekomanduar gjithsej:

-12 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 8 masa, në proces zbatimi 3 masa dhe të pa zbatuara 1 masë;

-12 masa shpërblim dëmi, nga të cilat janë zbatuar 5 masa, si edhe 7 masa janë në proces zbatimi.

- 9 masa për eliminimin e efekteve negative, nga të cilat janë në proces zbatimi 9 masa.
- 3 masa për procedura të realizuara në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, nga të cilat janë në proces zbatimi 3 masa.
- 19 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 19 masa

2.1 Rekomandimi: UK Durrës SHA, të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, me synim realizimin e objektivave dhe në përmbushjen e misionit të shoqërisë.

Menjëherë

Komenti i Subjektit: Masat janë në zbatim, në vijimësi, për sa kohë proceset gjyqësore ndaj subjekteve vazhdojnë.

Qëndrimi i audituesve: Nga auditimi është konstatuar se nga 55 masa të dhëna gjithsej, janë në proces zbatimi 6 masa organizative, 7 masa shpërblim dëmi, 9 masa për eliminimin e efekteve negative. Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet ***në proces zbatimi***.

3. Gjetje nga Auditimi: Rritja e ujit pa të ardhura tregon se, një pjesë e madhe e “klientëve”, që zyrtarisht nuk janë të tillë dhe që realisht marrin ujë nga sistemi nuk faturohen dhe nuk e paguajnë atë. Shoqëria UK Durrës SHA, për periudhën objekt auditimi, është karakterizuar nga një paqëndrueshmëri e lartë financiare. Rritja vjetore e të ardhurave (faturimi total), krahasuar me një vit më parë, rezulton përkatësisht 2.3 % në vitin 2019, -0.4 % në vitin 2020, dhe 6.5 % në vitin 2021. Norma e arkëtimit është llogaritur sipas kategorisë së arkëtimit korrent dhe të prapambetur. Gjithashtu, e para ka një ulje nga 79.8 % në vitin 2018 në 54 % në vitin 2021, dhe arkëtimi i prapambetur është rritur nga 17 % në vitin 2018 në 37 % në vitin 2021.

Realizimi i shpenzimeve dhe investimeve është i paqëndrueshëm, përkatësisht 37% në vitin 2018, 55% në vitin 2019, 39 % në vitin 2020 dhe 156 % në vitin 2021.

Kjo ndodh për arsye se, parashikimet e investimeve apo nevojat për shpenzime kryhen pa studime konkrete dhe analiza të plota me bazë rrisht.

Diferenca ndërmjet kostos së shitjes dhe kostos së prodhimit përbën koston shtesë joefektive në vlerën prej -118.46 leke/ m³, nga ku 20 % e saj ose 24 leke/ m³, përbën humbjen teknike të pranuar. Për sa më sipër, kjo situatë vjen kryesisht nga që shoqëria nuk ka organizuar dhe planifikuar mjaftueshëm burimet e saj, duke lejuar një rritje të papranueshme të ujit pa të ardhura.

Planifikimi për buxhetin e shoqërisë është kryer mbi bazën e nevojave të krahasuara me një vit më parë, mbi bazën e kërkesave të veçuara, pa analiza të plota të rrisht dhe të pambështetura në prioritetet konkrete dhe politika të qarta komerciale.

Sa më sipër, shoqëria ka pësuar një humbje financiare, përkatësisht për vitin 2019 në vlerën - 201,045,754 lekë, për vitin 2020 në vlerën prej -216,213,668, për vitin 2021 në vlerën prej - 370,713,260 lekë, si edhe për 9/Mujorin e vitit 2022 në vlerën prej -498,412,304 lekë.

3.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë UK Durrës SHA, të marrë të gjitha masat për të ngritur një sistem eficient të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, krijimin e regjistrit të rrisht dhe funksionimin e grupit të menaxhimit strategjik.

Hartuesit e programit ekonomik-financiar duhet të mbështeten në analiza të plota me bazë rrisht si edhe të orientuar nga prioritetet të përcaktuara më parë, me qëllim evidentimin dhe korrigjimin e shkaqeve që ndikojnë në mosrealizimin e objektivave të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit: Për funksionimin e Grupit Menaxhimit Strategjik dhe krijimin e regjistrit të rrisht, ju informojmë se me Urdhër Nr. 52 prot, datë 02.03.2023 nga ana e Administratorit është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Sa i përket hartimit të strategjisë së riskut dhe regjistrit të riskut kjo do të bëhet e mundur në vijimësi sapo të përcaktohen objektivat për shoqërinë sipas riorganizimit që është bërë nga VKM Nr. 302 datë 11.05.2022. *Rekomandimi do të zbatohet në vijimësi.*

Qëndrimi i audituesve: Megjithëse është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me Urdhër Nr. 52 prot, datë 02.03.2023 të Administratorit, nga verifikimi rezulton si më poshtë:

- GMS nuk funksionon. Mungojnë vendimet kolegjiale, minuta takimi, etj të grupit (në kuptim të pikës 2.2.6 të Manualit të MFK, të miratuar me Urdhër Nr.108, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë).

- Regjistri i Riskut nuk është krijuar dhe kjo bie në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit Nr.10296 datë 08.07.2010, ndryshuar me Ligjin Nr.110/2015 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin;

- Koordinator i riskut nuk funksionon, apo nuk ka një delegim të tillë;

- Buxheti i shoqërisë edhe për vitin 2024 është hartuar pa analiza të plota të riskut;

Sa më sipër, sistemi i MFK vazhdon të jetë i implementuar në një nivel të ulët dhe nuk funksionon mjaftueshëm.

Audituesi, mbi bazën e shqyrtimit të dokumentacionit konkludon se brenda afatit të përcaktuar për secilin rekomandim, subjekti (ose struktura përkatëse brenda subjektit) nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimin sipas llojit (përmirësim ligjor, organizativ, shpërblim dëmi, administrativ, disiplinor etj.), por vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerësohet në mundësinë e realizimit. Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet *i pa zbatuar*.

4. Gjetje nga Auditimi: Në 8 raste copëzim fondesh, shoqëria nuk ka marrëparasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, të cilat zakonisht duhet të prokurohen menjëherë, me qëllim parandalimin e shmangies të procedurave konkurruese të prokurimeve.

Procedurat e prokurimit nuk janë planifikuar sipas natyrës, sasisë dhe llojeve të kontratave, që do të prokurohen.

Në vitin 2019 është kryer Shoqëria i ngjashëm riparim pjesë motorike dhe xhenerike të mjeteve dhe me të njëjtin operator ekonomik A.G.

Procedurat sipërcituara së bashku rezultojnë në vlerën 1,227,000 lekë, që tejkalojnë me 227,000 lekë pragon e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.

Në vitin 2021 është kryer Shoqëria i ngjashëm riparim pjesë motorike dhe xhenerike të mjeteve motorrike.

Procedurat e sipërcituara së bashku rezultojnë në vlerën 2,245,533 lekë, që tejkalojnë me 1,245,533 lekë pragon e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.

Në vitin 2022 janë kryer procedura të veçanta për shërbime të ngjashme, riparim pjesë motorike dhe xhenerike, që së bashku tejkalojnë me 976,199.87 lekë pragon e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.

Sa më sipër bie në kundërshtim me Nenin 56, pika 2, e Vendimit Nr.285 datë 19.05.2021, si edhe pikën 3 të Udhëzimit Nr.03, datë 08.01.2018.

4.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë ose personi i autorizuar dhe personi përgjegjës i prokurimeve, të marrin të gjitha masat që në hartimin e regjistrit të prokurimeve të parashikohen të gjitha procedurat e blerjes së mallrave, punëve dhe shërbimeve, që do të prokurohen në vlerë të vogël, me qëllim që të shmangë përdorimin e paplanifikuar dhe të parregulluar të fondeve publike.

Komenti i Subjektit: Janë marrë të gjitha masat që të mos tejkalojnë vlerat e parashikuara nga ligji për blerjet e vogla si dhe janë analizuar dhe përmirësuar të gjitha procedurat për parashikimin e prokurimeve me vlerë të vogël.

Drejtoria prokurimeve për implementimin dhe përmirësimin e proceseve gjatë zhvillimit të veprimtarisë, ka propozuar ndryshimin e Regjistrit të prokurimeve dhe është ngritur Urdhëri me Nr. 53, date 06.03.2023. *Rekomandimi quhet i zbatuar plotësisht.*

Qëndrimi i audituesve: Me Urdhër Nr.53, datë 06.03.2023 të Administratorit, janë caktuar personat përgjegjës për masat mbi parashikimin e prokurimeve publike, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve në prokurimet me vlerë të vogël.

Sa më sipër, në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për vitin 2024, nr.6350/5 prot, datë 26.12.2023, janë parashikuar marrëveshje kuadër me qëllim përfshirjen e disa procedurave të prokurimit në vlerë të vogël, të cilat përsëriteshin dhe bëheshin shkak për copëzimin e fondeve apo të kontratave.

Por, nga ana tjetër, prokurimet e vogla në regjistrin e sipërcituar të prokurimeve, me nr.17, në vlerën gjithsej prej 28,000,000 lekë, nuk janë të parashikuara të ndara, sipas natyrës dhe llojeve të mallrave, shërbimeve dhe punëve që do të prokurohen, dhe ky veprim bie në kundërshtim me pikën 2, nenin 56, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 RRPP, gjithashtu në kundërshtim me pikën 4 të Udhëzimit Nr.05., datë 25.06.2021 të APP.

Gjithashtu, prokurimet në vlerë të vogël+emergjencën janë realizuar mesatarisht në vlerën **19,251,879 lekë**, për periudhën 2018-9/mujorin e vitit 2022, ndërkohë që me përfshirjen në marrëveshjet kuadër e një pjese të procedurave në vlerë të vogël, për vitin 2024, mund të kishim një parashikim historik në një vlerë më të vogël se ajo e parashikuar, gjë e cila flet për një parashikim të pa studiuar.

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet ***i zbatuar pjesërisht.***

5. Gjetje nga Auditimi: Në 6 raste, nga dosjet e kontrolluara, operatorët ekonomikë fitues rezultojnë me 2 oferta të ndryshme për të njëjtën objekt prokurimi, njëra ofertë e paraqitur gjatë verifikimit në treg për vlerësimin e fondit limit, dhe tjetra në vlerë më të ulët, gjatë zhvillimit të procedurës elektronike të prokurimit:

Në vitin 2018_Procedura e prokurimit me objekt “*Riparim i pompës kineze H 250 m dhe Q 100 lit/s*” dhe procedura e prokurimit me objekt “*Shërbim riparim pompe centrifugale për stacionin Fushë Kuqe*”. Në vitin 2019_Procedura e prokurimit me objekt “*Furnizim vendosje materiale elektrike të tensionit të mesëm (TM) në Fushë Kuqe*” dhe Procedura e prokurimit me objekt “*Riparim Fadrome*” e mjetit me targë AA 125 AB modeli JCB 3CX. Në vitin 2021 Procedura e prokurimit me objekt “*Riparim mjeti Renault*” dhe procedura e prokurimit me objekt “*Blerje materiale për elektropompën zhytëse Sulzer 15*”.

Në zbatim të pikave 1 dhe 3 të Udhëzimit Nr.11 datë 30.05.2018, të Agjencisë Prokurimit Publik, komisioni i prokurimit ka detyrimin të krahasojë ofertat e operatorëve ekonomik me fondin limit të përcaktuar më parë nga autoriteti kontraktor, me qëllim që oferta e OE të jetë sa më reale.

Veprimet për sa më sipër, bien në kundërshtim me pikën 3 të nenit 63, të VKM Nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, dhe në kundërshtim me pikën 4, neni 79 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, dhe deformojnë konkurrencën.

5.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të analizojë situatën e krijuar dhe të përcaktojë shkallën e përgjegjësisë të personave përgjegjës.

Menjëherë

Komenti i Subjektit: Nga ana e komisioni të prokurimit në vlerë të vogël të SHRUKD SHA janë marrë masa nga janari 2023 që të bëhet verifikimi i ofertave të ngarkuara online me ato të administruara nga përllogaritja e fondit, në mënyrë që të mos ketë operatorë me 2 oferta të ndryshme. *Duke qenë se ndaj punonjëseve janë propozuar dhe janë marrë masa disiplinore në zbatim të raportit mendojmë se Rekomandimi quhet i zbatuar plotësisht.*

Qëndrimi i audituesve: Nga ana e Administratorit të shoqërisë është marrë masa disiplinore “tërheqje vëmendje” me anë të vendimeve nr.184/65 dhe nr.184/66, datë 11.05.2023 për personat përgjegjës.

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet ***i zbatuar plotësisht.***

6. Gjetje nga Auditimi: Për katër vitet ushtrimore 2018, 2019, 2020 dhe 2021 bilancet nuk janë dorëzuar sipas legjislacionit në fuqi si dhe shtyrjeve me anë të akteve normative.

-Në analizimin e zërit Mjete Monetare vihet re që nga viti 2018 deri në vitin 2021 kemi një rënie në vlerë e cila pasqyrohet si mos arkëtim si më poshtë, duke mos dhënë arsyet përkatëse se përse vjen kjo rënie e mos arkëtimeve. Të ardhurat kryesore në bankë janë depozitimet e arkës gjatë mbylljeve ditore.

-Në analizimin e zërit të drejta të arkëtueshme dhe nënkategorisë “nga aktiviteti i shfrytëzimit” vihet re një rritje në vlerë e cila përkon me mosarkëtim në kohë të detyrimeve nga ana e debitorëve që reflektohet dhe në zërin e Mjeteve Monetare si një rënie e arkëtimeve me anë të Bankës dhe Arkës.

-Në nënkategorinë “llogari të tjera të arkëtueshme”, përshkrimi i llogarisë “Institucioni Financiare për t’u arkëtuar Posta, Uft, etj, nuk sqaron nëse përkojnë me të ardhurat e përfituara në muajin dhjetor dhe të mbledhura nga këto institucione për llogari të shoqërisë apo për ndonjë arsye tjetër.

-Gjithashtu, përshkrimi i llogarisë “Garanci përmbarues privat” paraqet një vlerë prej 24,105,629 lekë, në fund të periudhës 2018, duke u shtuar në periudhën pasardhëse në vlerën 28,069,356 lekë dhe qëndruar si e tillë për vitet në vazhdim, dhe nuk janë dhënë arsyet përkatëse, se çfarë karakterizon kjo vlerë dhe përse është e mbartur ndër vite.

Në llogaritë e arkëtueshme janë krijuar provizione për zhvlerësimin e aktiveve financiare të ndara në KL Familjar, KL Privat dhe KL Ente.

Nga analizimi i tyre vihet re që vlera e provizionit mbetet e pandryshuar dhënuq jepen shpjegime se klientët e përfshirë në klasifikimet e mësipërme në çfarë viti janë mbartur dhe përse janë klasifikuar si provizione dhe përkundrejt si borxh i keq. Në ato pak raste ku shoqëria ka humbur me anë të vendimit të gjykatës vlerë të caktuar të cilat i përkasin faturimeve që janë provizionuar për humbje, ekziston një vlerë e re e cila kalon si shpenzime të periudhës duke mos dhënë arsyet përkatëse mbi karakteristikat e vlerës.

-Në “detyrime afatgjata” dhe “Titujt e huamarrjes” janë përfshirë tre kredi afatgjatat, Kredia OPEC lidhur me datë 10.10.2002 në vlerën 2,672,938 USD, Kredia BEI lidhur me datë 15.04.2004 në vlerën 7,011,841 Euro si dhe Kredia IDA lidhur me datë 07.07.2003 në vlerën 5,201,310 USD, të konvertuara me kursin e ditës për vitet përkatëse. Për vitet në vijim principali dhe interesat nuk paguhën, por njihen si detyrime ndaj Ministrisë së Financave.

-Në analizimin e shpenzimeve në zërin Gjoha, Penalitete, Dëmshpërblime gjendja të cilat rëndojnë buxhetin e shoqërisë duke i përdorur fondet pa efektivitet, efience dhe ekonomikitet.

Në analizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve ku në të cilën shihet që shoqëria tre vitet e fundit, duke mbajtur të ardhurat në mënyrë konstante ka rritur shpenzimet dhe kur shoqëria rezulton me humbje.

6.1 Rekomandimi: UK Durrës sh.a. gjatë hartimit të pasqyrave financiare të marrë në konsideratë Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, hartimin, miratimin dhe depozitimit e pasqyrave financiare në kohë sipas legjislacionit në fuqi si dhe të ketë parasysh likuidimin në kohë ose duke krijuar një rend mbi likuidimin e kreditorëve të cilët janë akumuluar ndër vite.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit: Në lidhje me zbatimin e Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit ju informojmë se bazuar në Ligjin Nr. 25/2015 date 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat

Financiare", njësitë financiare ekonomike klasifikohen në disa njësi ekonomike, ku UKD Sha klasifikohet si njësi ekonomike e madhe, pasi plotëson numrin e lartë të punonjësve mbi 250 dhe vlerën e aktiveve mbi 750 milion lekë, ndaj ka ushtruar SNRF si mënyrë raportimi të Pasqyrave Financiare.

Nga ana e SHRUKD do merren masa që ky raportim të bëhet brenda afateve të përcaktuara ligjore. Sa i përket likuidimeve në kohë ose duke krijuar një rend kronologjik, si dhe likuidimin në rend dhe në kohë të palëve të treta, ju informojmë se shoqëria e re tashmë jo vetëm po zbaton një rend kronologjik por po shlyen me renditje edhe detyrime të trashëguara të ish UK.

Qëndrimi i audituesve:

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **në proces zbatimi**.

7. Gjetje nga Auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion në rrjetin ekzistues të qytetit të Durrësit, zona 10 dhe 13/1, për vitin 2021”, kriteret e veçanta nuk ishin në proporcion me objektin e kontratës, si dhe në mospërputhje me njëra tjetrën si më poshtë:

Shofer 4 persona, Automakinist 2 persona dhe Manovrator 6 persona, ndërkohë kërkon që të disponohen dhe mjetet që në total janë 25 mjete të kërkuara me 12 shoferë të kërkuar më sipër, të cilët janë mjete që duhen të jenë në shfrytëzim me kohë të plotë dhe që minimumi duhet të kenë nga një shofer për çdo mjet si dhe përfshirja e një numri të vogël të inxhinierëve në proporcion me vlerën dhe me zërat e punimeve në preventivin e punimeve.

7.1 Rekomandimi: UK Durrës SHA në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e specifikimeve teknike dhe kriteret e veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit: Në zbatim të sa citohet në këtë pikë zbatohet me përpikëmi kuadri ligjor për prokurimet publike, Ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik si dhe në zbatim të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik. OE të cilët dëshirojnë të jenë pjesëmarrës në çdo procedurë prokurimi, kanë të drejtë të ankohen sipas ligjit pranë organeve APP dhe KPP në çdo fazë të procedurave dhe nuk privohen nga e drejta e ankimit.

Për sa më sipër, pra për sa kohë nuk ka ankesa kriteret nuk mund të paragjyken. Vetë APP është autoriteti parësor i cili kontrollon DST dhe del me rekomandime nëse vëren se ka kushte për konkurrim jo të drejtë.

Qëndrimi i audituesve:

Audituesi, mbi bazën e shqyrtimit të dokumentacionit konkludon se brenda afatit të përcaktuar për secilin rekomandim, subjekti (ose struktura përkatëse brenda subjektit) nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimin sipas llojit (përmirësim ligjor, organizativ, shpërblim dëmi, administrativ, disiplinor etj.), por vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerësohet në mundësinë e realizimit. Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pa zbatuar**.

8. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje mjete për nevojat e UK Durrës SHA”, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriteret e veçanta, nuk është cilësuar viti prodhimit për automjetet, që është minimumi mbi përllogaritjen e vlerës që mbartin ato. Gjithashtu, për objekt të njëjtë kërkohen specifikime teknike të ndryshme.

Sa më sipër në specifikimet teknike për “Makinë teknologjike APV vetëshkarkuese” është kërkuar kriter për km e përshkruara deri 251,000km, ndërsa për “makinë teknologjike vetëshkarkuese për

pastrim pusetash e kanalizime dhe transport materialesh të veçanta” deri 150,000 km. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 50, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

8.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë UK Durrës SHA të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë, në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike, në lidhje me km e përshtuara të automjeteve dhe vitin e prodhimit si dhe për komisionin e marrjes në dorëzim të mallit në lidhje me makinën teknologjike APV, që rezultoi të jetë me timon në krahë të djathtë.

Menjëherë

Komenti i Subjektit: Në vijimësi dhe në zbatim të sa citohet në këtë pikë zbatohet me përpikmëri kuadri ligjor për prokurimet publike, Ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik si dhe Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik.

Komisioni i marrjes në dorëzim i është përmbajtur specifikimeve të pranuar dhe prokuruar. Duke qenë se ndaj punonjëseve janë propozuar dhe janë marrë masa disiplinore në zbatim të raportit mendojmë se Rekomandimi quhet i zbatuar plotësisht.

Qëndrimi i audituesve:

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet ***i zbatuar pjesërisht.***

9. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës nr.3011 Prot., datë 24.12.2020 me vlerë 37,500,594.41 lekë me TVShme objekt “*Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Shkafane dhe Lagjet Muzhaq Kulls, nj. Adm. Ishëm, Bashkia Durrës*” rezultoi se volumet e punës të situacionit nr. 1, për disa zëra të ndryshëm janë nga 101 % deri në 300 % më tepër, në krahasim me ato të preventivit të kontratës, në një kohë kur nga data 07.01.2021 deri në datë 22.01.2021 nuk ka as një kërkesë dhe as miratim për ndryshim projekti. Nga krahasimi i grafikut të punimeve dhe volumeve të situacionit ka një diferencë të konsiderueshme mes volumeve të parashikuara për tu kryer me ato të situacionuara e likuiduara në vlerën 6,394,479.6 lekë me TVSH, ose gati 50 % kapaciteteve teknike të ofruar dhe të vendosura në dispozicion gjatë zbatimit të punimeve (procesverbali i fillimit të punimeve, ditari i punimeve etj.).

Nga auditimi i të dhënave të ditarit të punimeve dhe tabelës krahasuese të grafikut të punimeve rezulton se është likuiduar situacionit pjesor nr.1 me vlerë 12,662,956.2 lekë me TVSH në kushtet kur nuk janë kryer zëra punimesh në vlerën 8,912,897 lekë me TVSH.

Përsa më sipër, është në kundërshtim me Ligjin Nr.8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, Kreu III, Udhëzimi nr.3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafët 3.2 dhe 3.3, Kontratën e Shoqëriat të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit nr.2801 Prot., datë 04.12.2020 si dhe me Kontratën e Shoqëriat të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit nr. 2345 Prot., datë 12.05.2021.

9.1 Rekomandimi: Nga ana e UK Durrës SHA të merren masa për ngritjen e grupeve efektive në drejtim ndjekjes së kontratës, me qëllim shmangien e kryerjes së pagesave përmes situacioneve fiktive e që nuk paraqesin realitetin në momentin e likuidimit.

Në vijimësi

Komenti i Subjektit: Administratori i SHRUKD sh.a ka marrë dhe vijon të marrë masa në vijimësi për ngritjen e grupeve efektive në drejtim të ndjekjes së kontratave, me qëllim shmangien e kryerjes së pagesave që nuk paraqesin realitetin e situacioneve. Për sa më sipër, Rekomandimi do të zbatohet në vijimësi.

Qëndrimi i audituesve:

Audituesi, mbi bazën e shqyrtimit të dokumentacionit konkludon se brenda afatit të përcaktuar për secilin rekomandim, subjekti (ose struktura përkatëse brenda subjektit) nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimin sipas llojit (përmirësim ligjor, organizativ, shpërblim dëmi, administrativ, disiplinor etj.), por vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerësohet në mundësinë e realizimit. Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet ***në proces zbatimi***.

10. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “*Sistemimi i furnizimit me ujë të zonës Turistike Hamallaj, Faza II, Nj. Adm. Sukth, Bashkia Durrës*” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriterë të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë:

Vendosja e licencave të mëposhtme: *NP.5-B Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti, NP.11-A Ndërtime për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë dhe NS.1-A Punime për prishjen e ndërtimeve*, ku bazuar në VKM nr.943 datë 28.12.2016⁴⁸ nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve.

Vendosja e kriterëve “*Operatori duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht 150 punonjës*”, nuk provon përvojën e duhur, dhe se ajo nuk mund të matet me numrin e personave që ka të punësuar, por me realizimet e projekteve të mëparshme dhe punëve të ngjashme. Gjithashtu “*Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet*”, diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.

- Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “*Ndërtim i rrjetit të KUZ të fshatit Shënavlash, Bashkia Durrës*” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriterë të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë:

Kërkesa për licencat *NP.5-B “Punime nëntokësore, ura e vepra arti, NP.11-A Ndërtime për N/Stac., kab.e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë” dhe NS.1-A “Punime për prishjen e ndërtimeve”*, bazuar në VKM nr.943 datë 28.12.2016⁴⁹ nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve. Vendosja e kriterit si më poshtë: “*Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet*” kriterë të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.

- Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “*Përmirësim i furnizimit me ujë lagja nr.1, Vardardh, nj. Adm Sukth, Bashkia Durrës*” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, janë vendosur kriterë të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë:

Vendosja e licencave të mëposhtme: *NP.5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti, NP.11-A Ndërtime për N/Stac., kab. e transform., linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë, NS.1-A Punime për prishjen e ndërtimeve dhe NS 9-A Punime strukturore special* ku bazuar në VKM nr.943 datë 28.12.2016⁵⁰ nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve.

Vendosja e kriterit si më poshtë: “*Drejtuesi Teknik të ketë përvojë jo më pak se 10 vjet*” kriterë të cilat diskriminojnë operatorët e tjerë si dhe drejtuesit teknik të cilët anën profesionale të tyre e dëshmon licenca përkatëse që kanë.

-Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “*Sistemimi i furnizimit me ujë të zonës Turistike Hamallaj, Faza II, Nj. Adm. Sukth, Bashkia Durrës*” gjatë hartimit të specifikimeve

teknike dhe kritereve të veçanta, janë vendosur kritere të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë:

Vendosja e licencës të mëposhtme “NP.-1 Punime gërmimi në tokë” ku bazuar në VKM nr. 943 datë 28.12.2016⁵¹ nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve.

Vendosja e kritereve si “Të kenë në stafin e tyre një inxhinier ndërtimi”, “Të kenë në stafin e tyre një murator, bojaxhi”, ku për shkak të volumit të vogël të punës që ka në lidhje me ndërtimin është i panevojshëm përfshirja e tyre si kriter për të qenë pjesëmarrës në garë.

Kamion me vinç (me kapacitet mbajtës mbi 5 ton)”, ku sipas specifikimeve teknike kemi të bëjmë me vendosjen e depozitave të klorit gjë që e bën të panevojshme pasjen si kriter të veçantë të kamionit me vinç vetëm për arsyen e mësipërme.

-Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit të fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë, Njësia Administrative Ishëm-Bashkia Durrës” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta, janë vendosur kritere të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë:

Mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës: “Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës (mbi 20 ton) – Copë 3”, “Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës (mbi 13 ton) – Copë 2” dhe “Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës (mbi 8 ton) – Copë 2, të cilat duke u bazuar në preventivin e punimeve dhe grafikun e punimeve, nuk ka një llogaritje të ndarjes së tyre sipas tonazhit ku në gjykimin e audituesve ndarja e tyre, si më sipër, sipas tonazhit përbën arsye mbi skualifikimin e O.E. të tjerë pjesëmarrës, ose orientimin drejtë një O.E. fitues të paracaktuar që të përmbushë kriteret e mësipërme.

Kërkesa për drejtues teknik si në rastin e: “1 (një) inxhinier hidroteknik” dhe “1 (një) inxhinier ndërtimi” e cila është e ulët në proporcion me objektin e kontratës dhe volumin e punëve në grafikundhe preventivin e punimeve, ku minimalisht duhet të ishin kërkuar nga 2 inxhinier për klasifikim.

- Gjatë zhvillimi të Procedurës së Prokurimit me objekt “Sistemimi i kanalizimeve të ujërave të ndotura të zonës turistike Hamallaj, Faza I, Njësia Administrative Sukth, Bashkia Durrës” gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta, janë vendosur kritere të cilat nën gjykimin e audituesve janë të ekzagjeruara dhe nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë: Vendosja e licencës të mëposhtme: “NP 2-B Ndërtimi civile dhe industrial”, “NP 5-B Punime nëntokësore, ura e vepra arti” dhe “NP. 11-A Ndërtime për N/Stac., kab e transformatorit, linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë” ku bazuar në VKM nr.943 datë 28.12.2016⁵² nuk janë në proporcion me objektin e kontratës si dhe me zërat dhe punimet e detajuara në preventivin e punimeve.

Vendosja e kritereve “inxhinier elektronik”, i cili gjithashtu nuk është në proporcion me objektin e kontratës dhe me zërat e punimeve, si dhe “4 Punonjës mekanik, 4 Punonjës Elektracist, 4 Punonjës Bojaxhi dhe 2 Punonjës Pllakashtrues”, ku për shkak të volumit të vogël të punës është i panevojshëm përfshirja e tyre si kriter për të qenë pjesëmarrës në garë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: UK Durrës sh.a., në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e kritereve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, përmbajtjen e tij duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapurndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Në vijimësi

Komenti i Subjektit: Në vijimësi si dhe në zbatim të sa citohet në këtë pikë zbatohet me përpikmëri kuadri ligjor për prokurimet publike, Ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” VKM Nr. 285

datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik si dhe në zbatim të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

OE të cilët dëshirojnë të jenë pjesëmarrës në çdo procedurë prokurimi, kanë të drejtë të ankohen sipas ligjit pranë organeve APP dhe KPP në çdo fazë të procedurave dhe nuk privohen nga e drejta e ankimit. Për sa më sipër, pra për sa kohë nuk ka ankesa kriteret nuk mund të paragjyken. Vetë APP është autoriteti parësor i cili kontrollon DST dhe del me rekomandime nëse vëren se ekzistojnë rrethana për konkurrim jo të drejtë.

Qëndrimi i audituesve:

Audituesi, mbi bazën e shqyrtimit të dokumentacionit konkludon se brenda afatit të përcaktuar për secilin rekomandim, subjekti (ose struktura përkatëse brenda subjektit) nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimin sipas llojit (përmirësim ligjor, organizativ, shpërblim dëmi, administrativ, disiplinor etj.), por vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerësohet në mundësinë e realizimit. Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet ***i pa zbatuar***.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt ‘Ndërtimi i Ujësjellësit të Fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë Njesia Administrative Ishëm - Bashkia Durrës’, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE K. & N., të përfaqësuar këta nga OE K. me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 4.../10 datë 06.06.2019 dhe me përfaqësues ligjor z. S. K. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 1922 prot., datë 13.09.2019 me vlerë 172,471,458.4 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 21 javë nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës. Nga auditimi i dosjes teknike të kontratës, konkretisht nga krahasimi i librezës së masave, situacionit përfundimtar, projektit të miratuar me ndryshime, etj. rezultoi se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve shuma prej **49,755 lekë pa TVSH, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik** si rrjedhojë e punimeve të situacionuara por të pakryera në fakt për 2 zëra punimesh si më poshtë:

Në lidhje me zërin ‘Mbushje me material të zgjedhur të gërmuar’.

Sipas situacionit përfundimtar për këtë zë rezulton se është likuiduar volumi prej 1168 m³. Libreza e masave pasqyron në mënyrë analitike të njëjtin volum punimesh. Në fakt nga analiza e kësaj të fundit konstatohet se gjerësia me të cilin është gërmuar kanali në segmentin L-B D.1 750-4275 është 0.25 ml kurse gjerësia e mbushjes me këtë material është marrë 0.6 ml. Duke bërë korrigjimet rezulton se është përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve volumi prej 123.55 m³ ose shuma prej **12,355 lekë pa TVSH.**

Në lidhje me zërin ‘F.V. Tub PE100 Φ 63mm PN 10atm’.

Sipas situacionit përfundimtar për këtë zë rezulton se është likuiduar volumi prej 597 ml. Ky volum sipas librezës së masave ka rezultuar nga linja në L-B D.1 5087 - 4790 (368 ml), L-B D.4 0 - 165 (113 ml) dhe L-B D.9 0 - 125 (116 ml). Në fakt referuar kronologjisë së punimeve dhe volumeve të pasqyruara për volumet e gërmimit në tokë kat. III dhe tokë e fortë rezulton se po në këto akse janë gërmuar përkatësisht gjatësitë 300 ml, 113 ml dhe 116 ml, ose 529 ml në total, pra 68 ml më pak. Duke bërë korrigjimet rezulton se është përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve shuma prej **37,400 lekë pa TVSH.**

Si përfundim, rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej **49,755 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e punimeve të pakryera në fakt, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UK Durrës sh.a. dhe si e tillë duhet të zhdëmtohet nga ana e BOE “K. & N.” në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e UK Durrës sh.a. të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **49,755 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE K. & N. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 1922 prot., datë 13.09.2019 me objekt *'Ndërtimi i Ujësjellësit të Fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë Njësia Administrative Ishëm - Bashkia Durrës'*.

Menjëherë

Komenti i Subjektit: Nga ana e Administratorit janë bërë Njoftimet për shpërbllim dëmi me Nr. 184/64 dhe Nr. 184/ 63 prot, datë 11.05.2023 për operatorët ekonomik N... shpk dhe K... shpk. Në datë 22/6/2023 subjekti K.. shpk ka kryer pagesën e vlerës sipas njoftimit për shpërbllim dëmi.

Qëndrimi i audituesve: Nga ana e subjektit SHRUK Durrës SHA është kërkuar likuidimi i dëmit me njoftimet nr.184/63 prot, datë 11.05.2023 dhe nr.184/64 prot, datë 11.05.2023 për OE N... SHPK, S... SHPK dhe K... SHPK. Nga nxjerrje e llogarisë të SHRUK Durrës SHA, në Tirana Bank për periudhën nga 01 Qershor 2023-22 Qershor 2023, është kryer pagesa vullnetarisht nga OE K... SHPK në datën 22.06.2023. Me Urdhërin 6489 Prot., datë 29.12.2023 është kryer sistemimi kontabël në vlerën prej 49,755 lekë..

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet ***i zbatuar***.

2. Gjetje nga Auditimi: Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt *'Përmirësimi i furnizimit me ujë Lagia Nr. 1, Vadardhë, Njësia Administrative Sukth Bashkia Durrës'*, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE K. & L. & S., të përfaqësuar këta nga OE K. me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 4.../12 datë 07.04.2020 dhe me përfaqësues ligjor z. S. K. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 1520 prot., datë 10.08.2020 me vlerë 153,273,319.4 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 200 ditë kalendarike nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve BOE K. & L. & S. vlera prej 336,000 lekë pa TVSH si rrjedhojë e punimeve të pa kryera në fakt dhe/ose jo të kryera sipas zërit të parashikuar në preventiv. Konkretisht kjo shumë rezulton si më poshtë:

Në lidhje me zërin 'Prova në tubin',

Sipas projekt-preventivit të hartuar nga ana e projektuesit rezulton se janë përfshirë në preventiv e njëkohësisht edhe në ofertën e paraqitur nga sipërmarrësi i punimeve BOE K. & L. & S. zëri për kryerjen e provës së tubit. Në fakt referuar *Specifikimeve Teknike*, Kapitulli 8, pika 8.9 *Përshkrimi i çmimit njësi të tubave për kanalizimet përcaktohet se: "Furnizim i tubacioneve të gjitha diametrave, mbajtja, shtrirja, furnizimi i të gjitha materialeve të nevojshme, veglave, pajisjeve të kërkuara për shtrimin e tubave, fuqia punëtore, përshtatësit, bashkuesit, izoluesit, prova e tubave, sigurimi dhe instalimi i shiritave me ngjyrë, sheshimi i sipërfaqes, hekuri dhe armimi i tubave dhe të gjitha aktiviteteve siç përshkruhen më sipër janë përfshirë në çmimin njësi për një metër tubacion kanalizimesh"*. Gjithashtu, referuar kontratës së sipërmarrjes të lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 1520 prot., datë 10.08.2020, neni 31 Inspektimet, pika 1 *përcaktohet se: "Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktori brenda çmimit të kontratës"*. Për rrjedhojë rezulton se është përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve shuma **336,000 lekë pa TVSH**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 81, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e UK Durrës sh.a. të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës

336,000 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE K. & L. & S. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 1520 prot., datë 10.08.2020 me objekt 'Përmirësimi i furnizimit me ujë Lagjia Nr.1, Vadardhë, Njësia Administrative Sukth Bashkia Durrës'.

Menjëherë

Komenti i Subjektit: Nga ana e Administratorit janë bërë Njoftimet për shpërblim dëmi me Nr. 184/ 63; 184/60; 184/59 prot, datë 11.05.2023 për të tre operatorët ekonomik S... shpk, L.... shpk dhe K.... shpk. Në datë 22/6/2023 subjekti K.. shpk ka kryer pagesën e vlerës sipas njoftimit për shpërblim dëmi.

Qëndrimi i audituesve: Nga ana e subjektit SHRUK Durrës SHA është kërkuar likuidimi i dëmit me njoftimet nr.184/59 prot, nr.184/60 prot, nr.184/63 prot, datë 11.05.2023. Nga nxjerrje e llogarisë të SHRUK Durrës SHA, në T. B. për periudhën nga 01 Qershor 2023-22 Qershor 2023, është kryer pagesa vullnetarisht nga OE K.... SHPK në datën 22.06.2023. Me Urdhërin 6490 Prot., datë 29.12.2023 është kryer sistemimi kontabël në vlerën prej 336,000 lekë.

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet ***i zbatuar***.

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt '*Rikonstrukcion i rrjetit të ujësjellësit Shkafane dhe Lagjet Muzhaq Kulls, nj. adm. Ishëm, Bashkia Durrës*', rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE G. & L., të përfaqësuar këta nga OE G. me nr. licence për zbatim punimesh NZ.7.../4 datë 15.06.2020 dhe me përfaqësues ligjor z. K. A. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 3011 prot., datë 24.12.2020 me vlerë 37,500,594.41 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 90 ditë kalendarike nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës sipas grafikut të hartuar nga projektuesi.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve BOE G. & L. vlera prej **404,900 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e punimeve të pa kryera në fakt dhe/ose jo të kryera sipas zërit të parashikuar në preventiv. Konkretisht kjo shumë rezulton si më poshtë:

Në lidhje me zërin 'F.V. Tub PE100 RC Φ 50 mm PN 16 atm',

Sipas situacionit përfundimtar për këtë zë rezulton se është likuiduar volumi prej 3369 ml. Sipas librezës së masave pasqyrohet në mënyrë analitike volumi prej 924 ml linear për situacionin e parë dhe 2429 ml për situacionin e dytë (559 ml + 1867 ml), ose 3350 ml në total. Në fakt nga krahasimi i volumeve të situacionit përfundimtar dhe librezave të masave rezulton një diferencë me situacionim tepër në sasinë prej 19 ml. Duke bërë llogaritjet rezulton se është përfituar padrejtësisht vlera prej **20,900 lekë pa TVSH** (19 ml x 1,100 lekë/ml).

Në lidhje me zërin 'Prova në tubin',

Sipas projekt-preventivit të hartuar nga ana e projektuesit rezulton se janë përfshirë në preventiv e njëkohësisht edhe në ofertën e paraqitur nga sipërmarrësi i punimeve BOE G. & L. zëri për kryerjen e provës së tubit. Në fakt, referuar kontratës së sipërmarrjes të lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 3011 prot., datë 24.12.2021, neni 31 *Testimet dhe Inspektimet*, përcaktohet se: "*Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktori brenda çmimit të kontratës*". Për rrjedhojë rezulton se është përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve shuma **384,000 lekë pa TVSH** e likuiduar për kryerjen e testimit të tubacioneve.

Si përfundim, rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera 404,900 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UK Durrës sh.a.dhe si e tillë

duhet të zhdëmtohet nga ana e BOE "G. & L." në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga ana e UK Durrës sh.a. të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **404,900 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE G.&L. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 3011 prot., datë 24.12.2020 me objekt 'Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Shkafane dhe Lagjet Muzhaq Kulls, nj. adm. Ishëm, Bashkia Durrës'.

Menjëherë

Komenti i Subjektit: Nga ana e Administratorit janë bërë Njoftimet për shpërbllim dëmi me nr. 184/61; 184/62 pror, datë 11/05/2023 për të 2 operatorët ekonomik. Duke qenë se subjekti nuk është paraqitur pas njoftimit, nga ana e SHRUKD sh.a janë marrë masa duke depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, kërkesë padinë nr. 4126 prot, date 26/07/2023 me objekt "Kthimin e shumës 404.900 lekë për punime të pakryera sipas Raportit përfundimtar të KLSH-së (bashkëlidhur kopje). *Rekomandimi konsiderohet në zbatim.*

Qëndrimi i audituesve: Nga ana e subjektit SHRUK Durrës SHA është kërkuar likuidimi i dëmit, me anë të njoftimeve nr.184/61 prot, datë 11.05.2023 dhe nr.184/62 prot, datë 11/05/2023 OE BOE G.&L. Gjithashtu, është depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës kërkesë padia nr. 4126 prot, date 26/07/2023 me objekt "Kthimin e shumës 404.900 lekë për punime të pakryera.

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet ***në proces zbatimi.***

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në 63 raste të blerjeve emergjente, gjithsej në vlerën prej **3,180,666 lekë**, shoqëria ka përdorur procedurën e blerjeve shkresore kur blerjet nuk kanë qenë në kushtet e emergjencës, d.mth. në kushtet e ndodhjes të një ngjarje të rastit, ngjarje e cila nuk mund të parashikohet në fillim të vitit, për kë arsye këto shpenzime janë konsideruar pa efektivitet ekonomik.

Në vitin 2018, në 19 procedura emergjence, gjithsej në vlerën prej **508,621 lekë**. Në vitin 2020, në 17 procedura emergjence, gjithsej në vlerën prej **902,043 lekë**.

-Në vitin 2021, në 16 procedura emergjence gjithsej në vlerën prej **1,186,082 lekë**.

Në vitin 2022, në 11 raste, Autoriteti Kontraktor ka përdorur procedurën e blerjeve shkresore në raste emergjente kur blerjet nuk kanë qenë në kushtet e emergjencës, në vlerën gjithsej prej **583,920 lekë**, dhe se këto shpenzime konsiderohen pa ekonomikitet. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të analizojë situatën e krijuar dhe të përcaktojë shkallën e përgjegjësisë të personave përgjegjës. Gjithashtu, administratori duhet të sigurojë që të përfshijë në rregulloret apo manualet përkatëse klasifikimin e rasteve emergjente sipas natyrës së proceseve kryesore të aktivitetit të shoqërisë, me qëllim parandalimin e rasteve abuzive në shpenzimin e fondeve publike.

Në vijimësi

Komenti i Subjektit: Janë marrë masa, duke filluar që nga Janari i vitit 2023 dhe në vijim, praktikat nën vlerën 100.000 lekë të mos trajtohen më si blerje emergjente, në rast se nuk kemi të bëjmë me avari emergjente të paparashikuara, të cilat kanë nevoja urgjente për tu kryer, pasi mund të

pengojë një proces pune të domosdoshëm. Autoriteti kontraktor dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka filluar ti trajtojë si 2 procedura të ndryshme blerjet emergjente dhe blerjet nën vlerën 100.000 lekë sipas parashikimeve ligjore.

Referuar këtij rekomandimi stafi i SHRUKD ka marrë masa që të bëhet klasifikimi i rasteve emergjente me Urdhërin Nr. 71 datë 24.04.2023 (bashkëlidhur). *Rekomandimi quhet i zbatuar plotësisht.*

Qëndrimi i audituesve: Nga ana e Administratorit është nxjerrë Urdhëri Nr.71 datë 24.04.2023, me anë të cilit kërkohet që komisioni i prokurimit në vlerë të vogël të ndajë blerjet e vogla nën vlerën 100,000 lekë nga ato në raste emergjente.

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**.

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt *‘Përmirësimi i furnizimit me ujë Lagia Nr. 1, Vadardhë, Njësia Administrative Sukth Bashkia Durrës’*, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE K. & L. & S., të përfaqësuar këta nga OE K. me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 4.../12 datë 07.04.2020 dhe me përfaqësues ligjor z. S. K. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 1520 prot., datë 10.08.2020 me vlerë 153,273,319.4 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 200 ditë kalendarike nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton Në lidhje me zërin ‘F.V derë metalike’.

Nga verifikimi në terren i punimeve rezultoi se dyert metalike të vendosura ishin të një cilësie shumë të dobët duke mos siguruar kështu një investim të qëndrueshëm e duke bërë që fondet e shpenzuara për këtë zë në masën prej **1,339,800 lekë pa TVSH** të konsiderohen si të përdorura pa efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet.

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu II, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Kontratën e Shoqëriat të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit nr. 1521 prot., datë 10.08.2020 si dhe Kontratën e Shoqëriat të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit nr. 1653/8 prot., datë 11.05.2021. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e UK Durrës sh.a. të merren masa për ngritjen e grupeve efektive në drejtim ndjekjes së kontratës, me qëllim shmangien e kryerjes së punimeve jo cilësore dhe/apo në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara si dhe shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve të shoqërisë.

Në vijimësi

Komenti i Subjektit: Në vijimësi si dhe në zbatim të rekomandimit, Administratori i shoqërisë së re ka marrë dhe vijon të marrë masa për ngritjen e grupeve efektive për ndjekjen e kontratave.

Qëndrimi i audituesve:

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **në proces zbatimi**.

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt *‘Ndërtimi i Ujësjellësit të Fshatrave Lalëz, Bizë, Draç dhe Shetë Njësia Administrative Ishëm - Bashkia Durrës’*, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE K. & N., të përfaqësuar këta nga OE K. me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 4.../10 datë 06.06.2019 dhe me përfaqësues ligjor z. S. K. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin

Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 1922 prot., datë 13.09.2019 me vlerë 172,471,458.4 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 21 javë nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës. Nga auditimi i dosjes teknike të kontratës, konkretisht nga krahasimi i librezës së masave, situacionit përfundimtar, projektit të miratuar me ndryshime, etj. rezultoi se sipas dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosjen teknike të zbatimit nuk dokumentohen në asnjë rast të vetëm kryerja e punimeve për transportin e materialit të gërmuar, mbushjes me rërë si dhe mbushjes me zhavorr për linjën e dërgimit si dhe linjave të shpërndarjes (shuma prej 8,464,526 lekë pa TVSH për linjën e dërgimit, shuma prej 6,378,512 lekë pa TVSH për linjën e shpërndarjes Lalëz dhe Bizë, shuma prej 4,533,929 lekë pa TVSH për linjën e shpërndarjes në Drac si dhe shuma prej 4,133,966 për linjën e shpërndarjes në Shete). Në total rezulton se vetëm për këta dy zëra nuk dokumentohen punime të kryera në vlerën totale prej **23,510,933 lekë pa TVSH**.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3 si dhe me kontratën e Shoqëriat të mbikëqyrjes të lidhur sipas shkresës me nr. 1925 prot., datë 13.09.2019, kontratën e Shoqëriat të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit nr. 720 prot., datë 10.04.2020 si dhe Urdhrit të Titullari të AK me nr. 1298/9 prot., datë 24.05.2019 për ndjekjen e kontratës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga ana e UK Durrës sh.a. të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës me qëllim kryerjen e sondazheve përfaqësuese në terren për të verifikuar zbatueshmërinë e projekt – preventivit të kontratës, konkretisht zbatueshmërisë së zërave për transportin e materialit të gërmuar, mbushjes me rërë si dhe mbushjes me zhavorr për të cilat nuk konfirmohet kryerja e tyre në shumën prej **23,510,933 lekë pa TVSH**. Në rast të konstatimit të punimeve të pakryera nga ato të përfshira në situacionin përfundimtar, të kërkohet arkëtimi i dëmit përkatës.

Menjëherë

Komenti i Subjektit: Referuar rekomandimit 3.1, ju sjellim në vëmendje se grupi i ngritur për kryerjen e sondazhit nga ana e SHRUKD, u bë me specialistë inxhinier dhe sigurisht nuk ishin punonjës të përfshirë në procesin e ndjekjes së kontratës. Për këtë kontratë ndjekës kanë qënë z. G. D, z. N. S, z. L. F.

Ndërsa punonjësi i cili ishte pjesë e sondazhit me urdhërin Nr.184/52 prot, datë 06.03.2023 të Administratorit u caktua Inxhinjeri B. M. E gjithë korrespondenca Njoftime, Urdhëri dhe proces verbali ju është dërguar me shkresën “Kthim përgjigje Projekt raportit Nr. 184/57 prot, datë 13.03.2023.

Qëndrimi i audituesve:

Përsa më sipër, rekomandimi konsiderohet *i zbatuar*.

4. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt ‘Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Shkafane dhe Lagjet Muzhaq Kulls, nj. adm. Ishëm, Bashkia Durrës’, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE G. & L., të përfaqësuar këta nga OE G. me nr. licence për zbatim punimesh NZ.7.../4 datë 15.06.2020 dhe me përfaqësues ligjor z. K. A. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. K. B. me nr. 3011 prot., datë 24.12.2020 me vlerë 37,500,594.41 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 90 ditë kalendarike nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës sipas grafikut të hartuar nga projektuesi.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se:

Në lidhje me zërin 'Shtresë stabilizanti t=20 cm'

Sipas situacionit përfundimtar rezulton volumi prej 4238.4 m² për lagjen Muzhaq dhe 1890.6 m² për Fshatin Shkafane. Libreza e masave pasqyron po të njëjtat volume të shprehura në mënyrë analitike. Në fakt referuar dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosje nuk rezulton asnjë rast i vetëm i përdorimit të këtij materiali përgjatë aksit të linjës së realizuar. Për rrjedhojë rezulton se nuk dokumentohen punime në shumën prej **2,758,050 lekë pa TVSH**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Nga ana e UK Durrës sh.a. të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës me qëllim kryerjen e sondazheve përfaqësuese në terren për të verifikuar zbatueshmërinë e projekt – preventivit të kontratës, konkretisht zbatueshmërisë së zërit *Shtresë stabilizanti t=20 cm*, për të cilin referuar dokumentacionit fotografik, nuk konfirmohet kryerja e tyre në shumën prej 2,758,050 lekë pa TVSH. Në rast të konstatimit të punimeve të pakryera nga ato të përfshira në situacionin përfundimtar, të kërkohet arkëtimi i dëmit përkatës.

Menjëherë

Komenti i Subjektit: Grupi i ngritur për kryerjen e sondazhit nga ana e SHRUKD është bërë me Inxhinier dhe sigurisht ishin nuk ishin punonjës të përfshirë në procesin e ndjekjes së kontratës. Për këtë kontratë ndjekës kanë qënë: z. L.F, z. N. S dhe z. E. S, Punonjësi, i cili ishte pjesë e sondazhit me urdhërin Nr184/55 prot, datë 07.03.2023 nga Administratori u caktua Ing. G. D. Korespondenca Njoftime, Urdhëri dhe proces verbali ju është dërguar me shkresën “Kthim përgjigje Projekt raportit Nr. 184/57 prot, datë 13.03.2023.

Pra nuk ishte punonjës i përfshirë në ndjekjen e kontratës.

Qëndrimi i audituesve:

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**.

E. MASA DISIPLINORE

E 1.2 Për punonjësit në marrëdhënie pune.

Komenti i Subjektit: Nga ana e Administratorit janë marrë masat disiplinore si më poshtë:

Për “Tërheqje Vëmendje”

-Vendimi Nr.184/65 prot., datë 11.05.2023 për punonjësin z. D. G;

-Vendimi Nr.184/66 prot., datë 11.05.2023 për punonjësin znj. M. H;

Për “Vërejtje me shkrim”

-Vendimi Nr.184/73 prot, datë 11.05.2023 për punonjësin z. A.K;

-Vendimi Nr.184/72 prot, datë 11.05.2023 për punonjësin z. E.S;

-Vendimi Nr.184/71 prot, datë 11.05.2023 për punonjësin z. L.F;

-Vendimi Nr.184/70 prot, datë 11.05.2023 për punonjësin z. E.S;

-Vendimi Nr.184/69 prot, datë 11.05.2023 për punonjësin z. G.D;

-Vendimi Nr.184/68 prot, datë 11.05.2023 për punonjësin z. N.S;

-Vendimi Nr.184/67 prot, datë 11.05.2023, për punonjësit znj. D.N;

Qëndrimi i audituesve:

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**.

2. AUDITIM I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE NË SUBJEKTIN AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Autoritetin Rrugor Shqiptar, për auditimin e zbatimit të rekomandimeve, të lëna në dy auditime të kryera gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, me objekt:

a) Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e përputshmërisë për periudhën objekt auditimi 01.10.2020 – 31.10.2022, përcjellë me shkresën Nr.1201/19 Prot. datë 02.08.2023.

b) për zbatimin e rekomandimeve të lënë në auditimin e projektit “*Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate*”, për periudhën objekt auditimi nga fillimi i projektit – 31.03.2022, të përcjella në subjekt me shkresën Nr.827/19 prot. datë 02.06.2023.

Në këtë pikë trajtohet zbatimi i rekomandimeve të përcjella me shkresën Nr.1201/19 Prot. datë 02.08.2023, ndërsa zbatimi i rekomandimeve të përcjella me shkresën Nr.827/19 prot. datë 02.06.2023, trajtohen në pikën 2.1.

Çështjet kryesore që janë trajtuar gjatë auditimit janë: verifikimi i hartimit nga subjekti të programeve (plan veprimeve), vlerësimi i ecurisë dhe i nivelit të zbatimit të rekomandimeve, përcaktimi i statusit të tyre, rikërkimi për zbatim i rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përhajtimi i punës për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi.

Gjithashtu është trajtuar nxjerrja nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve;

ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjekt u mbajt Akt Verifikimi nr. 1, datë 31.01.2024, administruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar me nr. 18/3 prot, datë 31.01.2024, për të cilin nuk është paraqitur observacion nga ana e subjektit. Pas dërgimit të Projektraportit të Auditimit, nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observacione.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Autoriteti Rrugor Shqiptar *ka respektuar* këtë afat duke kthyer përgjigje sipas shkresës së administruar në institucion me Nr.6558 Prot. datë 03.08.2023.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar *nuk janë marrë masa* për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

“*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*”,

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr.1201/19 Prot. datë 02.08.2023 dhe në Autoritetin Rrugor Shqiptar me Nr. 6558 Prot. datë 03.08.2023, janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar **29 masa organizative**;

b. Janë rekomanduar **1 masë për shpërblim dëmi në vlerën 12,131,741 lekë pa TVSH**;

c. Janë rekomanduar **5 masa për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit në shumën 477,246,069 lekë**;

d. Janë rekomanduar **masa disiplinore** mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, kontratat individuale të punës, ku i është kërkuar Drejtorit të Autoritetit Rrugor Shqiptar, referuar gjetjeve të auditimit, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe në varësi të tyre të japë masat disiplinore për ata punonjës që atakohen në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr.1201/19 Prot. datë 02.08.2023 dhe në Autoritetin Rrugor Shqiptar me Nr. 6558 Prot. datë 03.08.2023, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar (ARrSh)	Pa pranuar
1	Organizative	29 masa	29 masa	-
2	Shpërblim dëmi	1 masa 12,131,741 lekë	1 masa 12,131,741 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	5 masa 477,246,069 lekë	5 masa 477,246,069 lekë	-
4	Masa Disiplinore	Vlerësim i shkeljeve nga institucioni	Po	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	29 masa	10	-	15	4
2	Shpërblim dëmi	1 masa 12,131,741 lekë	-	-	-	1 masa 12,131,741 lekë
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	5 masa 477,246,069 lekë	3 384,839,168 lekë	-	2 masa 92,406,901 lekë	-
4	Masa Disiplinore	1	1	-	-	-
		36	14	0	17	5

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 1047/1 Prot. datë 29.12.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. S.H, (Përgjegjës grupi)

2. E.K

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr.1201/19 Prot. datë 02.08.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Autoriteti Rrugor Shqiptar, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr.825/15Prot. datë 03.05.2023, rezulton se nga **36** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi, 3-E, disiplinore*), janë pranuar nga subjekti **36** masa ose në masën 100 %. Nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 14 masa, ose 39 % e tyre, janë në proces zbatimi 17 masa ose 47 % dhe nuk janë zbatuar 5 masa ose 14 %. Niveli i zbatimit plotësisht të rekomandimeve është në masën 39 %, gjë e cila tregon se Autoriteti Rrugor Shqiptar nuk e ka vlerësuar si duhet procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	29 masa	10	-	15	4
2	Shpërblim dëmi	1 masa 12,131,741 lekë	-	-	-	1 masa 12,131,741 lekë
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	5 masa 477,246,069 lekë	3 384,839,168 lekë	-	2 masa 92,406,901 lekë	-
4	Masa Disiplinore	1	1	-	-	0
5	Gjithsej	36 489,377,810 lekë	14 384,839,168 lekë	-	17 masa 92,406,901 lekë	5 masa 12,131,741 lekë

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit plotësisht të rekomandimeve është në masën 39 %, nivele këto të cila tregojnë vlerësimin jo si duhet të këtij procesi si dhe domosdoshmërinë që ka ndjekja e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, përfundimi i atyre në proces si dhe nisja e hapave të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Autoriteti Rrugor Shqiptar, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën Nr.6595/3 Prot. datë 17.08.2023.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm

(pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me aktivitetin e organeve drejtuese rezulton se anëtarët e Bordit të Menaxhimit janë emëruar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 17.01.2018 “Për emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit të Autoritetit Shqiptar Rrugor”. Nëpërmjet Vendimit nr. 350, datë 16.06.2021, Këshilli i Ministrave vendosi përfundimin e mandatit të z. E.H dhe nëpërmjet Vendimit nr. 455, datë 29.06.2022, vendosi zëvendësimin e tij me z. E.L. Si rrjedhojë, për një vit, qershor 2021-qershor 2022, Bordi ka funksionuar me gjashtë anëtarë. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, neni 8, pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 18 – 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bordit, nëpërmjet sekretariatit/sekretarit të bordit, të tregojë kujdes maksimal në mënyrë që në asnjë rast në vazhdim, Bordi të mos ushtrojë funksionimin e tij pa numër të plotë të anëtarëve, sikurse e përcakton ligji nr. 10164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Nga ana jonë i është kërkuar kryetarit të bordit të marri masa për plotësimin e plotë të anëtarëve të Bordit.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

2. Gjetje nga Auditimi: Nga shqyrtimi i pjesëmarrjes së anëtarëve të Bordit në mbledhjet e zhvilluara, rezulton se gjatë vitit 2021, Kryetari i Bordit z. A.S nuk ka marrë pjesë në 5 mbledhje, ose 42 % të mbledhjeve të zhvilluara dhe z. F.K, përfaqësues i Shoqatës Shqiptare të Inxhinierëve Konsulentë, nuk ka marrë pjesë në 8 mbledhje, ose 67 % të tyre. Gjatë vitit 2022, rezulton se z. J.H, përfaqësues i Ministrisë së Brendshme, nuk ka marrë pjesë në 8 mbledhje, ose 80 % të mbledhjeve të zhvilluara; dhe z. A.S nuk ka marrë pjesë në 3 mbledhje nga 4 të zhvilluara, deri në zëvendësimin e tij me z. E.N nëpërmjet Vendimit nr. 455, datë 09.06.2022 të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, nga shqyrtimi i pagesave të kryera për kryetarin dhe anëtarët e Bordit, rezulton se pagesa e tyre është bërë për numër vendimesh të marra dhe jo për numër mbledhjesh të zhvilluara. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10164 datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, neni 10 mbi largimin nga detyra të anëtarëve të bordit, pika c si dhe VKM nr. 656, datë 31.10.2018 “Përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësisve të qeverisjes qendrore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 18 – 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Sekretari/sekretariati i Bordit të ndjekë me përgjegjshmëri pjesëmarrjen e anëtarëve të Bordit, në mënyrë që të respektohet kriteri i pjesëmarrjes minimale në 2/3 e mbledhjeve të zhvilluara gjatë vitit. Në rastet kur konstatohet tejkalim i këtij kriteri, të njoftohet Kryetari i Bordit, me qëllim marrjen e masave për të vënë në dijeni organin që e ka emëruar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Lidhur me rekomandimet tuaja për mos ushtrimin e funksionit të Bordit pa numër të plotë të anëtarëve, si dhe ndjekjen me përgjegjshmëri pjesëmarrjen e anëtarëve të Bordit, në mënyrë që të respektohet kriteri i pjesëmarrjes minimale në 2/3 e mbledhjeve të zhvilluara gjatë vitit sikurse e përcakton ligji nr. 10164, datë 15.10.2009 "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar", ju sqarojmë që në nenin 8 të ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009, përkatësisht pikat 3 dhe 4 bëjnë një rregullim ligjor për sa i përket kuorumi të përcaktuar për zhvillimin e mbledhjes dhe plotësimin të kuorumi për marrjen e vendimeve nga ana e Bordit, për sa më sipër nga ana e sekretarit të Bordit është vlerësuar ky rekomandim dhe është vijuar me njoftimin e anëtarëve të bordit (minimumi 24 orë) para mbledhjes dhe është kërkuar dhe një konfirmimin paraprak në lidhje me pjesëmarrjen e secilit anëtar.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi.*

2.2 Rekomandimi: Sekretari/sekretariati i Bordit të ndjekë me përgjegjshmëri pjesëmarrjen e anëtarëve të bordit dhe pagesa të llogaritit për numër takimesh dhe jo për numër vendimesh dhe nga ana e Drejtorisë së Financës të kontrollohet saktësia e dokumentacionit përpara kryerjes së pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Lidhur me rekomandimin tuaj të ndjekë me përgjegjshmëri pjesëmarrjen e anëtarëve të bordit dhe pagesa të llogaritit për numër takimesh dhe jo për numër vendimesh, ju bëjmë me dije se kopje e procesverbaleve mbi mbledhjen e Bordit dhe pjesëmarrësit në takim i dorëzohet Drejtorisë së Financave në mënyrë që të behet llogaritja e pagesës së anëtarëve të Bordit në bazë të numrit të takimeve.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i zbatuar.*

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me aktivitetin e organeve drejtuese rezulton se Vendimet e Bordit nuk kanë një rend dite të përcaktuar nga Kryetari si dhe nuk janë të shoqëruara me procesverbalet e mbledhjes. Në këtë rast, grupi i auditimit e kishte të pamundur të vlerësonte rendin e ditës, çështjet e diskutuara, vendimet që u morën, si dhe formën dhe rezultatin e votimeve. Gjithashtu, disa nga Vendimet e Bordit, që i janë vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk kanë bashkëlidhur asnjë dokumentacion shpjegues në mënyrë që të kuptohet se mbi bazën e çfarë dokumentacioni apo informacioni është marrë vendimi. Edhe pse grupi i auditimit kërkoi vazhdimisht praktikën që duhet të ishte bashkëlidhur këtyre vendimeve, deri në përfundim të auditimit nuk u vu në dispozicion asnjë dokument. Pra në këtë rast mungon gjurma e auditimit. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, neni 16, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore", neni 7 dhe neni 16, Detyrat e sektorit të Arkiv Protokollit në Rregulloren e Brendshme të Funksionimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 10, datë 04.09.2018 si dhe përcaktimet në normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shoqëriat arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat", neni 15, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 18-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Kryetarit të i Bordit të merren masa për përcaktimin e rendit e ditës për çdo mbledhje të zhvilluar. Gjithashtu, Sekretari/sekretariati i Bordit të mbajë procesverbalet e mbledhjes në të cilat të përmbledhë gjithçka që thuhet dhe diskutohet në mbledhje, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe formën dhe rezultatin e votimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Lidhur me rekomandimin tuaj për marrjen e masave për përcaktimin e rendit të ditës për çdo mbledhje të zhvilluar dhe mbajtjen e procesverbaleve për çdo mbledhje, nga ana sekretarit të Bordit ky rekomandim është vlerësuar dhe është vijuar me njoftimet paraprake për ditën, orën dhe rendin e diskutimeve gjatë takimit. Gjithashtu gjatë zhvillimit të mbledhjes është bërë mbajtja e minutave të takimit dhe është mbajtur procesverbal përmbledhës mbi të gjitha çështjet e diskutuara .

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

3.2 Rekomandimi: Nga ana e Sekretarit/sekretariatit të Bordit të merren masa që vendimet e Bordit të kenë të gjithë dokumentacionin shpjegues dhe justifikues bashkëlidhur dhe njëkohësisht Sektori i protokoll arkivës në asnjë rast të mos pranojë Vendimet e Bordit pa dokumentacionin e plotë bashkëlidhur.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Lidhur me rekomandimin tuaj për marrjen e masave që vendimet e Bordit të kenë të gjithë dokumentacionin shpjegues, justifikues, bashkëlidhur, ju bëjmë me dije se nga ana e sekretarit të bordit vendimet gjithmonë janë shoqëruar me dokumentacion shpjegues, justifikues dhe më pas janë dorëzuar te sektori i Arkivës- Protokoll. Gjithashtu pas rekomandimit tuaj për mbajtjen e procesverbaleve për çdo takim, pjesë e dokumentacionit bashkëlidhur është edhe procesverbali dhe minutat e takimit.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

4. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezulton se Sekretari i Bordit është propozuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe është miratuar nga Bordi por nuk ka zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore”, pasi në Rregulloren e Brendshme të ARRSH nuk ka përshkrim të detyrave të tij. Rregullorja e brendshme, edhe pse është miratuar nga vetë Bordi, me Vendimin nr. 10, datë 04.09.2018, nuk përmban rregullat për mënyrën e funksionimit të bordit. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 276, datë 16.5.2018 “Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar” pika III/3 si dhe VKM nr. 276, pika III/3/ç. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 18 – 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të merren masa për rishikimin e rregullores së brendshme të institucionit në të cilën të përshkruhen me detaje detyrat e sekretarit/sekretariatit të bordit, mënyra e funksionimit të bordit, hallkat e komunikimit dhe raportimit brenda dhe jashtë institucionit.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Autoritetin Rrugor Shqiptar ka në proces miratimi të ndryshimeve të Ligjit për ARRSH-në ku do të merren masa për rishikimin e rregullores së brendshme në përputhje me ndryshimet përkatëse.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet si *i pranuar* dhe *në proces zbatimi*.

5. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me buxhetin rezultojnë shpenzime publike të paplanifikuara në fillim të vitit dhe jashtë vitit buxhetor për të cilin janë parashikuar. Konkretisht, procedura e hapur e thjeshtuar e prokurimit me numër REF-98245-06-16- 2021 me objekt “Për mirëmbajtjen rutinë me performancë e segmentit rrugor Kryqëzim Qafa e Buallit-Fillim Rruga e Arbërit, me gjatësi 4.5 km” është kryer si rrjedhim i riallokimit të buxhetit të vitit 2021 për të cilën është lidhur kontrata nr. 5807 prot., datë 30.07.2021 në vlerën totale 744,000 lekë me TVSH, për periudhën 01.08.2021-31.12.2021. Segmenti rrugor i sipërcituar ka qenë i përfshirë në projektin e Bankës Botërore “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” deri në tetor të vitit 2020. Po për të njëjtin objekt prokurimi, me urdhrin e prokurimit nr. 328 prot., datë 17.12.2021 dhe fond limit në vlerën prej 673,069.⁵⁰ lekë pa TVSH, është kryer procedura me vlerë të vogël në datën 21.12.2021 për mirëmbaje për periudhën 01.01.2022-31.03.2022. Për këtë procedurë është lidhur kontrata nr. 11476/2 prot., datë 30.12.2021, pa mbaruar kontrata e mëparshme për të njëjtin objekt prokurimi. Me shkresën nr. 9295/1 prot., datë 15.10.2021 është miratuar riallokimi i fondit prej 161,600 lekë, ose afërsisht 20 % nga kontrata e sipërcituar. Nga sa më sipër rezulton se:

- është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 285 datë 19.05.2021 RrPP, neni 106 pika 1 dhe 2, e ndryshuar, pasi procedura e prokurimit në vlerë të vogël duhet të jetë bazuar në fondin e vitit buxhetor 2021;

- nuk është respektuar e drejta për të kryer shpenzime brenda kufirit të fondeve të miratuara, e cila skadon ditën e fundit të vitit buxhetor, pavarësisht nëse kontrata njëvjeçare ose shumëvjeçare mund të vazhdojë edhe në vitin buxhetor pasardhës;

- angazhimi i ri buxhetor (nënshkrimi i kontratës) për kontratën e dytë është kryer më vonë se data 15 Tetor e vitit buxhetor 2021, pra përtej afateve që parashikon udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pikat 41, 69, 71, 79, 83.

- stafi i ARRSH nuk është plotësisht i qartë dhe i informuar për të drejtat dhe detyrimet gjatë zbatimit të buxhetit dhe nëpunësi i autorizuar nuk provon se ka deleguar rregullat dhe procedura të miratuara në bordin e ARRSH për përgjegjësitë individuale gjatë zbatimit të buxhetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 23 – 26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH, në cilësinë e nëpunësit të autorizuar të merren të gjitha masat e nevojshme për analizën e nevojave të domosdoshme dhe planifikimin në kohën e duhur të shpenzimeve publike, me qëllim realizimin e shpenzimeve me eficiencën e duhur.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Lidhur me rekomandimin nga ana e ARrSh do kryhen analizat e nevojshme për kryerjen e shpenzimeve me eficiencën e duhur.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

5.2 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH, në cilësinë e nëpunësit të autorizuar të merren të gjitha masat e nevojshme për hartimin, miratimin në bord dhe delegimin e rregullave specifike dhe procedurave që duhet të ndiqen në procesin e zbatimit të buxhetit, me qëllim që çdo individ të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Lidhur me rekomandimin nga ana e ARrSh do kryhen miratimet përkatëse gjatë buxhetit të vitit 2024 e në vazhdim.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

6. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i procedurave për blerje të vogla rezultoi se në 4 raste, operatorët ekonomikë fitues janë paraqitur me oferta me vlerë më të ulët nga ajo e dërguar për verifikimin e tregut për vlerësimin e fondit limit. Ofertat e mësipërme janë prezantuar me vlera të ndryshme për të njëjtën objekt prokurimi dhe praktikisht në të njëjtën kohë, si më poshtë:

- Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale pastrimi” me numrin e referencës REF-89466-09-03-2021 dhe fond limit në vlerën prej 407,633 lekë pa TVSH.

Në SPE, në datën 10.03.2021, është shpallur oferta fituese, operatori M.V në vlerën prej 338,300 lekë pa TVSH.

Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit nr. 2199/2 prot, datë 08.03.2021, operatori M. V është prezantuar me ofertën në vlerën prej 403,375 lekë pa TVSH.

- Procedura e prokurimit me objekt “Blerje goma për automjete” me numrin e referencës REF-00769-12-07-2021 dhe fond limit në vlerën prej 625,000 lekë pa TVSH.

Në SPE, në datën 14.07.2021, është shpallur oferta fituese, OE P.. I... në vlerën prej 459,000 lekë pa TVSH.

Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit nr. 6197/1 prot, datë 09.07.2021 OE P... I... është prezantuar me ofertën në vlerën prej 590,000 lekë pa TVSH.

- Procedura e prokurimit me objekt “*Blerje tonera dhe dramer të ndryshme*” me numrin e referencës REF-13778-02-12-2021 dhe fond limit në vlerën prej 296,340.3 lekë pa TVSH.

Në SPE, në datën 03.12.2021 është shpallur oferta fituese, OE S.. C.. në vlerën prej 293,980 lekë pa TVSH. Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit nr. 9855/2 prot, datë 02.12.2021, OE SINTEZA CO është prezantuar me ofertën në vlerën prej 289,112 lekë pa TVSH.

- Procedura e prokurimit me objekt “*Blerje goma për automjetet*” është kryer në zbatim të Urdhrit të Prokurimit nr. 265 datë 03.11.2022 dhe fond limit në vlerën prej 998,933.3 lekë pa TVSH. Në SPE, në datën 04.11.2022 është shpallur oferta fituese, OE “A.. T...” SHPK në vlerën prej 719,000 lekë pa TVSH.

Në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit nr. 9026/1, datë 26.10.2022, OE A.. T... është prezantuar me ofertën në vlerën prej 1,016,800 lekë pa TVSH. Në zbatim të pikave 1 dhe 3 të Udhëzimit nr. 11 datë 30.05.2018 të Agjencisë Prokurimit Publik, komisioni i prokurimit në vlerë të vogël, ka detyrimin të krahasojë ofertat e paraqitura nga OE^{-kë} në sistemin elektronik të prokurimeve me fondin limit të përcaktuar më parë me qëllim që oferta e OE të jetë sa më reale. Për arsye që, fondi limit të jetë një bazë krahasuese reale, ky fond llogaritet përpara urdhrit të prokurimit dhe i shërben vetëm komisionit të prokurimit. Ofertat e operatorëve fitues, nga dekriptimi në sistemin elektronik, kanë rezultuar në një vlerë më të ulët se ofertat që ata kanë depozituar për llogaritjen e fondit limit, praktika e së cilës është vënë në dispozicion të komisionit të prokurimeve. Pranimi nga ana e komisionit të prokurimeve, të ofertave të operatorëve fitues në SPE, ka sjellë deformimin e procesit të krahasimit të këtyre ofertave me fondin limit, për arsye se këta ofertues kanë ndryshuar praktikisht në të njëjtën kohë të njëjtën ofertë në një vlerë më të ulët. Veprimet e mësipërme të komisionit të prokurimeve të vogla bien në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, neni 63 pika 3, i ndryshuar, dhe në kundërshtim me, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, neni 13 pika 4, neni 79 pika 4. Ekzistenca e 2 ofertave të sipërcituara për OE fitues, për të njëjtën objekt prokurimi dhe praktikisht në të njëjtën kohë, ka sjellë si pasojë deformimin e vlerësimit dhe të konkurrencës gjatë kryerjes së procedurës të prokurimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të sigurohet që proceset e prokurimeve të përfshihen në një manual për prokurimin, me qëllim identifikimin e përgjegjësive individuale, dokumentacionin përkatës të miratuar për hapat e procesit, vendimmarrjen individuale, të drejtat

dhe detyrimet, që duhet të ushtrohen gjatë zbatimit të këtyre procedurave me qëllim orientimin e komisioneve me dispozitat e aplikueshme në kuadrin ligjor dhe rregullator.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Për sa i përket pikës 6, Rekomandimi 6.1 është zbatuar.

Në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në VKM-në Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Nenet 73, 74, 75 janë të mirë përcaktuara rolet dhe përgjegjësitë individuale të komisioneve. Titullari i AK ka vepruar në përputhje me ligjin, udhëzimet dhe manualet përkatëse për prokurimet publike, në të cilat është e parashikuar ndarja ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

7. Gjetje nga Auditimi: Autoriteti Kontraktor (ARRSH) në momentin e hartimit të regjistrave të parashikimit, për përcaktimin e procedurës së blerjes në vlerë të vogël nuk ka marrë parasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, sipas natyrës, sasisë dhe llojit të kontratës, të cilat kanë të njëjtin funksion kryesor apo kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve.

Në 6 raste, gjatë hartimit të regjistrave të parashikimeve në prokurime është evidentuar shmangie nga procedurat përkatëse të prokurimit, duke shkaktuar copëzimin e fondeve apo të kontratave.

-Procedura me objekt prokurimi “Blerje tonera dhe drame të ndryshëm” - tonera për makina fotokopjuese, me fond limit në vlerën prej 800,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.04.2021 dhe realizuar në vlerën prej 699,000 lekë pa TVSH.

Procedura me objekt prokurimi “Blerje tonera dhe drame të ndryshëm” - tonera për printer dhe fax, me fond limit në vlerën prej 361,200 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.12.2021 dhe realizuar në vlerën prej 293,980 lekë pa TVSH.

Të dy procedurat e ngjashme të sipërcituara, gjatë planifikimit rezultojnë së bashku në vlerën 1,161,200 lekë, duke tejkeluar në këtë mënyrë me 161,200 lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.

-Procedura me objekt prokurimi “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore (lyerje ambientesh dhe zyrash, riparime hidraulike etj.)” me fond limit 800,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.04.2021 dhe realizuar në vlerën 276,525 lekë pa TVSH.

-Procedura me objekt prokurimi “Shpenzime për mirëmbajtjen e zyrave të laboratorit të ARRSH (lyerje ambientesh dhe zyrash, riparime hidraulike, elektrike pllakash etj.)” me fond limit në vlerën prej 1,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.07.2021 dhe realizuar në vlerën 780,000 lekë pa TVSH.

Të dy procedurat e ngjashme të sipërcituara, gjatë planifikimit rezultojnë së bashku në vlerën 1,800,000 lekë, duke tejkeluar në këtë mënyrë me 800,000 lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël.

-Procedura me objekt prokurimi “Shpenzime për blerje Software Autocad” me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.12.2022 dhe realizuar në vlerën 959,000 lekë pa TVSH.

-Procedura me objekt prokurimi “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike dhe elektronike” me fond limit në vlerën prej 1,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.10.2022 dhe realizuar në vlerën 915,600 lekë pa TVSH.

Të dy procedurat e ngjashme të sipërcituara, gjatë planifikimit rezultojnë së bashku në vlerën 2,000,000 lekë, duke tejkeluar në këtë mënyrë me 1,000,000 lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël. Nga auditimi, rezultojnë se janë emëruar personat përgjegjës për prokurimin për hartimin e regjistrave të prokurimit, megjithatë mungojnë linja të qarta raportimi,

përfshirje e aktorëve të domosdoshëm, vendimmarrje dhe përgjegjësi të përcaktuara. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 03, datë 08.01.2018, pikat 3, 4, me Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021, pikën 3, në kundërshtim me Vendimin nr. 285 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenin 56, pika 2 dhe 11, duke shkaktuar copëzimin e fondeve apo kontratave, për pasojë kufizimin e procedurave konkurruese të prokurimit. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 285 datë 19.05.2021, neni 56 pika 2 si dhe Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 i APP, pika 3 dhe 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Përputhshmërisë së Standardeve si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Prokurimeve, të merren masat e nevojshme, që në procesin e hartimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve të përfshihen linja të qarta bashkëpunimi, raportimi dhe përgjegjësi të përcaktuara, me qëllim që të shmanget kufizimi i procedurave konkurruese të prokurimit dhe copëzimi i fondeve publike.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Për sa i përket pikës 7, Rekomandimi 7.1 është zbatuar.

Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik është hartuar konform Nenit 3 të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe Udhëzimit nr. 04, datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

8. Gjetje nga Auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se Regjistri i Aktiveve të ARRSH, përfshihen: tag numri, emërtimi, njësia matëse/targa e mjetit, çmimi, gjendja në fund të vitit paraardhës (31.12.2021) e shprehur në sasi dhe vleftë, fletë hyrje dhe fletë dalje (numër, datë, sasia, dhe vlefta), si dhe gjendja në fund të vitit korrent (31.12.2022). Pra në këtë regjistër nuk paraqiten të dhëna lidhur me vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të përditësohet Regjistri i Aktiveve, pasi të jenë kryer vlerësimet lidhur me vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të aktiveve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin financiar.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Në lidhje me rekomandimin e mësipërm ju informojmë:

Për sa më sipër mbështetur në rekomandimin tuaj, ju informojmë se nga ana e Sektorit të Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, (Sektori i Shërbimeve), janë marrë masa lidhur me zbatimin e rekomandimit mbi mënyrën e mbajtjes së regjistrit të aktiveve duke nisur që nga momenti i vënies në dispozicion të informacionit për aktivet lidhur me vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, shërbimet e mirëmbajtjes, me qëllim që nga ana e Sektorit të Financës të bëhet i mundur dhe realizimi i përlogaritjes së vlerës së akumuluar të amortizimit deri në ditën e daljes nga pronësia. Menjëherë për realizimin e këtij rekomandimi DPBF, Sektori i Financës i ka dërguar shkresën Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme për pajisjen me informacionin sipas rekomandimit. (Bashkëlidhur shkresa nr.6187 prot, datë 20.07.2023).

Sektori i Financës, si fillim, ka nisur me përlogaritjen e vlerës së akumuluar të amortizimit të automjeteve dhe inventarit ekonomik, (bashkëlidhur tabela me përlogaritjet), duke u mbështetur në Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 "Tatimi mbi të Ardhurat i ndryshuar", Neni 22 Amortizimi, pika 5 (b) Në rastin kur vlera e mbetur e aktivit në fillim të periudhës tatimore është më e vogël se 10% e kostos historike të këtij aktivit, atëherë kjo vlerë e mbetur njihet tërësisht si shpenzim i zbritshëm i periudhës tatimore, (Ndryshuar me Ligj nr.156/2014, dt.27.11.2014).

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

9. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se lidhur me shitjen e skrapit janë realizuar dy procedura ankandi, të cilat janë anuluar dhe në vijim nga ana e ARRSH nuk janë marrë masa lidhur me kryerjen e mëtejshme të procedurave të ankandit, në mënyrë që të realizohet shitja e skrapit. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pika 109. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Sektori Juridik të marrin masa lidhur me realizimin e procedurës së ankandit lidhur me shitjen e skrapit dhe ndjekjen me përgjegjshmëri të hapave lidhur me plotësimin e dokumentacionit përkatës.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Në lidhje me rekomandimin e mësipërm ju informojmë:

Mbështetur në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar, ju informojmë se realizimi i procedurës së ankandit dhe ndjekja me përgjegjshmëri e hapave lidhur me plotësimin e dokumentacionit përkatës për këtë procedurë nuk është detyrë funksionale e Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit dhe Financës, (Sektorit të Financës), por detyrë funksionale e Drejtorisë Juridike dhe Përputhshmërisë së Standardeve dhe Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme. Drejtoria Juridike dhe Përputhshmërisë së Standardeve me shkresën nr.90/1 prot, datë 08.01.2024 mi ka përcjellë DPFB Urdhër Ankandi nr.03 datë 08.01.2024 “Automjete dhe makineri të tjetërsuara skrap”, sipas shkresës së Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme nr.90 prot, datë 05.01.2024 “Kërkesë për zhvillimin e ankandit”, me vlerë fillestare 2,746,000 lekë me TVSH.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i zbatuar*.

10. Gjetje nga Auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nuk janë evidentuar në kontabilitet “Rrugët dhe rrjetet rrugore”. Për pasojë, nuk ka një vlerë të saktë dhe të drejtë të zërave të mësipërm dhe vlerës së konsoliduar në pasqyrat financiare të shtetit. Deri në fund të vitit 2021 mungon një inventar i plotë e i azhurnuar i rrjetit rrugor, me të dhëna për gjatësinë e rrugëve të përfunduara dhe të kolauduara (me të dhëna të plota mbi gjatësitë, kategoritë e rrugës dhe vlerën kontabël respektive që referuar planit duhej të pasqyroheshin në analiza të veçanta sipas ndarjes së përcaktuar në “Kodin Rrugor Shqiptar”), të analizuara në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 2, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm, Sektori i Financës dhe Sektori Juridik të marrin masa lidhur me realizimin e inventarizimit dhe plotësimin të regjistrit të rrugëve dhe rrjeteve rrugore.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Në lidhje me rekomandimin e mësipërm ju informojmë: Në mbështetje të rregullores së brendshme të ARRSH-se, detyrë funksionale e DPBF është që të rakordojë dhe të kontabilizojë të gjithë akset rrugore që përfundojnë në secilin vit buxhetor, (pa qenë nevoja e

koordinatave, gjatësive dhe kategoritë e rrugës). Përcaktimi i këtyre të dhënave nuk është detyrë e DPBF por e Drejtorive të tjera të ARRSH-se. DPBF, Sektori i Financës, në mbyllje të secilit vit buxhetor, para hartimit të pasqyrave financiare, i kërkon informacion me shkresë, (kopje bashkëlidhur), Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes, për segmentet rrugore të mara përfundimisht në dorëzim. Vlera e këtyre segmenteve rrugore kontabilizohet për çdo vit, në llog. 213, Rrugë dhe Rrjete rrugore.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

11. Gjetje nga Auditimi: Autoriteti Rrugor Shqiptar, në cilësinë e subjektit në favor të së cilit bëhet shpronësimi ka paraqitur pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim kërkesat për shpronësim të cilat janë finalizuar duke u miratuar me Vendime të Këshillit të Ministrave në vlerën 3,312,523,392 lekë, nga të cilat rezulton të jenë shlyer 39 % e kësaj vlere. Diferenca e mbetur e mos likuidimit është për shkak se pronarët e pasurive të shpronësuara nuk kanë depozituar pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar dokumentacioni ligjor për likuidim. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme pronë private për interes publik”, i ndryshuar, neni 190 “Fitimi i pronësisë me anë të shpronësimit”, ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar si dhe VKM nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar, pika 2, 3 dhe 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Nga Sektorit i Financës dhe Sektorit i Sigurimit të Tokës të analizohet situata e mos likuidimit të pronarëve të pasurive të shpronësuara si dhe të merren masa lidhur me likuidimin e tyre.

Menjëherë

Komenti i subjektit: DPBF në çeljen e secilit vit buxhetor i kërkon shkresërisht të gjitha Drejtorive të Arrsh-së dhe DPSO (Sektorit të Sigurimit të Tokës), të sjellin kërkesat për plotësimin e nevojave për fonde buxhetore, (kopje bashkëlidhur). Mbështetur në Rregulloren e Brendshme të funksionit të Autoritetit Rrugor Shqiptar, detyra kryesore funksionale e Sektorit të Financës, lidhur me realizimin e pagesave është:

Kontrolli i dokumentacionit bashkëlidhur pagesave dhe realizimi i tyre brenda afateve kohore të caktuara në përputhje me legjislacionin. Sektori i Financës realizon pagesat në mbështetje të shkresave për pagesë që i vihen në dispozicion nga të gjitha drejtoritë e ARRSH-së që menaxhojnë objekte dhe shërbime me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm dhe nuk përgatit vetë si sektor asnjë praktikë për pagese. E njëjta procedure është dhe për pagesat e shpronësimeve. Sektori i Financës realizon vetëm pagesat që i vihen në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve dhe nuk ka informacion për praktikën që janë në pritje për tu realizuar. Konkretisht lidhur me praktikën e shpronësimit, detyrë funksionale e ndjekjes së gjithë procesit për kontrollin/dorëzimin e dosjeve personale të pronarëve për shpronësim, është e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve, Sektorit të Sigurimit të Tokës. Sektori i Financës me marrjen në dorëzim të praktikës për pagesë vijon me kontrollin e dokumentacionit justifikues dhe më pas me likuidimin në kohë të pagesës për llogari të përfituesve, në zbatim të buxhetit vjetor. Për sa më sipër, ju informojmë së në Sektorin e Financës nuk ka asnjë praktikë shpronësimi për pagesë të pa likuiduar.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

12. Gjetje nga Auditimi: Në regjistrimin e pasurisë së paluajtshme u konstatua se nga ana e strukturave drejtuese të ARRSH, për periudhën objekt auditimi, këto pasuri rezultojnë të regjistruara në mënyrë jo të plotë në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë dhe më pas në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, në kundërshtim kjo me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr. 155, datë 02.03.2011 dhe VKM nr. 3, datë 07.01.2005. Konkretisht rezulton se nuk është regjistruar sipërfaqja totale e Ndërtesës së ARRSH prej 1.379,92 m² por është pasqyruar në kartelën dhe certifikatën e regjistrimit të pronësisë në ZVRPP vetëm 439 m², ose nuk janë regjistruar në kartelat e pronësisë së institucionit 940.92 m². Bazuar në Fletën e Inventarit të hartuar nga Komisioni i Inventarizimit të pasurisë, në inventarin e llog. 212. “Ndërtesa” përfshihen 6 zëra (nga këto, një objekt është godina e ARRSH me përfshirjen e Katiti 2, 3, 4, 5 dhe shtesës) dhe objektit “Laboratori”, me vlerë kontabël prej 3,622,664 lekë. Nga krahasimi i Hartës Treguese dt. 29.01.2019 që shoqëron Vërtetimin e Pronësisë ZVRPP Tiranë të datës 23.04.2019, me Planin e Rilevimit që shoqëron VKM nr. 788, datë 07.10.2020, konstatohen mospërputhje në pasqyrimin e objekteve ndërtimore, si vijon: Në Certifikatën për Vërtetimin e Pronësisë me nr. 1867034, datë 23.4.2019 për ZK nr. 8320, nuk janë pasqyruar dy objektet (objekti “H” sipas Plan Rilevimit që shoqëron VKM nr. 788, datë 07.10.2020, përkatësisht me sipërfaqe 401 m² dhe një shtojcë ngjitur me zyrat 2 katëshe). Për DRV Shkodër: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, nuk është regjistruar pronësia dhe nuk disponohen certifikata për DRV Shkodër nga ZVRPP e përfshira në këtë rajon dhe sipas pasqyrave të inventarit të dërguara në ARRSH shumica e objekteve rezultojnë të dëmtuara. Për DRJ Gjirokastrë: Rezultoni se bazuar në certifikatën e pronësisë sipërfaqja e truallit rezulton 3,556 m², ndërsa sipas VKM nr. 3, datë 07.01.2005 rezultojnë sipërfaqe trualli prej 2,607 m², duke mos patur përputhje të këtyre shifrave dhe arsytet të gjurmës së auditimit për diferencën e sipërfaqes së regjistruar me atë sipas VKM përkatëse. Sipas VKM nr. 789, datë 07.10.2020 është vendosur ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit të kësaj pasurie me sipërfaqe prej 3,556 m² duke kaluar nga ARRSH te DPSHTR. Për objektet e tjera të përfshira në këtë rajon nuk disponohen certifikatat e regjistrimit të pronësisë. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr. 155, datë 02.03.2011 dhe VKM nr. 3, datë 07.01.2005, gjë që tregon për parregullsi dhe pasaktësi dokumentare dhe bën të domosdoshëm rifreskimin e kartelave të regjistrimit të kësaj pasurie si dhe UMF nr. 8, 2018, kreu 3.7, paragrafi 85, në lidhje me shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare vjetore, pasi ato nuk japin informacion të 52 përgjithshëm në lidhje me rakordimet financiare me debitorët dhe kreditorët në lidhje me elementë specifikë të pasqyrave financiare të dorëzuara, etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive Rajonale të marrin masa lidhur me ndjekjen e hapave ligjorë të menjëhershëm për regjistrimin e pasurive të paluajtshme në ZVRPP/ ASHK, me qëllim pajisjen me dokumentacionin e plotë hipotekor.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Në lidhje me rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit konform raportit përfundimtar të auditimit me nr. 1201/19 date 02.08.2023 për periudhën 01.10.2020-21.12.2022, dërguar me shkresë nr. 6558 prot., date 03.08.2023, pika 12.1 për të marrë masa lidhur me ndjekjen e hapave ligjorë të menjëhershëm për regjistrimin e pasurive të paluajtshme në ZVRPP/ASHK, me qëllim pajisjen me dokumentacionin e plote hipotekore, po ju informojmë se Autoriteti Rrugor Shqiptar ka ngritur një urdhër me nr. 77 date 11.04.2023 për ngritjen e komisionit për të bërë

inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri ne regjistrimin e pronave ne regjistrin publik te pasurive te paluajtshme dhe pajisjen me Certifikatë Pronësie për çdo pasuri. Po ju vëmë ne dijeni se grupi i ngritur është duke hartuar një liste përmbledhëse të konsoliduar te aseteve.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i pa zbatuar*.

13. Gjetje nga Auditimi: Sipas programit ekonomik për vitin 2020, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 112 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2020 është realizuar 110 punonjës. Fondi i pagave është 86,968,000 lekë, pra realizimi është 1,617,674 lekë më pak se programi. Sipas programit ekonomik për vitin 2021, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 112 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2021 është realizuar 105 punonjës. Fondi i pagave është 87,029,000 lekë, pra realizimi është 950,930 lekë më pak se programi. Sipas programit ekonomik për vitin 2022, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 117 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2022 është realizuar 108 punonjës. Fondi i pagave është 85,951,461 lekë, pra është realizuar 100 %. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 37 – 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të merren masa për plotësimin e nevojave për punonjës të ARRSH - së referuar parashikimeve të programit ekonomik.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Ndryshimet janë si rezultat i rritjes së pagave nga VKM e miratuara përkatëse.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet si *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

14. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me rekrutimet e punonjësve rezulton se:

- Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punë nga Burimet Njerëzore gjatë periudhës objekt auditimi, janë rekrutuar 24 punonjës, nga të cilët në 15 raste është shpallur vakanca e vendit të punës në faqen web dhe janë kryer procedurat e rekrutimit, pra në 62,5 % të tyre.

- Nga auditimi rezulton se konstatohet se në asnjë rast nuk ka patur konkurrencë, pra ka patur vetëm një kandidat për çdo pozicion pune.

- Gjatë periudhës objekt auditimi në total janë dhënë 39 masa disiplinore, nga këto 28 “Vërejtje”, 4 masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, 1 masë “Kalim në një detyre të një niveli apo klase më të ulët” dhe 6 masa “Pushim nga puna”. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente, pasi nuk ka të dhëna lidhur me mënyrën e marrjes të këtyre masave dhe nuk ka komision apelimi. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr. 136/2015, datë 05.12.2015, neni 11, 12, 37 dhe 37. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 37 – 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj, dhe hartimi dhe miratimi i rregulloreve për emërimin dhe procedurat e lëvizjeve të stafit të ARRSH.

Në vijimësi

14.2 Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies së masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit përkatës të apelimit.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Për sa i përket pikës 13.1, Rekomandimi 14.1, 14.2 është marrë parasysh dhe zbatuar. Në lidhje me procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve në punë dhe hapat që duhen të ndiqen në lidhje me rekrutimin e punonjësve të rinj, janë bërë të gjitha referuar: A. Nenit 17 të Rregullores së Brendshme të Autoritetit Rrugor Shqiptar miratuar me vendim nga Bordi i Menaxhimit Nr.10, datë 04/09/2018. B. Referuar Nenit 17 të Rregullores së Brendshme të Autoritetit Rrugor Shqiptar miratuar me vendim nga Bordi i Menaxhimit Nr.10, datë 04/09/2018 është ngritur 1. Urdhri Nr.204, datë 08/10/2020 për “Procedurën e shpalljes së vendit vakant në faqen zyrtare të Autoritetit Rrugor Shqiptar”, 2. Urdhër Nr.251, datë 11/11/2020 për “Ngritjen e “Komisionit të përzgjedhjes” të kandidatëve për vendet vakante”.

Për sa me sipër procedura e rekrutimit dhe përzgjedhjes është bërë Konform Rregullores së Brendshme të Autoritetit Rrugor Shqiptar, Kodit të Punës, Urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

15. Gjetje nga Auditimi: Sipas DT rezulton se kriteri i përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto duke përdorur sistemin me pikë. Në fakt, referuar nenit 87 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pika 4 citohet se: “Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese ...”. Gjithashtu, referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik1”, neni 45 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese, pika 3 citohet se: “Për punët/mallrat/shërbimet, që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave”. Përzgjedhja e metodës bazuar në kosto nuk është në përputhje me parimet kryesore të Ligjit të Prokurimit Publik. Kjo do të thotë se nga ana e AK do të duhet të ishin përcaktuar vetëm kriteret e veçanta të kualifikimit dhe oferta ekonomikisht më e favorshme të përzgjidhej në bazë të çmimit dhe jo të koston pasi punimet e ndërtimit janë me standarde të njohura kombëtare e ndërkombëtare e përveç çmimit OE pjesëmarrës, praktikisht nuk kanë se me çfarë të konkurrojnë tjetër. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 87, pika 4 si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik1”, neni 45 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 37 – 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH të merren masa të menjëhershme për rishikimin në procedurat e prokurimeve të zhvilluara nga ana e ARRSH, përfshirë ato në proces, të kriterit të vlerësimit të ofertës fituese me pikë si më sipër pasi kjo metodë nuk rrit eficiencën dhe efikasitetin e procedurave, nuk arrin të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale, nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, nuk nxit konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe si e tillë krijon kushte për përdorim pa EEE të fondeve publike.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Për sa i përket pikës 15, Rekomandimi 15.1 është zbatuar.

Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 87 dhe VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, Neni 45, AK ka përzgjedhur ofertën ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto, për garantimin e mundësisë së konkurrencës efektive.

ARRSH në procedurat që do të prokurojë do të marrë në konsideratë dhe do të rishikojë kriteret e vlerësimit të ofertës fituese me pikë dhe do të mirë përcaktojë elementët e nevojshëm për vlerësim në drejtim të cilësisë dhe përvojës, në mënyrë që pikët të jenë të matshme dhe objektive, me qëllim rritjen e eficiencës dhe mirë përdorimin e fondeve publike, shmangien e subjektivizmit, si dhe nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

16. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara rezulton se janë vendosur kritere të paargumentuara teknikisht dhe ligjërisht për sa i takon numrit të punonjësve të kërkuar, numrit dhe kualifikimeve të stafit kryesor teknik dhe atij mbështetës si dhe numrit dhe kapacitetit të mjeteve në disa raste. Konkretisht janë vendosur kritere si më poshtë: *“Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht ... persona.”*

NJP në këtë rast, përveçse ka cituar bazën ligjore (nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”) është shprehur ndër të tjera se: *“Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës ...”* Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht procesverbaleve të argumentimit të kritereve rezulton se nuk ka ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër të punësuarish në lidhje me këtë kontratë pavarësisht faktit nëse ky numër mund të jetë ose jo i mjaftueshëm. *“Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë: .. Kriteri: “Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë: ... Konstatohet se argumentimi i bërë për stafin në cilësinë e drejtuesit teknik është i njëjtë me atë të dhënë edhe për stafin mbështetës (copy – paste) dhe gjithashtu nuk është e argumentuar kërkesa për diferencimin mes stafit të kërkuar si pjesë e licencës së shoqërisë dhe atyre si staf mbështetës me kontratë, jo domosdoshmërisht në licencën e shoqërisë. “Operoret ekonomike duhet te paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ... Në fakt, referuar preventivit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezulton i argumentuar teknikisht në çdo rast domosdoshmëria e disponimit të niveleve të kërkuara të kategorive të licencave. Kriteri: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht procesverbaleve të argumentimit të kritereve rezulton se nuk ka një sqarim konkret për të argumentuar numrin llojin dhe kapacitetet e mjeteve të vendosura.*

Kriteri: “Operatori ekonomik duhet të disponojë programin “PLS CADD and TOWER”, për projektimin e linjave elektrike Në lidhje me këtë kriter NJP nuk ka argumentuar domosdoshmërinë që lidhet me disponimin e këtij programi pasi programi i kërkuar është një software i cili, sipas citimit të bërë nga ana e NJP, është për projektimin e linjave elektrike, kur kontrata në fjalë është e llojit Punë. Kriteri: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: Kriteri: “Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur për QMT, sipas relacionit teknik. Ku përfshihet

edhe qendër monitorimi trafiku (ndërtimi dhe pajisja, kontrolli dhe monitorimi në rrugë, tunele dhe autostrada të kësaj kategorie) të realizuara në një kontratë të ngjashme.” Në fakt vendosja e këtij kriteri është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, neni 39, pika 5 pasi kjo dispozitë ligjore ka parashikuar saktësisht se cilat janë dëshmitë që do të merren në shqyrtim nga Autoritetet Kontraktore për të vlerësuar përvojën e mëparshme. Në lidhje me punët e ngjashme AK duhet të kishte kërkuar të tilla në raport vlerën e parashikuar të kontratës që prokurohet, pra në raport me fondin limit dhe jo për kategori të veçanta zërash në preventiv, apo për një zë i cili sipas relacionit teknik ka një vlerë prej 306,752,162.48 lekë, ose gati 13 % të të gjithë vlerës së parashikuar të kontratës. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti”, pika 1 dhe 2, Neni 2 “Qëllimi”, Neni 3 “Parime të përgjithshme”, Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 1, germa a, b dhe c, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 2 dhe 4 si dhe Neni 39, pika 5, germa a dhe b, Neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 1 dhe 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht si dhe në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, efijencës dhe economicitet.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Për sa i përket pikës 16, Rekomandimi 16.1 është zbatuar.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; Rekomandimit Nr. 1797/1 prot, datë 10.03.2022 “Mbi Hartimin e Kriterëve për Kualifikim për Procedurat e Prokurimit për Mallra, Punë, Shërbime”; Rekomandimit Nr. 3872 prot, datë 10.06.2021 “Mbi hartimin e procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, sjellim në vëmendje se procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim është publikuar në SPE për çdo procedurë prokurimi. Çdo kriter i vendosur në DST është në përputhje me objektin e kontratës dhe i mirë argumentuar nga specialistët e fushës.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

17. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara rezulton se për atë me objekt ‘Ndërtimi i Unazës së jashtme Tiranë, Loti 4’, pavarësisht faktit se BOE i shpallur fitues ka deklaruar në ofertën e tij në SPE se garancia e punimeve do të jetë 3 vite nga data e kolaudimit të punimeve, kontrata e lidhur sipas aktit me nr. 7354/6 prot., datë 11.11.2021, në Kushtet e Veçanta të Kontratës, neni 11 *Garancia e defekteve*, ka cituar se kjo periudhë do të zgjas 2 vite. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 122, pika 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa për modifikimin e kontratës së lidhur sipas aktit nr. 7354/6 prot., datë 11.11.2021, të Kushteve të Veçanta të Kontratës, konkretisht neni 11 *Garancia e defekteve*, duke ndryshuar periudhën e garancisë nga 2 në 3 vite, aq sa ka ofruar fituesi i kësaj procedure BOE E P &U & N... C.....

Menjëherë

Komenti i subjektit: Për sa i përket pikës 17, Rekomandimi 17.1 është zbatuar.

Sqarojmë se në kontratën e nënshkruar nga ARRSH me BOE E P &U & N... C..... shpk, me Nr. 7354/6 prot, datë 11.11.2021 është bërë amendimi i kontratës bazë, në të cilën është saktësuar dhe mirëpërcaktuar Neni 11 i Kushteve të Veçanta “Garancia e defekteve” pika 11.1 e tij. Pra, periudha e garancisë së defekteve do të zgjasë 3 vjet dhe jo 2 vjet. (Bashkëlidhur amendimi me ndryshimin përkatës).

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

18. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e OE fitues rezulton se në 2 raste, konkretisht në procedurat me objekt:

1. Ndërtimi i Unazës së jashtme Tiranë, Loti 2

Nga ana e BOE ..A... & E...K... & I...K... nuk përmbushet kriteri në lidhje me disponimin e licencave sipas përqindjes së punimeve të marra përsipër, kjo pasi sipas kontratës së bashkëpunimit të përkohshëm mes shoqërive me nr. 5428 rep. 1206 kol., datë 15.09.2021, nga ana e OE I... K... janë marrë përsipër të kryhen 95 % e punimeve nën kategorinë e licencës NS-19 *Sisteme kundër zhurmës* për të cilën NJP ka përlllogaritur shumën prej 121,541,840 lekë. Referuar vlerës përkatëse, OE I... K..... i takon një vlerë punimesh prej 115,464,748 lekë ($0.95 \times 121,541,840$), ose kategoria D e licencës NS-19. Në fakt kjo shoqëri disponon kategorinë C të NS-19 e si e tillë kjo kompani nuk përmbush kriterin në lidhje me disponimin e licencës profesionale në raport me punën e marrë përsipër dhe si e tillë duhet të ishte s’kualifikuar.

2. Përmirësimi i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior, Loti 1

Në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues OE J... me të cilin sipas shkresës me nr. 4122/6 prot., datë 31.05.2022 është lidhur kontrata përkatëse e sipërmarrjes së punimeve me vlerë 217,200,000 lekë me TVSH. Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE si dhe atij të ndodhur në dosje, OE D.... është deklaruar si nënkontraktor në fazën e ofertës me një angazhim në drejtim të realizimit të kontratës prej 40 %. Pas shpalljes fitues, me aktin nr. 3558 rep. 1695 kol., datë 20.05.2022 është lidhur kontrata e sipërmarrjes (Kontratë sipërmarrje për kryerje punimesh) mes OE J... dhe OE D.... sipas të cilës palët kanë ndarë mes tyre edhe zërat e punimeve. Nisur nga volumet dhe vlerat përkatëse të punimeve të marra përsipër nga ana e nënkontraktorit të punimeve, rezulton se ky i fundit nuk plotëson kriterin në lidhje me disponimin e licencave sipas zërave respektivë të marrë përsipër në kontratën e sipërmarrjes. Konkretisht OE D... nuk disponon licencën NS-6/D *Sinjalistika rrugore jo ndriçuese*, pasi sipas përqindjes dhe volumeve të marra përsipër rezulton një vlerë në diapazonin e punimeve mes 51,000,000 – 100,000,000 lekë. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 80, “Parimet e procesit të përzgjedhjes”, Neni 3 “Parime të përgjithshme”, Neni 92, “Shqyrtimi i Ofertave”, Pika 3, VKM nr. 285, datë 19.5.2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2, Neni 89 “Nënkontraktimi”, pika 1 si dhe Rregulloren e Përgjithshme të punës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Rekomandimi është i pranuar dhe do të jetë në vëmendje në procedurat në vazhdim.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *në proces zbatimi*.

19. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt *Ndërtim rruga Korçë – Ersekë Loti 2 (pjesa e dytë)*, konstatohet se, me qëllim përmbushjen e kritereve të vendosura, nga ana e OE A...K, në zbatim të nenit 73 *Sistemet e Kualifikimit* si dhe nenit 84 *Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera*, është nënshkruar një marrëveshje me datë 08.04.2022 me shoqërinë B... sipas të cilës OE A...K do të mbështetet në kapacitetin ekonomik dhe financiar të OE B.... pasi ky i fundit ka një xhiro vjetore 2018 – 1,000,278,099 lekë, 2019 – 1,296,437,763 lekë dhe 2020 – 1,254,864,003 lekë. Pra duke qenë se sipas kritereve të AK xhiro mesatare vjetore e OE duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës, pra sa fondi limit ose shuma 2,165,325,695.08 lekë, dhe OE A...K ka një xhiro vjetore 2018 – 1,536,228,476 lekë, 2019 – 1,370,910,610 lekë dhe 2020 – 1,215,643,833 lekë, atëherë, pjesëmarrësi A...K ka përdorur OE B... për të përmbushur kriterin e xhiros vjetore të kërkuar. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE rezulton se OE B...., tek i cili OE A...K ka deklaruar se do të mbështetet në kapacitetet e tij financiare, nuk është dëshmuar për mbështetje në staf teknik, makineri, pajisje, kryerja zërash punimesh. Referuar kuadrit ligjor e rregullator të Prokurimit Publik, operatorët ekonomikë dëshmojnë për kapacitete dhe aftësi të natyrave të ndryshme, të cilat, për ta konsideruar OE të kualifikuar, këto dëshmi duhet të jenë në përputhje me punët/shërbimet/furnizimet e marra përsipër. Thënë sa më sipër OE A...K nuk duhet të mbështetet në xhiron vjetore të OE B.... për sa i takon kapaciteteve ekonomiko-financiar, pasi vet OE B... nuk ka marrë përsipër të kryejë punime. Në interpretim të kuadrit ligjor si më sipër, kërkesat e Autoriteteve Kontraktore vendosen më qëllimin e vetëm që të garantohet se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, pra njohjen e gjendjes financiare e cila çon në një konkluzion mbi mundësinë e përmbushjes ose jo me sukses të kontratës. Pra xhiroja vjetore është një tregues për atë OE që e disponon dhe e përdor për atë pjesë të kontratës që merr përsipër apo tek i cili mund të mbështetet OE pjesëmarrës në procedurë. Praktikisht A...K ka marrë përsipër të kryejë të gjitha punimet e kontratës, duke përdorur xhiron mesatare vjetore të një operatori tjetër ekonomik. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 77 *Kërkesat për kualifikim*, pika 1, germa a, b dhe c, pika 3, VKM nr. 285, datë 19.5.2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, neni 43 *Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*, pika 1, 5 dhe 6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, efizienz dhe ekonomicitet të fondeve.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Rekomandimi është i pranuar dhe do të jetë në vëmendje në procedurat në vazhdim.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

20. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se me Urdhër nr. 169 datë 06.08.2021 është ngritur Grupi i Punës për hartimin e Termave të Referencës (ToR) për Qendrën e Monitorimit të Trafikut (QMT), nga ana e të cilit janë hartuar këto terma, pjesë e dosjes së procedurës së prokurimit. Këto terma referenca i kanë diktuar firmës sipërmarrëse hartimin e detyrës së projektimit në lidhje me këtë qendër monitorimi. Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se vlera e punimeve në shumën prej 368,102,594.97 lekë me TVSH është caktuar pa një referencë konkrete por vetëm (kjo pavarësisht citimit të preventivit ku është shprehur se vlera krahasuese i është referuar projekt zbatimit të tunelit të Llogorasë, seksioni Elektromekanike) duke përfshirë 4 kategori si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Pajisjet E&M, kostot e përgjithshme + Projekt	lump sum	1	34,366,039. ²³	34,366,039. ²³
2	Sistemi i Ventilimit të Tunelit	lump sum	1	90,457,610. ⁷¹	90,457,610. ⁷¹
3	Sistemet mekanike	lump sum	1	24,228,992. ³¹	24,228,992. ³¹
4	Sistemi Elektrik	lump sum	1	157,699,520. ²³	157,699,520. ²³
SHUMA					306,752,162.⁴⁸
TVSH					61,350,432.⁵⁰
TOTAL					368,102,594.⁹⁷

Në këtë rast AK ka përzgjedhur *Kontratë për punë publike* dhe mënyra e prokurimit ka qenë *Punime me matje* dhe jo *Kontratë me çelësa në dorë* e për këtë arsye nuk duhet të ishte përfshirë në këtë kontratë edhe projektimi i kategorive si më sipër nga ana e sipërmarrësit. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik1’, neni 12 *Metoda të zbatueshme në përlllogaritjen e vlerës së kontratës*, pika 4, Neni 13 Studimi paraprak i tregut, Neni 39 *Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*, pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa, për ato raste në të cilat për reference merren kontratat e mëparshme, që përlllogaritja e vlerës së fondit limit të investimeve të kryhet bazuar në zërat konkretë të këtyre praktikave të mëparshme dhe jo në kategori preventivash pasi kategorizimi nuk përshkruan saktë zërat konkretë që përfshin.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Bëjmë me dije se DPSO, për Llogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratave me çelësa në dorë mbështetet në eksperiencën të ngjashme referuar preventivave të këtyre kontratave të realizuara. Përgatitja e preventivit me kategorizim bëhet për arsye se në këto kontrata një element i preventivit të kategorizuar është dhe hartimi i projekt-zbatimit nga operatori që do dalë fitues në garën e prokurimit që zhvillohet. Ndaj bazuar ligjit të prokurimit publik grupi i punës harton një vlerë paraprake me zëra punimesh sipas preventivit të kontratës së ngjashme që shërben si argumentim i fondit limit. Ky preventiv paraprak nuk mund të shërbejë si preventiv i fondit limit, për sa në dokumentet e prokurimit është kërkuar të hartohet projekt-zbatimi.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *në proces zbatimi*.

20.2 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa për të identifikuar dhe ndjekur saktë rastet në të cilat duhen ndjekur metoda e prokurimit *Punime me matje* apo *Kontratë me çelësa në dorë* me qëllim realizimin e një procedure prokurimi efikase.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Bëjmë me dije se DPSO, për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ekonomik për procedurë prokurimi Kontratë me çelësa në dorë vepron bazuar në një urdhër me shkrim. Por do të merret në konsideratë rekomandimi i sipërcituar nga KLSH, duke trajtuar problematikën me Drejtorinë Juridike, si përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *në proces zbatimi*.

21. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit dhe të zbatimit të kontratës me objekt *Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja – Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT*, në përfundim të procedurës është shpallur

fitues OE S..... me të cilin sipas aktit nr. 9729/7 prot., datë 24.12.2021 është lidhur kontrata përkatëse e punimeve me Titullarin e AK me vlerë të kontratës 2,736,853,766 lekë me TVSH. Nga ana e Titullarit të AK janë caktuar mbikëqyrësit e punimeve z. G.N. me nr. licence MK.2352/1 dhe znj. D.S. me nr. licence MK.0910/2. Në fakt rezulton se nga ana e inxhinierëve të caktuar nuk disponohen disa prej kategorive të licencës NP-12 *Punime inxhinierike mjedisore*, NS-5 *Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut*, NS-12 *Pajisje termike, teknologjike dhe të kondicionimit*, NS-13 *Pajisje të linjave telefonike dhe telekomunikacionit*, NS-14 *Pajisje të brendshme, elektrike, të telefonisë, radiotelefonike, televizive*, dhe NS-18 *Punime topogjeodezike*. Me shkresën e administruar në ARRSH me nr. 11742/2 prot., datë 30.12.2021 nga ana e sipërmarrësit të punimeve është njoftuar fillimi i punimeve në datën 24.12.2021. Sipas korrespondencave rezulton se në datën 24.12.2021 është bërë akti i dorëzimit të sheshit (i cili ka rezultuar pjesërisht i lirë në momentin e dorëzimit të tij), është mbajtur akti i piketimit të objektit si dhe procesverbali i fillimit të punimeve. Këto tre akte rezultojnë të jenë firmosur nga ana e përfaqësuesit të AK znj. A.S, nga ana e mbikëqyrësit të përkohshëm z. G.N, sipërmarrësi i punimeve z. L.S si dhe Drejtuesi Teknik i OE S..... z. T.B. Sipas aktit me nr. 769/2 prot., datë 09.03.2022 është lidhur kontrata e Shoqëriat të mbikëqyrjes së punimeve me OE A... E... me përfaqësues ligjor znj. E.Ç me vlerë të kontratës 21,600,000 lekë me TVSH. Sipas shkresës nr. 9729/7 prot., datë 28.12.2021 i është dorëzuar nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes Plani i Zbatimit të Kontratës Drejtorisë Juridike dhe Përputhshmërisë së Standardeve. Sipas raporteve mujore të hartuara nga ana e mbikëqyrësit të punimeve rezulton se nga ana e OE S..... nuk është angazhuar si drejtues teknik ing. T.B, sipas deklaratës së bërë në zbatim të kërkesës 2.3.7 të DT por është vendosur ing. T.M. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 87, pika 4. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa për përzgjedhjen në cilësinë e mbikëqyrësve të përkohshëm të kontratave të punimeve të atyre punonjësve të cilët disponojnë të gjitha kategoritë dhe nivelet e nevojshme të licencave për të realizuar një shërbim efektiv dhe të plotë, në përputhje me nevojat që dikton edhe natyra e investimeve.

Në vijimësi

21.2 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa për tu siguruar se nga ana e sipërmarrëse janë angazhuar mjete dhe staf sipas deklarimeve të bëra nga ana e OE gjatë fazës së ofertimit. Zëvendësimet e tyre të shoqërohen me dokumentacionin e nevojshëm e të mjaftueshëm justifikues, duke siguruar kështu edhe një gjurmë të mjaftueshme auditimi.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Për sa i përket pikës 21, Rekomandimi 21.1 është zbatuar dhe do të mbahet në konsideratë në vijimësi. AK në përzgjedhjen e mbikëqyrësve të përkohshëm të punimeve / punonjës, të cilët disponojnë të gjitha kategoritë dhe nivelet e nevojshme të licencave ka vepruar në përputhje me VKM Nr. 943, datë 28.12.2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 759, datë 12.11.2014 "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim". Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, konform raportit përfundimtar të Auditit nr. 1201/19 date 02.08.2023 për periudhën 01.10.2020-21.12.2022, dërguar me shkresën nr. 6558 prot., datë 03.08.2023, i bëjmë me dije Kontraktorit, por i kërkojmë mbikëqyrësit të punimeve që gjatë fazës së zbatimit të plotësohen me rigorozitet dhe përgjegjësi të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me shtojcat e DST-ve që janë plotësuar gjatë fazës së ofertimit dhe të reflektohen në dokumentacionin e përpiluar nga mbikëqyrësi i punimeve.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

22. Gjetje nga Auditimi: Në rregulloren e brendshme të institucionit, rregullat apo proceset kryesore të përfshira janë ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësive, por ato nuk përshkruajnë me detaje proceset, rrjedhën dhe identifikimin e punës, përgjegjësinë individuale, afatet e kryerjes, vendimmarrjen individuale, dokumentacionin e miratuar, si edhe veprimtaritë e kontrollit të nevojshme. Nga auditimi ka rezultuar se, me përjashtim të Drejtorisë Planifikimit të Buxhetit dhe Financës, manualët për proceset kryesore në sektorët dhe drejtoritë e ARRSH janë akoma në proces hartimi. Qeverisja e ARRSH përfaqëson mënyrën me të cilën ajo drejtohet dhe kontrollohet, por nga auditimi rezulton se Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk ka funksionuar mjaftueshëm, mungojnë minutat e takimit, vendimet dhe raportet, të cilat duhet t'u vihen në dispozicion stafit menaxhues të njësisë publike. Regjistri i riskut është rishikuar çdo vit, por nga auditimi formularëve të plotësuar të regjistrit të riskut ka rezultuar se nuk bëhet dallimi i riskut të mbetur nga ai i qenësishmi (i natyrshëm), dhe se menaxhimi i riskut nuk kryhet në mënyrë sistematike, apo periodike gjatë vitit. Gjithashtu, ka rezultuar se regjistri nuk është plotësuar korrekt, p.sh. kur niveli i riskut nuk ndryshon dhe mbetet i lartë nuk kërkohet marrja e masave të kontrollit, apo kur niveli i riskut ulet kërkohen në mënyrë të panevojshme masa të tilla. Proceset kryesore sipas objektivave, me qëllim adresimin e risqeve, duhet të vendosin “pronarët” e proceseve të punës, dhe jo Drejtorin e Përgjithshëm si “pronar” të tyre. Topologjia e riskut nuk është e plotë dhe e qartë, risqet e brendshme duhet të lidhen më shumë me planifikimin, proceset operacionale, burimet njerëzore (kapacitetet e nevojshme), anën ligjore të mbikëqyrjes (ndarjen e detyrave, caktimin e përgjegjësive për punën e secilit punonjës). Në rregulloren e brendshme të ARRSH nuk janë përfshirë mjaftueshëm veprimtaritë e kontroleve parandaluese, për shkak se rregulloret nuk përshkruajnë me detaje proceset.

Gjithashtu, veprimtaritë e kontroleve menaxheriale të pamjaftueshme kanë sjellë mungesën e përgjegjësive të përcaktuara menaxheriale, siç është rasti i mungesës së marrëveshjes në zbatimin e programit “Për transportin rrugor” ndërmjet ARRSH dhe ministrisë përgjegjëse MEI. Për sa më sipër, për pasojë rezulton në një nivel i pamjaftueshëm implementimi i sistemit financiar dhe kontrollit (MFK). Sa më sipër është në kundërshtim me ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 20, pika 2 shkronja c, neni 21 pika 1, neni 27, ligjin nr. 10 164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, neni 6 pika 2 si dhe me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Manuali për MFK”, pika 2.2.6, dhe pika 2.1 “Përgjegjësia menaxheriale”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 65 – 68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, në cilësinë e nëpunësit autorizues, të marrë të gjitha masat e nevojshme për rishikimin e rregullores së brendshme, në të cilën të përfshihen me detaje proceset kryesore të veprimtarisë së ARRSH dhe me këtë rast, veprimtaritë e domosdoshme parandaluese të kontrollit. Gjithashtu, të marrë të gjitha masat e nevojshme për funksionimin e një sistemi të shëndoshë financiar dhe të kontrollit, duke siguruar menaxhimin sistematik të risqeve që cenojnë veprimtarinë e ARRSH, si edhe funksionimin sistematik dhe të nevojshëm të grupit të menaxhimit strategjik (GMS).

Në vijimësi

22.2 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, të marrë të gjitha masat e nevojshme për krijimin dhe funksionimin e marrëveshjes me ministrinë e linjës MEI, për administrimin e programit “Transporti Rrugor”, me qëllim përcaktimin e përgjegjësive përkatëse menaxheriale të secilit institucion pjesëmarrës.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Me miratimin e ligjit të ri të ARRSH-së jemi duke bërë ndryshime me qëllim përcaktimin e përgjegjësiave përkatëse menaxheriale të secilit institucion pjesëmarrës.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe pa zbatuar*.

23. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezulton se Njësia e Auditit të Brendshëm nuk funksionon në mënyrë të decentralizuar si një veprimtari e pavarur funksionalisht dhe është pjesë përbërëse e ekzekutivit në formën e sektorit dhe në varësinë e drejtorit të përgjithshëm të ARRSH, i cili miraton planin e angazhimeve të AB. Misioni i AB është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë publike, në mënyrë të pavarur dhe objektive për sistemin e kontrollit të brendshëm. Auditimi i brendshëm, duke qenë një strukturë e varur nga Drejtori i përgjithshëm brenda ekzekutivit të ARRSH nuk arrin të kryejë një aktivitet të pavarur dhe objektiv, që jep siguri dhe këshilla, si dhe për t'i shtuar vlerë operacioneve të njësisë publike. Gjatë angazhimeve për zbatimin e rekomandimeve nuk kemi reagime nga subjekti i audituar. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 4 pika 22, ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 4 pika 19, si dhe me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave “Manuali për MFK”, pika 2.2.10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 65 – 68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, të marrë të gjitha masat e nevojshme për kalimin e auditit të brendshëm jashtë strukturës ekzekutive të ARRSH, me qëllim sigurimin e funksionit të decentralizuar të auditimit të brendshëm, si një veprimtari e pavarur funksionalisht dhe që raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Bordi.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Do të kemi në vëmendjen me miratimin e strukturës së re të ARRSH-së.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i pa zbatuar*.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Në objektin “Ndërtim Rruga mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij” sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe OE A...B me nr. 1130 prot. datë 03.02.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me 1,402,652,826 lekë pa TVSH ose 1,683,183,392 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 15 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës nr. 3091/2 prot. datë 18.03.2022, deri më 02.11.2022 (kontratë në proces), nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht:

Projekti fillestar;

Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);

Pagesat pjesore nga Situacioni nr. 1 deri Situacioni nr. 4;

Librezat e masave pjesore deri në situacionin përmbledhës nr. 4;

Ndryshimet e miratuara me Vendimet e Këshillit Teknik;

Korrespondencat mes Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe Kompanisë konsulete që kryen supervizionimin BOE “P.....C” sh.p.k & E.... C.... G....” sh.p.k & “E...G” sh.p.k & “I.....” sh.p.k. si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt në shumën prej 12,131,741 lekë pa TVSH në 3 zëra punimesh të përshkuara në Akt konstatimin Nr. 21. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3, Kontratën e

Shoqëriat e lidhur midis ARRSH dhe BOE "P.....C" sh.p.k & E.... C.... G...." sh.p.k & "E...G" sh.p.k & "I....." sh.p.k me nr. 301/2 prot. datë 03.02.2021 me objekt: "Supervizion Punimesh, Ndërtim Rruga mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij" Neni 7 pika 1 "Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktorit". (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: ARRSH në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës 12,131,741 lekë pa TVSH që përbën dëm ekonomik, në situacionet pasardhës deri në atë përfundimtar, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve OE A..... B...., me të cilin është lidhur kontrata nr. 1130 prot., datë 03.02.2021 për zbatimin e punimeve.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Pas verifikimit të librezave të masave, në kategorinë A-1, zëri A 1.6 "Transport materiale inerte dhe dheu me auto deri 10.0 km" për të cilin i referohen grupi auditues, ju bëjmë me dije se ky volum, ashtu siç ka sqaruar edhe mbikqyrësi i Punimeve në observacionin e tij është zbritur në kategorinë e zërit A-2.3 "Transport materiale inerte dhe dheu me auto deri 10.0 km". Cmimi njësi për zërat A-4.6 dhe, 4.2.3 "Transport materiale inerte dhe dheu me auto deri 10.0 km është 1250/m³, i njëjtë në të dy rastet. Sa më sipër nuk është paguar më tepër, pasi volumi "Transport materiale inerte dhe dheu me auto deri 10.0 km është zbritur në librezën e masave si dhe reflektuar në situacionin e punimeve.

Po kështu edhe zëri 2.1 "Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, 0.25 m³, në kanale gjerësi 2 m, tokë zak, kategoria III, me shkarkim në mjet", është pasqyruar volumi i skarifikimit në fund të volumit total për t'u zbritur nga volumi total i gërmimeve. Nga Llogaritjet sipas librezës së masave, volumi total i punimeve të realizuara në zërin A 2.1 "Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, 0.25 m³, në kanale gjerësi > 2 m, tokë zak, kategoria III, me shkarkim në mjet", është 80,499.98m³. Referuar gjetjeve të grupit auditues, volumi i zërit të mësipërm rezulton të jetë 75.359,10 m³. Nga ana e mbikqyrësit të punimeve, në situacionin e punimeve nr.4, janë situacionuar vetëm 70.069.00 m³, i cili është një volum akoma më i vogël sesa ai i realizuar nga subjekti sipërmarrës. Nga sa më sipër arrijmë në konkluzionin se në objektin "Ndërtim Rruga mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij" nuk ka diferenca volumesh të paguara nga dy herë ose më shumë se fakti. Për çdo rast Sipërmarrës i punimeve "A.....B..." sh.p.k. ka zbatuar Projekt- Preventivin e këtij objekti.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër dhe dokumentacionit të vendosur në dispozicion rekomandimi konsiderohet si *i pranuar pjesërisht dhe i pa zbatuar*.

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi, duke ju referuar vendimeve të Gjykatave, ARRSH rezulton të jetë palë debitore në 18 raste me subjekte të ndryshme në vlerën **373,116,044 lekë**. Në dy nga këto raste, nga ana e debitorëve është vendosur urdhër sekuestro në llogaritë e Thesarit me vlerën 41,942,661 lekë. Sa më sipër, situata e krijuar lidhur me detyrimet ndaj palëve të treta dhe urdhër sekuestrot e llogarive të Thesarit, rrezikojnë performancën e ARRSH, përmbushjen e funksioneve primare, pagesën e punonjësve e të detyrimeve të tjera, në kushtet e bllokimeve të vazhdueshme të llogarive të saj, gjë e cila mund të rezultojë në pezullim të detyrimeve operacionale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Financës të analizojnë efektin financiar negativ me vlerë **373,116,044 lekë**, shkaqet të cilat kanë sjellë këtë situatë dhe të marrin masa

lidhur likuidimin e këtyre detyrimeve, të cilat sjellin si pasojë sekuestrim të llogarive thesarit të ARRSH.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Në lidhje me rekomandimin e mësipërm ju informojmë:

Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës, me Aktin Normativ nr.6, datë 14.12.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, ka planifikuar likuidimin e të gjithë detyrimeve të prapambetura të krijuara për vitin 2023, ku përfshihen dhe zëri Vendime Gjyqësore në proces.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se procedura e largimeve nga puna është e parregullt, konstatim ky i cili mbështetet edhe nga argumentimi si më poshtë. Konkretisht rezulton se në proceset gjyqësore në të cilat ARRSH është palë, për periudhën objekt auditimi janë në proces 7 çështje gjyqësore Gjykatën e Shkallës të Parë Tiranë dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku 4 çështje janë humbur dhe 3 janë në proces. Për periudhën objekt auditimi, lidhur me këto procese ARRSH ka paguar ish – punonjësit e saj në vlerë prej **3,233,034 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore, duke shkaktuar kështu efekt financiar negativ. Sa më sipër është në kundërshtim me ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr. 136/2015, datë 05.12.2015, neni 155. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 37 – 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria Juridike dhe Përputhshmërisë së Standardeve dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të Autoritetit Rrugor Shqiptar, të merren masa për analizimin e efektit negativ në vlerën **3,233,034 lekë** dhe për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për ARRSH.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Ky efekt ka qene i kohes te meparshme, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur largime nga puna .

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

3. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës të tipit *Me çelësa në dorë* me objekt *Stabilizimi i qëndrueshmërisë të trupit të rrugës në aksin rrugor Vlorë – Orikum (zona Jonufër – Nimfa)*, të lidhur mes ARRSH si Autoritet Kontraktor dhe BOE G..... & G....L.... sipas shkresës me nr. 5002/8 prot., datë 03.06.2021, rezulton se nga krahasimi i zërave të likuiduar e me ato të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave paraqite diferenca në volume me pasojë përdorim pa efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet fondet në shumën prej 10,376,373.5 lekë pa TVSH si rrjedhojë e përdorimit të çmimeve të preventivit të hartuar nga ana e projektuesit mbi ato të parashikuara nga manuali teknik i çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi dhe/apo punimeve të pakryera në fakt. Gjithashtu, konstatohet se projekti i hartuar nga ana e projektuesit të kontraktuar nga BOE G..... & G....L.... nuk i është referuar parashikimeve ligjore në drejtim të hartimit të preventivit të punimeve. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5/1, pika 1, pika 3, neni 7/1, neni 12, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin

e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat 3.2 dhe 3.3 si dhe Kreu II, Pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH, në rastet e kontratave të llojit *Me çelësa në dorë*, përpara miratimit të projektit nga ana e institucioni, të merren masat e nevojshme për respektimin, nga ana e projektuesve të të gjitha detyrimeve që parashikon kuadri ligjor e rregullator i projektimit, kjo me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe economicitet i fondeve.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Rekomandimi është i pranuar nga ana jonë dhe do të kihet parasysh në procedurat në vashdim.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

4. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës të tipit *Me çelësa në dorë* me objekt *Rrëshqitje e Borshit” Kontratë me çelësa në dorë*, të lidhur mes ARRSH si Autoritet Kontraktor dhe OE G.... sipas shkresës me nr. 3731/5 prot., datë 28.05.2021, rezulton se nga krahasimi i zërave të likuiduar e me ato të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave paraqiten diferenca në vlerë me pasojë përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe economicitet fondet në shumën prej 82,030,528 lekë pa TVSH si rrjedhojë e çmimeve ndryshe nga sa ka parashikuar manuali teknik i çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi në momentin e realizimit të kontratës dhe/apo punimeve të pakryera në fakt. Sipas evidencave konstatohet se projekti nuk është i miratuar nga ana e projektuesit C... C... pasi nuk është i sigluar dhe nuk ka emrat e hartuesve të tij por vetëm atë të OE G.... Nga një analizë e preventivit të ndodhur në dosje vërehet se zërat janë paraqitur me çmime. Nga krahasimi i preventivit të përdorur nga ana e punonjësve të ARRSH për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit dhe atij të hartuar nga ana e sipërmarrësit të punimeve rezulton se dokumenti i parë, i hartuar nga ana e BOE EK & I.....S, ka parashikuar volume pune për një gjatësi shkarjeje prej 50 ml dhe dokumenti i dytë për një gjatësi prej 84 ml, por në këtë të fundit një pjesë e volumeve janë në sasi më të vogla duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të ofrohet një projekt preventiv me çmime më të larta për njësi duke rritur kështu koston totale. Konkretisht, rezultatet nga auditimi i ndryshimeve të vlerave për çdo kategori punimesh pasqyrohen më të detajuara në Aneksin nr. 3.3.

OE G...., në këtë rast:

1. Nuk ka hartuar projektin sipas parashikimeve dhe deklarimeve të bëra në fazën e zhvillimit të procedurës (hartimin e projektit të zbatimit nga ana e shoqërisë C... C...) e duke sigluar një projekt preventiv jo sipër licencave që disponon për projektim punimesh ndërtimi;
2. Nuk ka hartuar projekt-preventivin e punimeve të zbatimit në përputhje me kuadrin ligjor që disiplinon punimet e ndërtimit, këtë përmes heqjes nga preventivi të shumë zërave dhe kalimit të shumës korresponduese në zëra të tjerë me çmime shumë herë më të larta se ato që parashikon VKM përkatëse;

Rezultatet e efektit financiar pasqyrohen në Aneksin nr. 3.4. Ky projekt preventiv i është nënshtruar oponencës teknike nga ana e Institutit të Ndërtimit i cila ka kthyer përgjigje sipas shkresës së administruar në ARRSH me nr. 7668 prot., datë 25.08.2021 e më pas projekti ka marrë miratimin përmes VKT nr. 32 me nr. 7668/1 prot., datë 30.08.2021. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5/1, pika 1, pika 3, neni 7/1, neni 12, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për

mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat 3.2 dhe 3.3 si dhe Kreu II, Pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH, në rastet e kontratave të llojit *Me çelësa në dorë*, përpara miratimit të projektit nga ana e institucioni, të merren masat e nevojshme për respektimin, nga ana e projektuesve të të gjitha detyrimeve që parashikon kuadri ligjor e rregullator i projektimit, kjo me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe economicitet i fondeve.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Rekomandimi është i pranuar nga ana jonë dhe do të kihet parasysh në procedurat në vazhdim.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi.*

5. Gjetje nga Auditimi: Në objektin *“Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rreth rrotullimi Shqiponja Loti 1”* sipas kontratës të lidhur midis ARRSH dhe S..... & B... me nr. 5469/7 prot., datë 22.10.2019 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 1,776,111,282 lekë pa TVSH ose 2,129,438,058 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 24 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës nr. 9300/2 prot., datë 15.10.2021, deri më 16.04.2022, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht:

- *Projekti fillestar; Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit); Pagesat pjesore nga Situacioni nr. 1 deri Situacioni nr. 16; Librezat e masave pjesore deri në situacionin përmbledhës nr. 16 ; Ndryshimet e miratuara me Vendimet e Këshillit Teknik; Korrespondencat mes ARRSH dhe Kompanisë konsulente që kryen supervizionimin OE A ... E E.....*

si dhe nga verifikimi i kryer në terren rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt në vlerën 8,490,090 lekë pa TVSH në 3 zëra punimesh të përshkruara në Akt konstatimin nr. 22. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat 3.2 dhe 3.3, Kontratën e Shoqëriat e lidhur midis ARRSH dhe OE A ... E E..... me nr. 2128/5 prot., datë 24.06.2019 me objekt: *“Supervizion Punimesh, Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rreth rrotullimi Shqiponja Loti 1”*, Neni 7 pika 1 *“Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktorit”*.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39 – 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: ARRSH në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të verifikojnë dokumentacionin e plotë të dosjes teknike si dhe punimet faktike të realizuara në terren për volumet e përmendura, në kontratën e sipërmarrjes së punimeve të lidhur mes BOE *“S.....” sh.p.k* & *“B...” sh.p.k* sipas aktit me nr. 5469/7 prot. datë 22.10.2019, për zbatimin e punimeve civile.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Objekti *“Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta- rreth rrotullimi Shqiponja, Loti 1”* është kolauduar më datë 15.04.2022. Dosjet teknike të dorëzuara nga Mbikëqyrësi i punimeve në të cilat paraqiten volumet e realizuara dhe proces verbalet e punimeve të maskuara (që janë referenca për to) janë në përputhje me librezat e masave dhe punimeve në terren. Bashkëngjitur Proces-Verbali i Kolauditimit i objektit.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i zbatuar.*

E. MASA DISIPLINORE

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 - Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe Kontratës kolektive për punonjësit e ARRSH, kërkojmë nga Drejtori i Përgjithshëm fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore për punonjësit të cilët janë konstatuar me shkelje nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Komenti i subjektit: Rekomandimi është marrë parasysh është tërheq vëmendje punonjësve në mënyrë verbale.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i pa zbatuar*.

2.1. AUDITIM I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE NË SUBJEKTIN AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR, PËR PROJEKTIN “MIRËMBAJTJE DHE SIGURI RRUGORE BAZUAR NË REZULTATE”.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Autoritetin Rrugor Shqiptar** me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023”, konkretisht për zbatimin e rekomandimeve të lënë në auditimin e projektit “*Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate*” për periudhën objekt auditimi nga fillimi i projektit – 31.03.2022, të përcjella në subjekt me shkresën Nr.827/19 prot. datë 02.06.2023.

Në subjekt u mbajt Akt Verifikimi nr. 2, datë 31.01.2024, administruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar me nr. 18/4 prot, datë 31.01.2024, për të cilin nuk është paraqitur observacion nga ana e subjektit. Pas dërgimit të Projektraportit të Auditimit, nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observacione.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

-Në zbatim të neni 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Autoriteti Rrugor Shqiptar nuk ka respektuar këtë afat pasi nuk ka kthyer përgjigje.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, në kundërshtim me në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

“*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*”.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr.827/19 prot. datë 02.06.2023, administruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar me nr. 4831 prot. datë 06.06.2023, janë rekomanduar gjithsej:

a. 12 masa organizative;

b. 2 masa për shpërblim dëmi në vlerën 68,960 Euro;

c. 2 masa për përdorimin të fondeve publike jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit në shumën 783,875.77 Euro;

d. masa disiplinore për largim nga puna por ato janë të ezazuara pasi personat nuk janë më në marrëdhënie pune.

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr.827/19 prot. datë 02.06.2023 dhe në Autoritetin Rrugor Shqiptar me Nr. 6558 Prot. datë 03.08.2023, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar (nga ARrSH)	Pa pranuar
1	Organizative	12 masa	12 masa	-
2	Shpërblim dëmi	2 masa 68,960 Euro	2 masa 68,960 Euro	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	2 masa 783,875.77 Euro	2 masa 783,875.77 Euro	-
4	Masa Disiplinore	-	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmblëdhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	12 masa			12	
2	Shpërblim dëmi	2 masa 68,960 Euro	-	-	-	2 masa 68,960 Euro
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	2 masa 783,875.77 Euro	-	-	2 masa 783,875.77 Euro	-
	Masa Disiplinore	-	-	-	-	-

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 1047/1 Prot. datë 29.12.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. S.H, (Përgjegjës grupi)
2. E.K

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr.827/19 Prot. datë 02.06.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Autoriteti Rrugor Shqiptar, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr.825/15Prot. datë 03.05.2023, rezulton se nga **16** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi dhe 3-E, disiplinore*), janë pranuar nga subjekti **16** masa ose 100 %. **Nga të pranuarat** nuk është zbatuar plotësisht asnjë masë, janë në proces zbatimi **14** masa ose 88%, nuk janë zbatuar **2** masa ose 12 % e masave të rekomanduara.

Nga sa shikohet niveli i realizimit është në masën 0 %, kurse ai i atyre në proces zbatimi 88%, gjë e cila tregon se Autoriteti Rrugor Shqiptar nuk e ka vlerësuar si duhet procesin e zbatimit të rekomandimeve, si dhe domosdoshmërinë që ka ndjekja e procedurave për zbatimin e rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, përfundimi i atyre në proces si dhe marrja e masave të nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	12 masa			12	
2	Shpërblim dëmi	2 masa 68,960 Euro	-	-		2 masa 68,960 Euro
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	2 masa 783,875.77 Euro	-		2 masa 783,875.77 Euro	
4	Masa Disiplinore	-	-	-	-	
5	Gjithsej	16 masa 842,835.77 Euro				

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 0 %, kurse ai i atyre në proces zbatimi 88%, nivele këto të cila tregojnë vlerësimin jo si duhet të këtij procesi si dhe domosdoshmërinë që ka ndjekja e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, përfundimi i atyre në proces si dhe nisja e hapave të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.
 -Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Autoriteti Rrugor Shqiptar, nuk ka respektuar këtë afat pasi nuk kthyer përgjigje.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”,

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetja nga auditimi: Në marrëveshjen e huasë, viti i fillimit të Projektit (viti 1) do të ishte viti 2016 dhe viti i përfundimit (viti 5) do të ishte viti 2021 por konstatohet se periudha kohore e fillimit është viti 2017 dhe jo ai i parashikuar në marrëveshje. Kjo shtyrje ka ardhur si rezultati i vonesave të procesit të prokurimit, lidhjes të kontratave (në janar dhe shkurt të vitit 2017), mos njohja e disa komponentëve të projektit nga palët, të cilat kanë sjell disbursimin e vlerat e parashikuara në këtë marrëveshje me vonesë. Bankës Botërore, me shkresën datë 29.03.2021 “Amendimi i marrëveshjes së huasë”, amendimet konsistuan në konsiderimin e vitit 1 të periudhës 10 mujore duke filluar nga Marsi 2017 e deri në 31 Dhjetor 2017 dhe data e përfundimit të Projektit është 31 Dhjetor 2022. Shuma origjinale e kontratës ishte në vlerën 70,486,573.71 Euro, e cila pas rishikimeve të kontratës arriti në vlerën përfundimtare 85,651,671.08 Euro. Referuar përcaktimeve të Marrëveshjes, problematikat e krijuara gjatë realizimit të këtij Projekti mund të sillnin për pasojë anulimin ose rialokimin e shumës të përcaktuar për kategorinë 1 “*Mallra, punime, shërbime të konsulentëve dhe trajnim për pjesët 1 dhe 2 të Projektit*” në një kategori më poshtë, pra shërbime konsulence dhe kosto operative, duke mos realizuar objektivat dhe qëllimet kryesore të Projektit. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligji nr. 71, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”, seksioni IV, pika B, 4d. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 16-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: ARRSH në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (ministra e linjës) dhe Ministrinë e Financave (si përfaqësuese e huamarrësit) të marrin masa që të bashkërendojnë punën dhe në çdo rast të kryejnë kërkesat për amendimin e marrëveshjeve të huave brenda afateve të marrëveshjeve duke ulur riskun e ndërprerjes së financimit.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Nga ana ARrSh rekomandimi është referuar edhe në ministrinë përkatëse që të kihet parasysh në kontratat e ardhshme me financim të huaj.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

2. Gjetje nga Auditimi: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u konstatua janë larguar nga puna Menaxheri i Projektit dhe Specialistja e Menaxhimit Financiar. Në datën 28.02.2018 është pushuar nga puna Menaxheri i Projektit me motivacion performancë e dobët gjatë ushtrimit të detyrës, pasi me shkresën nr. 9168/2 prot, datë 06.12.2017 “Kërkesë zyrtare për dorëheqje” nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH, i është kërkuar Menaxherit të Projektit dorëheqja zyrtare. Pas Largimit nga detyra Menaxheri i Projektit ka hapur proces gjyqësor kundër ARRSH për pushim të padrejtë nga detyra. Me vendim nr. 6086, datë 05.07.2018 Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë dhe dëmshpërblimin e paditësit me dyzetë e dy paga (42*1.500=63.000 Euro). Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e

Apelit Tiranë me shkresë nr. 7109/1 prot, datë 24.08.2018, ku kjo gjykatë nuk ka dalë ende me një vendim.

Në pozicionin e Specialistes së Menaxhimit Financiar është emëruar në datën 02.03.2018 znj.E.A, e cila më pas është pushuar nga puna për performancë të dobët në detyrë, në datën 16.07.2019. Me vendim nr. 6086, datë 05.07.2018 Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë dhe dëmshpërblimin e paditësit me njëzetë e një paga ($42 * 1.500 = 63.000$ Euro).

-Me Vendimin Nr. 3700, datë 31.05.2021, Gjykata e Shkallës të Parë, Tiranë vendosur pranimin e kërkesë-padisë dhe dëmshpërblimin e paditësit me dyzetë e dy paga ($21 \text{ paga} * 1,400 = 29,400$ Euro). Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë me shkresë nr. 9952 prot, datë 04.11.2021 dhe çështja nuk është shqyrtuar ende nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Largimet nga detyra janë bërë në kundërshtim me MOP ku punëdhënësi nuk është bazuar në performancën e tyre apo në parashikimet e kontratave të lidhura e cila nuk justifikon veprimet e kryera. Sa më sipër vlera totale prej 92,400 Euro të fituara nga punonjësit e larguar nga puna, deri në këtë shkallë të gjykimit, konsiderohet *shpenzim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet në buxhetin e shtetit* e cila është në kundërshtim me Manualin e Operimit të Projektit (MOP), pika 30. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 16-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të merren masa për vlerësimin e performancës së stafit të projekteve, duke shmangur shpenzimet e proceset gjyqësore që mund të rezultojnë në rastet e largimit të tyre nga puna e për rrjedhojë shmangien e përdorimit të fondeve pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Nga ana ARrSh rekomandimi do të kihet parasysh në kontratat e ardhshme me financim të huaj.

Komenti i audituesve: Nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

3. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezulton se arritja e realizimit të ILD – ve paraqitet në masën 81%, konkretisht: ILD 1.1, 1.2 dhe 2.1 janë realizuar në 100% të parashikimit, ndërsa ILD 1.3 është realizuar 22%, ILD 2.2, dhe 2.3 është realizuar në 0%.

Duke ju referuar qëllimit primar të Projektit rezulton se ILD 1.3 dhe 2.3 rezultojnë se nuk kanë përshkruar objektivat kryesore të projektit, dhe mund të konsiderohen si shpërqendrim i menaxhmentit nga objektivat thelbësore të këtij projekti. Vlerat e disbursuar lidhur me këto ILD, mund të ishin shpenzuar në indikatorë tjerë të rëndësishëm të lartë për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore.

Komponentët 1.1 dhe 1.2, të cilët lidhen me mirëmbajtjen dhe kishin objektiv gjendjen e rrugëve. Në përgjithësi këta indikatorë masin punën e bërë, por jo direkt gjendjen e rrugëve. Kjo mund të ishte realizuar duke kryer matjen e ashpërsisë të rrjetit të rrugëve, duke e shprehur në termat e Indeksit Ndërkombëtar të Ashpërsisë (INA). Asnjë nga këto ILD, nuk shpreh se në cilën masë janë përmirësuar kushtet rrugore, gjatë periudhës të projektit.

Komponentin ILD 2.1, vlerësimi me yje iRAP, sistemi rezultoi të ishte i dobishëm për përmirësimin e përgjithshëm të infrastrukturës për të gjitha kategoritë e përdoruesve rrugorë, por dhe ky indikator nuk paraqet panoramën e plotë.

Lidhur me komponentin ILD -2.2 vendosja dhe operacionalizimi i RAMS/BMS, Projekti nuk arriti të krijonte sistemin e bazuar në evidenca, të dizenuar për të patur informacion lidhur me planifikim vjetor të mirëmbajtjes. Planifikimi u realizua duke u bazuar në vendimet vjetore, të marra duke analizuar evidencat. Dhe nëse ka patur përmirësim në menaxhimin e aseteve gjatë kësaj periudhe, kjo nuk pasqyrohet nga ILD 2.2, që dështoi të materializohej në digjitalizimin e RAMS. Ecuria e

projektit varet nga qartësimi dhe përcaktimi me detaje të sakta se cilët do të jenë indikatorët, të cilët do të përcaktojnë mbarëvajtjen e projektit.

-Koncepti i kontraktimit për performancën nuk është kuptuar si duhet nga kontraktorët dhe nga ARRSH. Ky koncept është një koncept i panjohur për të dyja palët: Kontraktorët presin tu thuhet çfarë të bëjnë, kur dhe si ta bëjnë punën e tyre, ndërsa Klienti (pra ARRSH) pret të jetë në gjendje të instruktojë Kontraktorin çfarë të bëjë, si dhe kur. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 71, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” dhe përcaktimet e Manualit të Operacioneve të Projektit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të merren masa që në Projektet e ardhshme të mirë kuptohen nga të gjitha palët pjesëmarrëse dhe të përmbushen në kohë objektivat, duke patur në fokus rezultatin në terren njëkohësisht me atë financiar.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Nga ana ARrSh rekomandimi do të kihet parasysh në kontratat e ardhshme me financim të huaj dhe do të ketë një bashkëpunim për një pjesëmarrje sa më të gjerë ku rezultatet dhe objektivat të jenë të qarta dhe të realizueshme..

Komenti i audituesve: Nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe në proces zbatimi.

4. Gjetje nga Auditimi: Komponenti 1.3 “Zhvillimi dhe operacionalizimi i Sistemit Social të Transparencës/ Reagimi publik – Sistemi i zgjidhjes” është realizuar 22%, ndërsa komponentët 2.2 “Vendosja dhe operacionalizimi i RAMS/BMS”, dhe 2.3 “Niveli i marrëveshjes të Shoqëriat midis ARRSH dhe MTI” është realizuar në 0%.

Nga auditimi rezulton se këta komponentë nuk kanë sjellë përfitime lidhur me qëllimin kryesor të projektit, dhe mund të konsiderohen si shpërqëndrim i menaxhimit nga objektivat thelbësore të këtij projekti. Vlerat e disbursuara lidhur me këto ILD, mund të ishin shpenzuar në indikatorë tjerë të rëndësishëm të lartë për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore.

Në marrëveshje përcaktohet se pas konsultimeve me Huamarrësin dhe duke njoftuar Bankën, mund të përshtaten shumat dhe objektivat e parashikuara për ILD specifike. Ecuria e projektit varet nga qartësimi dhe përcaktimi me detaje të sakta se cilët do të jenë indikatorët, të cilët do të përcaktojnë mbarëvajtjen e projektit. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 71, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”, seksioni IV, pika B5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: ARRSH në bashkëpunim me të gjitha institucionet e përfshira në hartimin dhe miratimin e marrëveshjeve të financimit të marrë masa që për projektet që hartohen në të ardhmen të përcaktohen objektiva të qarta dhe të matshme, me synim monitorimin e saktë të përfitimeve që arrihen nga zbatimi i tyre.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Nga ana ARrSh rekomandimi do të kihet parasysh në kontratat e ardhshme me financim të huaj dhe do të ketë një bashkëpunim për një pjesëmarrje sa më të gjerë ku rezultatet dhe objektivat të jenë të qarta dhe të realizueshme..

Komenti i audituesve: Nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe në proces zbatimi.

5. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i situacioneve ka rezultuar se ka raste të vonesave në përgatitjen e dokumentit të autorizimit të faturës dhe kërkesës së pagesës, dokument i cili konfirmohet nga menaxheri i projektit krahasuar me datën e faturës apo dhe datën e konfirmimit të situacionit nga menaxheri. Për Lotin 1, Kontrata A me operator JV “B... A.... & G... “shpk situacionet me vonesa janë: 1 – 17, 21 – 24, 26 - 33, dhe 35. Për Lotin 2, Kontrata B me operator JV “B... A..... & G.....” shpk situacionet me vonesa janë: 1 – 17, dhe 23 – 32. Për shkak të vonesave lidhur me pagesat e këtyre situacioneve, midis ARRSH dhe operatorëve “B.... A.....” dhe “G.... LTD” kanë lindur mosmarrëveshje, për të cilat palët kanë dakordësuar t’i drejtohen International Centre for ADR, ku me shkresën e ARRSH nr. 7483 prot, datë 01.08.2019, kërkohet caktimi i një eksperti për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Me shkresën nr.10732 prot, datë 22.11.2019 ARRSH i drejtohet z. C. A. M. ku konfirmohet përzgjedhja e tij si ekspert i zgjidhjes të mosmarrëveshjeve dhe kërkohet prej tij kosto e Shoqëriat dhe drafti i marrëveshjes mes palëve.

Kontraktimi i këtij eksperti është konfirmuar pa komente nga Banka Botërore me shkresën nr. 1706 prot, datë 25.02.2020.

-Me shkresat nr. 7620 prot, datë 12.10.2020 (Kontrata A), nr. 7621 prot, datë 12.10.2020 (Kontrata B), nr. 7622 prot, datë 12.10.2020 (Kontrata D), dhe nr. 76203prot, datë 12.10.2020 (Kontrata C), janë lidhur kontratat me ekspertin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve z. C. A. M..

Pavarësisht bisedimeve mes palëve dhe ekspertit, me shkresën hyrëse në ARRSH nr. 5628 prot, datë 07.06.2021, nga “B...A..T” dhe “G... LTD” është shprehur mos dakordësimi lidhur me kontratën A dhe B.

-Me shkresën nr. 1350/1 prot, datë 24.02.2022 nga Menaxheri i Projektit, drejtuar Drejtorisë Juridike dhe të Përputhshmërisë të Standardeve, vendosen në dijeni lidhur me vlerat e kërkuara nga operatorët, konkretisht:

-pagesa shtesë për Urdhër Ndryshimin A06 të kontratës A, dhe Urdhër Ndryshimin B05 të kontratës b, në vlerat 206,000 Euro dhe 15,248 Euro.

-interesa lidhur me vonesat për kontratat A dhe B respektivisht në vlerat 82,181.85 Euro dhe 145,946.24 Euro,

-pagesa e kontraktorit për punimet e anuluar për kontratat A dhe B, në vlerat 56,366.01 Euro dhe 142,239.84 Euro.

Sa më sipër, vlera 647,952 Euro, përbën një dëm ekonomik i mundshëm në disfavor të ARRSH. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 71/2015, (miratuar më 2.07.2015 dhe dekretuar me dekretin nr.9174, datë 14.07.2015, për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” dhe kontratat A dhe B, klauzola 50 “Pagesat” pika 50.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 46-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar të merren masa që në Projektet e ardhshme të ndiqen me përgjegjësi të procedurat e pagesave të situacioneve, të zbatohen afatet e përcaktuara lidhur me pagesat, duke shmangur procedurat gjyqësore të cilat do të sillnin për pasojë humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Nga ana ARrSh rekomandimi do të kihet parasysh në kontratat e ardhshme dhe në rast se nga ana e kontraktorit do të paraqiten ankesa në arbitrazh për pagesën e kamatëvonesave do të ndiqen sipas legjisllacionit në fuqi.

Komenti i audituesve: Nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi.*

6. Gjetje nga auditimi: Me Amendamentin Nr.1 është dakortësuar që: i. Shtrirja dhe shkalla e Punëve të Rehabilitimit të përcaktuara për disa seksione rrugore në kontratë janë të pamjaftueshme për të arritur Nivelet e Shoqëriat me të cilat kërkohet që Kontraktori të respektojë në ato seksione rrugore. ii. Teksti i Specifikimeve ka mungesë të qartësisë, përfshin kontradikta dhe përsëritje, si dhe dispozita joreale, duke rezultuar në vështirësi në zbatimin e kontratës. iii. Sqarimet e dhëna ofertuesve gjatë procesit të tenderimit përfshijnë deklarata të cilat janë në kundërshtim me njëra-tjetrën dhe me pjesë të tjera të kontratës.

Referuar pikave ii) dhe iii), të dakortësuar në këtë amendament, konstatohet se: specifikimet teknike të hartuara dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të tenderimit nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe ekspertëve të BB nuk kanë qenë në përputhje me objektivat e kontratave si dhe mungesë qartësie të tyre. Për problematikat e hasura në specifikimet teknike, në pikën B të këtij amendamenti, është dakordësuar rishikimi i tyre të cilat do të zëvendësojnë ato origjinale të kontratës. Mospërshtatja e kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike është edhe si rezultat i mungesës së experiencës pasi kjo lloj kontrate implementohet për herë të parë dhe nga koha e hartimit të tyre ka kaluar një kohë relativisht e gjatë. Këto ndryshime kanë rezultuar në implementimin e kontratave sipas një metode hibride dhe jo sipas asaj të projektuar në DST. Gjithashtu janë përfshirë rrugë që kanë pasur nevojë për një rehabilitim total dhe referuar gjendjes së tyre gjatë procesit të mirëmbajtjes nuk mund të arrihej niveli i kërkuar i Shoqëriat. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me dokumentat standarte të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që termat e referencës dhe specifikimet teknike për projektet me financim të huaj të jenë në përputhje me kushtet aktuale të gjendjes së rrugëve me qëllim ofrimin e Shërbimit me cilësi dhe siguri.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Nga ana ARrSh rekomandimi do të kihet parasysh në kontratat e ardhshme me financim të huaj dhe do të bëhet një vlerësim paraprak sa më real i situatës në terren para fillimit të hartimit të termave të referencës dhe zbatimit të projektit.

Komenti i audituesve: Nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi.*

7. Gjetje nga auditimi: Në kontratat “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” për të patur rezultate sa më të mira në menaxhimin e tyre, në seksionin e specifikimeve pjesa 2 të cilat janë pjesë e DST, është seksioni 6.1 Masat e performancës menaxheriale (*Management Performance Measures*) MPM e cila pasqyron aftësinë e kontraktorit për të menaxhuar me sukses rezultatet e kontratës duke përfshirë cilësinë dhe efikasitetin e raportimit të tij të informacionit tek punëdhënësi. Për çdo raportim dhe pasqyrim të dhënash tek punëdhënësi nga kontraktori që nuk përputhen me afatet e kërkuara në kontratë janë vendosur penalitete për çdo ditë vonesë përtej këtyre afateve. Masa e Penaliteteve për MPM janë të pasqyruara në DST, për çdo çështje, (Aneksi VII Reduktim i Pagesave për MPM, OPM, RDPM) të specifikimeve pjesa 2 të hartuara nga konsulenti i BB dhe AK kanë qenë kriter mbi bazën e të cilit të gjithë operatorët ekonomik kanë dhënë ofertën e tyre ekonomike. Nga auditimi i dokumentacionit, të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, nuk gjenden gjurmë ku të sqarohet se mbi çfarë reference ose studimi janë bazuar vlerat e penaliteteve nga ana e ekspertit të marrë nga AK dhe BB për hartimin e tyre. Ndryshimi i specifikimeve teknike ka sjell si rezultat edhe rishikimin e penaliteteve, ku janë shtuar dhe hequr disa, duke i përshtatur me kushtet aktuale të kontratës. Veprimet e mësipërme janë në

kundërshtim me dokumentat standarte të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike . (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për projektet me financim të huaj vlerat e penalteteve të cilat do të aplikohen gjatë zbatimit të kontratave të jenë të argumentuara dhe në përputhje me kushtet aktuale të zbatimit të tyre.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Nga ana ARrSh rekomandimi do të kihet parasysh në kontratat e ardhshme me financim të huaj dhe do të bëhet një vlerësim paraprak sa më real i situatës në terren dhe penaltetet e vendosura për kontraktorët do të jenë në përputhje me kushtet aktuale të zbatimit.

Komenti i audituesve: Nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *në proces zbatimi*.

8. Gjetje nga auditimi: Në amendimin nr.3 është ndryshuar Klauzola 51 e Kushteve të Veçanta të Kontratës e cila lidhet me penaltetet e dëmeve ku është 10% dhe në raste të veçanta mund të bëhet 20% e vlerës së punimeve rehabilituese, përmirësuese dhe emergjente në rastet ku testet e kryera nuk plotësojnë kërkesat e kërkuara. Për plotësimin e ndryshimeve të kësaj klauzole është ndryshuar pika C 2.1, ku kontraktori duhet të kryej të gjitha testet e materialeve në përputhje me specifikimet teknike, ku rezultatet e tyre do të tregojnë cilësinë e punimeve dhe mbi to do të kryhen pagesat përkatëse ndaj kontraktorit. Gjithashtu në këtë pikë është shtuar se, pavarësisht se rezultatet e testeve nuk janë në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat, Konsulentit Monitorues mund t'i rekomandojë Menaxherit të Projektit pagesën e ndërmjetme si dhe të zgjatet perioda e garancisë së punimeve, si dhe mbajtja 20% e vlerës së tyre e cila kthehet me përfundimin garancisë. Pavarësisht kushteve të vendosura, likuidimi i punimeve të kryera pa u vërtetuar se janë kryer sipas specifikimeve teknike nuk japin garanci për jetëgjatësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre e për rrjedhojë risin koston e mirëmbajtjes së rrugëve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me dokumentat standarte të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike; KTZ, VKM Nr. 68 datë 15.02.2001 “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit” i ndryshuar; ligjin 8402 datë 10.09.1998, i ndryshuar, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për projektet me financim të huaj punimet e kryera të likuidohen pasi të jenë realizuar në përputhje me specifikimet teknike duke siguruar jetëgjatësinë e investimit dhe ulen e koston të mirëmbajtjes.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Nga ana ARrSh rekomandimi do të kihet parasysh në kontratat e ardhshme me financim të huaj likuidimet do të kryhen pasi punimet të jenë kryer sipas specifikimeve teknike dhe të vërtetuara me certifikatat përkatëse.

Komenti i audituesve: Nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *në proces zbatimi*.

9. Gjetje nga auditimi: Në amendimin nr.3 është ndryshuar klauzola 12.1 ku shtohet se nën-kontraktimi mund ta kalojë vlerën 40% të kontratës vetëm në rastet kur është pjesë e JV ku bashkimi i operatorëve ekonomik ka hyrë në tender me përqindje të caktuara sipas përvojës që kanë në menaxhimin dhe zbatimin e kontratave të bazuar në rezultate me performancë. Ky ndryshim bën të mundur që të kryhen punime nga ana e kontraktorëve që nuk kanë përvojën e nevojshme për kryerjen e tyre dhe këto punime nuk do të jenë në standardin e kërkuar. Gjithashtu AK do të lëshojë nën-kontraktorit një certifikatë që konfirmon llojin dhe vlerën e punimeve të

kryera prej tij ku në momentin e ndryshimit ka kaluar më shumë se 50% e afatit kohor të zgjatjes së kontratës. Me këtë ndryshim duke lëshuar certifikatë konfirmimi për nën-kontraktorët u jep atyre mundësinë të marrin pjesë, në procedura prokurimi, në kontrata të këtij lloji pa patur përvojën e menaxhimit të tyre pasi ata kryejnë vetëm punime faktike në terren të matura dhe punime të mirëmbajtjes rutinë dhe jo “Self control unit” pasi nuk është e lejuar të nënkontraktohet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kontratat e punimeve civile, klauzola 12.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për projektet me financim të huaj lëshimi i certifikatave për nën-kontraktorët të kryhet sipas punimeve të kryera nga ana e tyre duke shmangur pjesëmarrjen e tyre në financime të tjera pa pasur përvojën e kërkuar.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Nga ana ARrSh rekomandimi do të kihet parasysh në kontratat e ardhshme me financim të huaj, për lëshimin e certifikatave të nën-kontraktorëve do të kryhet një vlerësim i detajuar mbi punimet e realizuara nga ana e tyre në projekt dhe certifikata do të lëshohet në bazë të vlerësimit të bërë.

Komenti i audituesve: Nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi.*

10. Gjetje nga auditimi: Në kontratat “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” mirëmbajtja rutinë përcaktohet nga niveli i Shërbimit të kërkuar sipas kategorisë dhe kushteve teknike të rrugës. Në amendimin nr.3 janë modifikuar kërkesa e nivelit të Shërbimit për seksionet rrugore ku shtresat asfaltike ekzistuese nuk mund të mirëmbahen për shkak se punimet rehabilituese të përfshira në kontratë janë pezulluar ose anuluar nga Punëdhënësi. Ky ndryshim ka ulur nivelin e Shërbimit por nuk është i shoqëruar me ulje të kostos së mirëmbajtjes rutinë pasi kontraktori kryen më pak punime nga ato të ofruara. Në DST nuk është kërkuar një analizë kostoje të çmimit/njësi, për zërat e punimeve të mirëmbajtjes rutinë, e cila do të bënte të mundur llogaritjen e uljes së kostos sipas nivelit të Shërbimit të ofruar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kontratat e punimeve civile, dokumentet standarde të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për kontrata të ngjashme niveli i Shërbimit të kërkohet sipas kushteve të rrugëve dhe me një kosto të detajuar për punimet që kryhen ku do të bëjë të mundur uljen e kostos së projekteve në tërësi në rastet ku do të kërkohet një nivel Shoqëria i reduktuar.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Nga ana ARrSh rekomandimi do të kihet parasysh në kontratat e ardhshme me financim të huaj dhe ato nga buxheti i shtetit duke vlerësuar gjendjen e rrugëve dhe në bazë të saj do të bëhet kostoja e detajuar duke minimizuar shpenzimet shtesë. Konkretisht është zbatuar në kontratat e mirëmbajtjes të financuara nga buxheti i shtetit.

Komenti i audituesve: Nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi.*

11. Gjetje nga auditimi: Në kontratat “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” në Amendamentin nr.3 datë 16.10.2019 në pikën F janë ndryshuar specifikimet B.3.6.4 për dëmtimin e aseteve rrugore, ku sipas kontratës fillestare thuhet se humbjet apo dëmtimet të punimeve ose aseteve risku është i kontraktorit në masën 100%. Sipas specifikimeve të rishikuara në amendamentin nr.1, kontraktori mbulon në riskun e tij deri 3,500 Euro për çdo ngjarje dhe

maksimumi në total 35,000 Euro në vit. Pra dëmtimi i aseteve nga palët e treta që kalojnë vlerën mbi 3,500 Euro për rast ose mbi 35,000 Euro në vit do të paguhet nga punëdhënësi. Gjithashtu në pikën e mësipërme të këtij amendamenti në specifikimet teknike B.3.4.6 është shtuar që risku të mbahet nga punëdhënësi edhe para datës 16.03.2018 kur është miratuar ndryshimi i specifikimeve teknike duke patur fuqi prapavepruese. Para ndryshimeve të kryer në specifikimet teknike nuk ka pasur nga kontraktori për dëmtime të aseteve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kontratën e punimeve civile, dokumentet standarde të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi: ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për kontrata të ngjashme të mos miratohen ndryshime me veprime prapavepruese të cilat risin koston e projektit mbi punëdhënësin.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Nga ana ARrSh rekomandimi do të kihet parasysh në kontratat e ardhshme me financim të huaj ndryshimet të mos kenë efekte prapavepruese por sipas kushteve të kontratës.

Komenti i audituesve: Nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi.*

12. Gjetje nga auditimi: Në kontratat “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” është parashikuar që para fillimit dhe në të punimeve rehabilituese dhe përmirësuese duhet të kryheshin testet IRI (Indeksi i Ashpërsisë së Rrugës) dhe FWD (kriteri i fortësisë së rrugës). Në amendamentin nr. 3 datë 16.10.2019 në pikën G seksioni i specifikimeve teknike B.4.6.7 (Vrojtimet dhe Projektimet sipas Shtresave Rrugore) është hequr totalisht, pra testet e IRD dhe FWD të mos kryhen pas përfundimit të punimeve dhe do të paraqiten në Raportin e Inventarit të Aseteve çdo 6 muaj. Kryerja e testeve para fillimit të punimeve është e rëndësishme pasi ato përcaktojnë nevojat e rehabilitimit të shtresave si dhe më jetëgjatësia e tyre nga punimet e kryera. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kontratën e punimeve civile, dokumentet standarde të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për kontrata të ngjashme për një përcaktim sa më të saktë të nevojave rehabilituese të shtresave rrugore të kryhen testet e kërkuara duke kryer shpenzime efikase dhe ruajtjen e kushteve të rrugëve për ofrimin e Shërbimit të kërkuar nga përdoruesit e saj.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Nga ana ARrSh rekomandimi do të kihet parasysh në kontratat e ardhshme me financim të huaj dhe ato nga buxheti i shtetit duke vlerësuar gjendjen e rrugëve dhe në bazë të saj do të bëhet kostoja e detajuar duke minimizuar shpenzimet shtesë. Konkretisht është zbatuar në kontratat e mirëmbajtjes të financuara nga buxheti i shtetit.

Komenti i audituesve: Nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi.*

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Në kontratën me objekt Shoqëria “Monitorim/ Supervizionim i katër Kontratave, Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate” sipas amendimit nr. 7 me Nr.4765Prot. datë 16.05.2019 janë shtuar kontribute për një shofer 31 muaj dhe një përkthyes për 12 muaj. Në ofertën fillestare nuk janë parashikuar shoferë, për makinat e vendosura në dispozicion nga kontraktori, pasi janë marrë parasysh si shpenzime të rimbursueshme me kosto zero, dhe janë të shpërndara në pagesat e stafit. Për përkthimin e dokumenteve sipas kontratës fillestare mbulohen

nga sekretare/përkthyes e përcaktuar në përshkrimin e punës si dhe referuar materialeve të përkthyer të vendosura në dispozicion rezultojnë se janë vetëm disa raporte për të cilat nuk kanë patur nevojë për kohë 12 muaj. Për sa më sipër vlera prej 35,600 Euro pa TVSH (24,800 Euro shoferi + 10,800 Euro përkthyes) është përfituar më tepër nga konsulenti dhe përben dëm ekonomik në buxhetin e projektit. Veprime në kundërshtim me kontratën e Shërbimit të konsulencës nr. 9999 prot. datë 05.12.2016, Aneksi III, shtojca IV dhe D. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: ARRSH të marrë masa, për arkëtimin e shumës 35,600 Euro pa TVSH, e cila përben dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “I...E... S.r.l&S... S.p.a&S... S.p.a” me të cilin është lidhur kontrata Nr. 9999Prot. datë 05.12.2016, për monitorimin dhe konsulencën e katër kontratave të mirëmbajtjes.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Për sa i përket pikës 1, Rekomandimi 1.1 nga ARrSh me shkresën nr. 8406 Prot, datë 27.10.2023 është njoftuar për shpërblim dëmi në mënyrë vulltare dhe nëse nuk do të arrihet arkëtimi do të vijohet me rrugë gjyqësore. Kjo vonesë ka ardhur si rezultat pasi kompania ka përfunduar mardhënien kontraktuale dhe nuk ka pasur një adresë të saktë.

Komenti i audituesve: Nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i pa zbatuar*.

2. Gjetje nga Auditimi: Në kontratën me objekt Shoqëria “Monitorim/ Supervizionim i katër Kontratave, Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate” krahas kontributeve për stafin kryesor dhe jo kryesor është parashikuar dhe një shumë e rimbursueshme prej 100,000 Euro e cila do të përdoret për, raportin iRAP në vlerën 39,960 Euro, dy reflektometra në vlerën 30,000 Euro dhe për teste të pa varura që do të duhen konsulentit në vlerën 30,000 Euro. Sipas faturave të vendosura në dispozicion rezultojnë se 18,678.75 Euro janë shpenzuar për reflektometrat dhe 60,000 Euro për testet iRAP, në total 78,678.75 Euro. Në kontratën fillestare dhe sipas marrëveshjes financiare aktiviteti iRAP do të kryhej tre herë gjatë zbatimit të kontratave, në vitin e parë, të tretë dhe të pestë përpara 1 Nëntorit të këtyre viteve ku konsulenti ka ofruar shumën 39.960 Euro. Në amendamenti nr.7 datë Nr.4765Prot. datë 16.05.2019 është (pika viii) është dakordësuar që do të kryhen vetëm dy herë, dhe i dyti të kryhet në mesin e viti 2021. Ky ndryshim do të zvogëlojë dhe koston për iRAP të cilën Konsulenti Monitorues duhet ta ndryshojë në përputhje me pikën 30 të kontratës. (viii) *In accordance with the discussions held during the Mid-Term Review of the RRMSF, the number of iRAP surveys to be carried out by the MC through an independent provider is reduced from three to two, with the second survey to be carried out in mid-2021. This shall reduce the overall cost for the iRAP surveys which the MC shall charge in accordance with para. 30 of the Contract.*

Derisa kostoja për tre testet iRAP ishte jo më shumë se 39,960 Euro, për dy duhet të jetë 26,640 Euro. Nga auditimi i dokumentacionit dhe raporteve të vendosura në dispozicion rezultojnë se iRAP është kryer dy herë dhe sipas faturave të paraqitura secili ka një kosto prej 30,000 Euro dhe në total 60,000 Euro, jo vetëm që nuk është zvogëluar por ka kaluar edhe vlerën e parashikuar në kontratë. Për sa më lart vlera e dy testeve iRAP nuk duhet të kalonte vlerën 26,640 Euro e për rrjedhojë konsulenti ka përfituar më tepër vlerën 33,360 Euro pa TVSH e cila përben dëm ekonomik në buxhetin e shtetit. Veprime në kundërshtim me kontratën e Shërbimit të konsulencës nr. 9999 prot. datë 05.12.2016, dhe amendimi nr.7 datë 16.05.2019, pika (viii). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: ARRSH të marrë masa, për arkëtimin e shumës 33,360 Euro pa TVSH, e cila përben dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme

administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “I...E... S.r.l&S... S.p.a&S... S.p.a” me të cilin është lidhur kontrata Nr. 9999Prot. datë 05.12.2016, për monitorimin dhe konsulencën e katër kontratave të mirëmbajtjes..

Menjëherë

Komenti i subjektit: Për sa i përket pikës 1, Rekomandimi 2.1 nga ARrSh me shkresën nr. 8406 Prot, datë 27.10.2023 është njoftuar për shpërblim dëmi në mënyrë vullnetare dhe në se nuk do të arrihet arkëtimi do të vijohet me rrugë gjyqësore. Kjo vonesë ka ardhur si rezultat pasi kompania ka përfunduar marrëdhënien kontraktuale dhe nuk ka pasur një adresë të saktë.

Komenti i audituesve: Nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i pa zbatuar*.

C. MASA PËR ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga Auditimi: Në kontratën me objekt Shoqëria “Monitorim/ Supervizionim i katër Kontratave, Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate” janë parashikuar, staf jo kryesor, 12 punonjës për kontrollin dhe monitorimin e punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në 12 muajt e parë të kontratave të zbatimit. Referuar zbatimit të kontratave të punimeve civile rezulton se gjatë 12 muajve të parë deri në nënshkrimin e amendamentit nr.1 datë 16.03.2018, nuk janë realizuar punime rehabilituese dhe përmirësuese. Sipas kontratës çdo 6 muaj nga bërja efektive e kontratës së konsulentit, ARrSh dhe konsulenti duhet të rishikojnë kontributet (input) e stafit për 6 muajt e ardhshëm bazuar në dakortësinë e planifikimit të stafit e cila nuk është realizuar. Nga mosrealizimi i punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në 12 muajt e parë të kontratave, kontributet e stafit lokal të parashikuara për kontrollin dhe monitorimin e këtyre punimeve janë përfituar nga konsulenti pa ofruar ndonjë shërbim sipas përshkrimit të punës (scope of work) të parashikuar në kontratë nga ky staf në vlerën prej 432,000 Euro pa TVSH. Gjithashtu nga mosrealizimi i punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në vitin e parë janë shtuar dhe kontributet e Deputy Team Leader me 12 muaj në vlerën 162,000 Euro pa TVSH. Për sa më sipër vlera prej 594,000 Euro pa TVSH (432,000 stafi lokal + 162,000 Deputy Team Leader) konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet i fondeve të projektit. Veprime në kundërshtim me kontratën e Shërbimit të konsulencës nr. 9999 prot. datë 05.12.2016, informacion përmbledhës për stafin, pika b. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: ARRSH të marrë masa, për projektet në proces dhe të reja, të monitoroj kontratat e konsulencës dhe shtimi i kontributeve të stafit të jetë sipas situatës në terren duke shmangur kështu rritjen e kostove të kontratave.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Nga ana ARrSh rekomandimi do të kihet parasysh në projektet në proces dhe të reja ku kontratat e konsulencës do të jenë në përputhje me Shoqërian e kryer referuar grafikut të zbatimit të punimeve.

Komenti i audituesve: Nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *në proces zbatimi*.

2. Gjetja nga auditimi: Termat e marrëveshjes në këtë Projekt përcaktojnë se komisioni i angazhimit i pagueshëm nga Huamarrësi për çdo vlerë e cila rezulton e pa tërhequr është i barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) në vit të shumës së Huas gjendje. Nëse objektivat e Projektit do të ishin realizuar sipas afateve të përcaktuara në marrëveshje komisioni i angazhimit

do të paguhej në vlerën 263,518 Euro. Nga auditimi rezulton se vlera e paguar për këtë komision deri në datën 31 dhjetor 2022 është 453,393.82 Euro.

Diferenca midis vlerës të parashikuar dhe asaj të paguar rezulton në vlerën 189,875.77 Euro dhe konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet për buxhetin e shtetit. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 71, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” neni 2.5. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të merren masa që në Projektet e ardhshme të përmbushen në kohë të gjitha përcaktimet e marrëveshjeve financiare, në mënyrë që të shmangen të gjitha efektet e mundshme financiare që rrjedhin nga këto vonesa në afate.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Nga ana ARrSh rekomandimi është referuar edhe në ministrinë përkatëse që të kihet parasysh në kontratat e ardhshme me financim të huaj projekti të kryet brenda afateve të përcaktuara në marrëveshjen financiare.

Komenti i audituesve: Nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

D. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit që janë identifikuar si përgjegjës në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit, masa administrative e propozuar nga ana jonë do të ishte “*Vërejtje*” deri në “*Largim nga detyra*” por meqenëse Projekti ka përfunduar dhe personat janë larguar nga pozicionet përkatëse masat do të konsiderohen të ezazuara.

Komenti i subjektit: Projekti ka përfunduar dhe masat e lëna quhen të ezazuara.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

3. AUDITIM I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE NË SUBJEKTIN UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SHA

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime SHA, Tiranë** me objekt “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023*” për periudhën objekt auditimi 01.09.2018 – 31.10.2022, të përcjella në subjekt me shkresën Nr.447/13Prot. datë 03.05.2023.

Çështjet kryesore që janë trajtuar gjatë auditimit janë: verifikimi i hartimit nga subjekti të programeve (plan veprimeve), vlerësimi i ecurisë dhe i nivelit të zbatimit të rekomandimeve, përcaktimi i statusit të tyre, rikërkimi për zbatim të rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshejtimi i punës për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi. Gjithashtu është trajtuar nxjerrja nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

- a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
- b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
- c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve;
- ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandimeve që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjekt u mbajt Akt Verifikimi nr. 1, datë 31.01.2024, administruar në Sh.A Ujësjiellës Kanalizime Tiranë me nr. K-18/2 prot. datë 31.01.2024, për të cilin nuk është paraqitur observacion

nga ana e subjektit. Pas dërgimit të Projektraportit të Auditimit, nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observacione.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, UK Tiranë SHA ka respektuar këtë afat duke kthyer përgjigje sipas shkresës së administruar në institucion me Nr.6613/1 Prot. datë 18.05.2023.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr.447/13Prot. datë 03.05.2023, administruar në UK Tiranë SHA me Nr. 6613 Prot. datë 04.05.2023, janë rekomanduar gjithsej:

a. 42 masa organizative;

b. 8 masa për shpërblim dëmi në vlerën 65,932,162 lekë;

c. 2 masa për përdorimin të fondeve publike jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit në shumën 5,414,458 lekë;

d. masat disiplinore të vlerësohen nga institucioni.

IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr.447/13Prot. datë 03.05.2023, administruar në UK Tiranë SHA me Nr. 6613 Prot. datë 04.05.2023, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar (nga UK Tiranë)	Pa pranuar
1	Organizative	42 masa	42 masa	-
2	Shpërblim dëmi	8 masa 65,932,162 lekë	7 masa 55,441,729 lekë	1 masë 10,490,433 lekë
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	2 masa 5,414,458 lekë	2 masa 5,414,458 lekë	-
4	Masa Disiplinore	1	1	-
		53	52	1

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmblëdhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	42 masa	17	-	25	
2	Shpërblim dëmi	7 masa	1 masë	1 masë	-	5 masa

		55,441,729 lekë	3,064,212 lekë	1,545,045 lekë		50,832,472 lekë
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	2 masa 5,414,458 lekë	-		2 masa 5,414,458 lekë	
4	Masa Disiplinore	1	-	-	-	1
		52	18	1	27	6

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 1047/1 Prot. datë 29.12.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. S.H, (Përgjegjës grupi)
2. J.M

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr.447/13Prot. datë 03.05.2023, administruar në UKT SHA me Nr. 6613 Prot. datë 04.05.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Ujësjiellës Kanalizime SHA, Tiranë, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr.447/13Prot. datë 03.05.2023, administruar në UKT SHA me Nr. 6613 Prot. datë 04.05.2023, rezulton se nga 53 masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi dhe 3-E, Disiplinore*), janë pranuar nga subjekti 52 masa ose 98 %. Nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 18 masa, ose 35 % e tyre, është zbatuar pjesërisht 1 masë ose 2%, janë në proces zbatimi 27 masa ose 52 % dhe nuk janë zbatuar 6 masa ose 11%.

Niveli i realizimit plotësisht të rekomandimeve është në masën 35%, gjë e cila tregon se Ujësjiellës Kanalizime SHA, Tiranë e ka vlerësuar jo si duhet procesin e zbatimit të rekomandimeve, si dhe domosdoshmërinë që ka ndjekja e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, përfundimi i atyre në proces si dhe marrja e masave të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	42 masa	17	-	25	
2	Shpërblim dëmi	7 masa 55,441,729	1 masë 3,064,212	1 masë 1,545,045	-	5 masa 50,832,472

		lekë	lekë	lekë	lekë	lekë
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	2 masa 5,414,458 lekë	-		2 masa 5,414,458 lekë	
4	Masa Disiplinore	1	-	1	-	1
5	SHUMA	52	18	1	27	6

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit plotësisht të rekomandimeve është në masën 35 %, nivele këto të cila tregojnë vlerësimin pjesërisht të këtij procesi si dhe domosdoshmërinë që ka ndjekja e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, përfundimi i atyre në proces si dhe nisja e hapave të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.
 -Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, UK Tiranë Sh.A, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën Nr. 6613/1 Prot. datë 18.05.2023.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje elektropompa”, viti 2019 në vlerën 12,353 mijë lekë, Ndërtim rrjet shpërndarjes ujësjellësi dhe kanalizimi në zonën e kufizuar nga rrugët Tefta Tashko”, “Luigj Gurakuqi”, viti 2021 në vlerën 45,639 mijë lekë, “Zhblllokim pusëtash”, viti 2022 në vlerën 19,994 mijë lekë dhe “Blerje tuba dhe rekorderi”, viti 2022 në vlerën 19,994 mijë lekë, kriteret e veçanta për kualifikim nuk janë vendosur plotësisht konform akteve rregullatore për prokurimet publike, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2009, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 5, VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, kreu III, pika 1/a, VKM nr. 108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar, shkresën e APP (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr.

3341/1 prot., datë 20.03.2018 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “*Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023*”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 1.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

2. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”, viti 2021, në vlerën 99,903 mijë lekë, nuk është siguruar kontrata për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta, si dhe Autoriteti Kontraktor, nuk ka zgjatur periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit, ose nuk ka bërë vet siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

Veprim në kundërshtim me neni 25 të kontratës së lidhur, pika 1 dhe 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se

“25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në afatin e realizimit të plotë, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në sigurimin e kontratave, me qëllim jo vetëm lidhja tyre të shoqërohet me policat e sigurimi, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “*Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023*”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është

dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 2.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi në vijimësi.*

3. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”, viti 2019, për vlerën 99,903 mijë lekë, “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”, viti 2021 për vlerën 999,800 mijë lekë, punimet janë projektuar dhe preventivuar nga inxhinier/specialist pa pasur zotësinë profesionale për të projektuar (teknike dhe ligjore), pasi nuk kanë pasur licencat profesionale përkatëse të dhëna nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 759, datë 12.11.2014 ‘Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim’, i ndryshuar, pika 1, neni 16/1 “Licenca – kategoritë e punimeve” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për hartimin e projekteve, me qëllim jo vetëm kryerja e tyre të bëhet me inxhinier/specialist të licencuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Në buxhetin e vitit 2024 është parashikuar një zë studim projektim me palë të treta, zë i cili do të mbulojë projektimin me ekspertë të licencuar, zë i cili do të mbulojë projektimin me ekspertë të licencuar apo studio projektimi për projektet strategjike/mëdha. Për punët rutinë shfrytëzohen licencat individuale të secilit prej projektuesve si dhe eksperiencat dhe vitet e ndarë në kategorizimin që kanë këta projektues.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi në vijimësi.*

4. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”, viti 2019, për vlerën 99,903 mijë lekë, në preventiv nuk është pasqyruar pajisja hardëare e komunikimit DCU, që mundëson transmetimin në kohë reale në Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të dhënave, pajisje e cila është në projekt, duke sjellë:

-a. Mos efikasitet të plotë të fondit publik të përdorur në këtë prokurim në përputhje me qëllimin e tij, që ka të bëjë me “Sistemi matjes në distancë bazohet në ngritjen e një rrjeti komunikimi të njësisë matëse me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të Dhënave”. Kjo lloj teknologji shfrytëzon transmetimet wireless, e cila transformon informacionin mekanik në sinjale elektrike. Përmes instalimit të këtyre ujëmatëseve ndërtohet Sistemi i Matjes në Distancë. Sistemi i Matjes në Distance bazohet në ngritjen e një rrjeti komunikimi të njësisë matëse me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të Dhënave. Projekti parashikon që në ofertë të jenë të parashikuara të gjitha kostot në lidhje me programimin e software, zhvillimin me qëllim përfundimtar që të dhënat të përfutuara përmes walk-By/Drive-By, ose përmes rrjetit fiks të jenë të disponueshme në sistemin e shfrytëzimit të U.K.T.

-b. Mos kalimin e vlerës mbi 100,000,000 lekë, për t’ju nënshtruar projekti, oponencës teknike.

-c. Mos shkurtimin e personelit (faturistëve) për faturimin e ujit të pijshëm.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 18.7.2002 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, pika 1, VKM nr. 1055, datë

22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, Urdhrin e Ministres së Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit nr. 7, datë 20.1.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura në lidhje me instalimin e matësve inteligjent është e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 4.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe në proces zbatimi në vijimësi për kontratat në të ardhmen.

5. Gjetje nga auditimi: Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë viti 2019, për vlerën 99,903 mijë lekë, “Ndërtim rrjet shpërndarjes ujësjetllësi dhe kanalizimi në zonën e kufizuar nga rrugët “Tefta Tashko”, “Luigj Gurakuqi”, viti 2021, vlera 45,639 mijë lekë, punimet janë kryer pa deklaratë paraprake punimesh. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 3 pika 21, VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar neni 7 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Nga Shoqëria të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për ndërtimet dhe rikonstruksionet e objekteve, me qëllim jo vetëm kryerja e tyre të bëhet me leje ndërtimi/ deklaratë paraprake punimesh, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 5.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar pjesërisht* dhe në proces zbatimi sipas rastit.

6. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” Sh.a për periudhën 2021, ka instaluar 4776 matës inteligjent të ujit të pijshëm. Instalim i matësve inteligjent është realizuar pa

kryer më parë, vlerësim ekonomik, i cili duhet të kishte marrë në konsideratë të gjitha kostot afatgjata dhe përfitimet që do të ketë tregu dhe klientët, duke përfshirë gjithashtu edhe formën e matjes inteligjente që do të përzgjidhej/përzgjidhet, e cila duhet të jetë ekonomikisht më efektive dhe me afatin kohor më të përshtatshëm për implementimin e këtij sistemi matjeje.

Në bazë të vlerësimit ekonomik të përcaktuar si më sipër Shoqëria, duhet të kishte propozuar në ERU ndryshimet përkatëse ligjore dhe rregullatore, si dhe mbas miratimit të tyre duhet të përgatiste një kalendar për implementimin brenda një periudhë 10-vjeçare të sistemeve inteligjente të matjes. ERU duhet të sigurojë/siguroj ndëryshimin e sistemeve të ndryshme matëse, që do të implementohen në të gjithë territorin e vendit. Në instalimin e matësve nuk është dokumentuar testimi i kryer pas verifikimit periodik, me rezultatin që matësi nuk kryen funksionet e matjes (Verifikimit periodik të ujëmatësve i nënshtrohen të gjithë ujëmatësit që kanë plotësuar kriterin e datës së vendosjes së tyre 60 muaj, dëmtimi/ose jo fizikisht i tij, kalimi/ose jo j jetëgjatësisë së tij, matësi nuk kryen funksionet e tij etj). Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, “Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e Shërbimit të ujësjellës kanalizimeve SHA”, pika 2/7, Ligjin nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë” i shfuqizuar, neni 26, i ndryshuar me Ligjin nr. 126/2020 “Për metrologjinë”, neni 25; VKM nr. 96, datë 21.2.2007 “Për disa ndryshime në VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë”, pika 3; Vendimin e Enti Rregullator i Ujit nr. 8, datë 04.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip” ndryshuar me Vendimet nr. 15, datë 09.06.2014 “Për zbatimin e kontratës model të miratuar nga KKRR për të gjithë klientët e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” dhe me Vendimin nr. 25, datë 08.07.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën model të shërbimeve ujësjellës kanalizime” Enti Rregullator i Ujit, neni 7 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Në rastet e vendosjes së matësve inteligjent të ujit të pijshëm nga Shoqëria “UKT Tiranë” SHA, të merren masa për të përgatitur paraprakisht vlerësimin ekonomik, i cili duhet të marrë në konsideratë të gjitha kostot afatgjata dhe përfitimet që do të ketë tregu dhe klientët, duke përfshirë gjithashtu edhe formën e matjes inteligjente që do të përzgjidhej/përzgjidhet, e cila duhet të jetë ekonomikisht më efektive dhe me afatin kohor më të përshtatshëm për implementimin e këtij sistemi matjeje. Në bazë të vlerësimit ekonomik të përcaktuar si më sipër Shoqëria, duhet ti propozoj në ERU ndryshimet përkatëse ligjore dhe rregullatore, si dhe mbas miratimit të tyre duhet të përgatit një kalendar për implementimin brenda një periudhë 10-vjeçare të sistemeve inteligjente të matjes.

ERU duhet të siguroj ndëryshimin e sistemeve të ndryshme matëse, që do të implementohen në të gjithë territorin e vendit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësijellës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 6.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi në vijimësi.*

7. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e kontratës “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”, viti 2021, për vlerën 999,800 mijë lekë, për çdo muaj është hartuar akt kolaudimi dhe procesverbali i marrjes në dorëzim. Konkretisht për muajin janar 2022. Aktkolaudimi me nr. 4119/3 prot., datë 20.10.2022 i firmosur nga “P..S..” Shpk dhe grupi i marrjes në dorëzim R.L, D.Q dhe E.Q “ Ku është shprehur “Grupi i kolaudimit u njohë me kontratën të kolaudojë dhe të marr në dorëzim Shoqërian e kryer sipas faturës nr.8/2022, datë 20.01.2022 (bashkëlidhur) është në përputhje me kërkesat e paraqitura në kontratë dhe në specifikimet teknike sipas kontratës. Operatori “P...S..” Shpk ka kryer Shoqërian sipas dokumenteve bashkëngjitur”. Procesverbal me nr. 1012 prot., datë 20.01.2022 i firmosur I. H dhe grupi i punës R.L, D.Q dhe E.Q, ku është shprehur në mënyrë eksplicite e “Shpk “P...S” Shpk për periudhën 15.12.2021-15.01.2022, ka realizuar me sukses monitorimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të sigurisë për 76 objekte sipas kontratës dhe termave të referencës”, por nuk cilëson çfarë mirëmbajete ka bërë specifikisht. Po ashtu dhe për dy operatorët e tjerë “E.... dhe G... S.... Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktivitetëve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 23 gërma g dhe pika 34 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të nxjerri urdhër/urdhra me qëllim ndjekjen me përpikmëri të zbatimit të kontratave, duke përfshirë dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara, për sasinë, cilësinë, llojin si dhe dokumentacionin shoqëruar të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 7.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi në vijimësi.

8. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Ndërtim rrjet shpërndarjes ujësjetllësi dhe kanalizimi në zonën e kufizuar nga rrugët Tefta Tashko”, “Luigj Gurakuqi”, viti 2021 për vlerën 45,639 mijë lekë, në dokumentet e tenderit dhe në kontratën e lidhur nuk reflektojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratave, sipas përcaktimeve të dokumenteve të tenderit, nuk reflektohet afati për mbajtjen e garancisë së punimeve, në kundërshtim me Udhëzim i KM nr. 3, datë 15.2.2001, “Për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të nxjerri urdhër/urdhra me qëllim përcaktimin me përpikmëri të afatit për mbajtjen e garancisë së punimeve, duke përfshirë dhe vlerën përkatëse si garanci.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur

Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 8.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *i pranuar* dhe në proces zbatimi.

9. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Ndërtim rrjet shpërndarjes ujësjellësi dhe kanalizimi në zonën e kufizuar nga rrugët Tefta Tashko”, “Luigj Gurakuqi”, viti 2021 për vlerën 45,639 mijë lekë, me shoqërinë “L... C..” Shpk, nuk është lidhur kontrata e sigurimit për çdo dëm që mund të shkaktohet. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 1 dhe 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në sigurimin e kontratave, me qëllim jo vetëm lidhja tyre të shoqërohet me policat e sigurimi, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 9.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe në proces zbatimi.

10. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi mbetjet të tipit inerte (dhe, shtufë, materiale hidraulike; tubacione, saraçineska etj) të cilat krijohen për shkak të ndërhyrjeve dhe punimeve në infrastrukturë të projekteve të ndryshme, depozitohen në Landfill-in e Sharrës, i administruar nga shoqëria “I.. E.... BV SPV”.

Për vend depozitimin dhera dhe inerte tek Landfilli Sharrës për llogari të Shoqërisë (I... E.. BV SPV”, për vitin 2019 është faturuar vlera 12,879,558 lekë, është likuiduar vlera 11,759,763 lekë, për vitin 2020 është faturuar vlerë 490,315 lekë, është likuiduar vlera 1,602,325 (1,119,805 lekë mbetje nga viti 2019 dhe 490,315 nga viti 2020), për vitin 2021 është faturuar vlera 3,102,964 lekë, është likuiduar vlera 390,583 lekë, mbetur në diferencë pa likuiduar vlera 2,720,175 lekë, për periudhën janar-tetor 2022 është faturuar vlera 1,006,084 lekë, është likuiduar vlera 1,006,084 lekë.

Për këtë depozitim nuk ka kontratë të lidhur ndërmjet Shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” SHA dhe Shoqërisë “I... E... BV SPV”, veprim në kundërshtim me VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, pika 9. Faturim është bërë me çmimi 800 lekë/tonë inerte (mbetje nga ndërtimet dhe prishjet) dhe 246.7 lekë/tonë për dhera dhe shtuf.

Këto çmime janë vendosur nga Shoqëria (I.. E... BV SPV”, pa miratimin e Bashkisë Tiranë, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, pika 15. Transportimi është bërë nga UKT pa patur Licencën tipit III.2.B e

pajisur vet ose nëpërmjet nënkontraktore për transport të mbetjeve në destinacionin e përcaktuar, si dhe mjetet e angazhuara për këtë qëllim, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integrua të mbetjeve”, neni 57 “Transportuesit e mbetjeve”, pika 1 dhe 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të merren masa që për vend depozitimi i mbetjeve të tipit inerte (dhe, shtufë, materiale hidraulike; tubacione, saraçineska etj) të cilat krijohen për shkak të ndërhyrjeve dhe punimeve në infrastrukturë të projekteve të ndryshme, të lidhet kontratë/kontata ndërmjet Shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” SHA dhe operatorit/operatorëve ekonomik të përzgjedhur për këtë qëllim.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.2. Rekomandimi: Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” ti kërkoj Bashkisë Tiranë miratimin e çmimit të faturimit për/tonë inerte (mbetje nga ndërtimet dhe prishjet) dhe për dhera dhe shtuf etj.

Vazhdimisht

10.3. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të merren masa që shoqëria të pajisjet vet me Licencën tipit III.2.B, ose nëpërmjet kontraktorëve për transport të mbetjeve në destinacionin e përcaktuar.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 10.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

11. Gjetje nga auditimi: Likuidimet për llogari të (I. E... BV SPV”, për vend depozitimin e mbetjeve të tipit inerte (dhe, shtufë, materiale hidraulike; tubacione, saraçineska etj) të cilat krijohen për shkak të ndërhyrjeve dhe punimeve në infrastrukturë të projekteve të ndryshme, janë bërë pa situacion, pa formular vend depozitimi lëshuar (firmosur) nga Lanfilli dhe drejtuesi i mjetit që ka transportuar, pa firmosur prodhuesi i mbetjeve, shoqëruar me fletë peshën e impiantit, në kundërshtim me aneksin “Formati i dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme” të VKM nr. 575, datë 24.06.2015, pika 7, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Zotëruesit e mbetjeve inerte dhe operatorët e lëndësive të mbetjeve inerte janë të detyruar të plotësojnë dhe të nënshkruajnë dokumentin e transferimit të këtyre mbetjeve dhe të dhënat regjistrohen në Regjistrin e Transfertime Individuale, sipas VKM nr. 229, datë 23.4.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”.

UKM nr. 1, datë 16.06.2011, “Për disa ndryshime në UKM nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 3.3, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe 26, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, UMF

nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/b.

Mbetjet nuk janë klasifikuar sipas kodeve përkatëse në kundërshtim me VKM nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, pika 17 “Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (përfshi dhera të gërmuara nga zona të kontaminuara)” si dhe pika 20, mbetjet urbane (mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetje industriale e institucionale të ngjashme) përfshirë fraksionet e mbledhura veçmas: 20 02 02 “Dhera dhe gurë”; 20 02 03 “Mbetje të tjera të pabiodegradueshme”; 20 03 “Mbetje të tjera urbane”; 20 03 01 “Mbetjet e përziera urbane”; 20 03 04 “Llumra nga gropat septike”; 20 03 06 “Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza”; 20 03 07 “Mbetjet të vëllimshme”; 20 03 99 “Mbetjet urbane të paspecifikuara”. Procesverbalet të firmosura nga drejtuesit e automjeteve, M.V. me detyrë përgjegjës i transportit, dhe E.K me detyrë përgjegjës i sektorit të investimeve dhe kanalizimeve (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale administrimit të mbetjeve të tipit inerte jo vetëm fizikisht por dhe në mbajtjen e dokumentacion të plot tekniko-ligjor dhe likuidimit konform këtij dokumentacioni.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 10.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

12. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”, viti 2021, në preventiv dhe situacion për 211 objekte është përfshirë zëri “Instalimi i sistemit të ndërlidhjes të objekteve me qendrën e monitorimit” në vlerën 49,042,692 lekë me TVSH. Në qendrën e monitorimit (Zyrat Qëndrore UKT) instalimi i sistemit të ndërlidhjes të objekteve me qendrën e monitorimit është në vlerën 54,360,240 lekë me TVSH. Në total vlera për instalimin e sistemit të ndërlidhjes të objekteve me qendrën e monitorimit është 103,402,932 lekë.

Duke marr në konsideratë: Investimin e bërë për punime rrethimi depo & punime për furnizimin me energji & ndërtim sistem alarm+kamera në vlerën 522,237,830 lekë me TVSH në vlerat respektive 140,407,914 lekë, 46,612,456 lekë dhe 335,253,459 lekë; Vlerën 103,402,932 lekë për instalimin i sistemit të ndërlidhjes të objekteve me qendrën e monitorimit; Personelin e disponueshëm të UKT, pasi në strukturë organizative të shoqërisë është Sektori Call Center me 9 punonjës në organik, dispeçeria 5 punonjës, IT me personel 8, drejtues mjeti 56, punonjës të taks forcës 31, si dhe automjete 42 autovetura, 30 motor 36 minifugon; Zbatimin e VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”, Shtojca VI “Zonat e Mbrojtjes Sanitare”. Pika 2. Mbrojtja sanitare e burimeve të ujërave nëntokësore (Për furnizim publik ose individual) ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “... Mbrojtja e saj me roje të armatosur sigurohet nga administratori i ujësjetës”. Investimi nuk është maksimalizuar me efektivitet të

plotë në përputhje me qëllimin e tij (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të kësaj shoqërie, të merren masa që investimi të maksimalizohet me efektivitet të plotë në përputhje me qëllimin e tij, duke garantuar edhe mbrojtjen zonave të burimeve të ujërave nëntokësore.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 10.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

13. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Tuba dhe Rekorderi”, në vlerën 149,858,642 pa Tvsh, viti 2022, vlera e fondit limit (marrëveshja kuadër) është realizuar 100 % brenda 5 muajve.

Lidhja e kontratave është realizuar mbi bazën e marrëveshjes kuadër, e cila pavarësisht se ka ndikuar në uljen e çmimit për njësi, por si shpenzim ka shkuar tek fondit limit, duke rritur numrin e pjesëve/njësive dhe në rastin e audituar asnjëherë uljen e numrit të pjesëve/njësive si dhe pakësimin jo vetëm të fondit limit por edhe as të vlerës së prokuruar, dhe mbart në të ardhmen riskun e lart të përzgjedhjes së pjesëve/njësive me vlerë më të lart, duke mos arritur në këtë mënyrë uljen kostove të blerjeve/shërbimeve. Veprime në kundërshtim me Udhëzimet e APP nr. 6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, me ndryshimet vijuese të tij, pikat 7.1,7.2 dhe 7.3.

Në dokumentet e tenderit dhe në minikontratat e lidhura nuk është përcaktuar se tubat dhe rekorderit do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve) në zbatim të Rekomandimit të APP nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Duhet të respektohen termet e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqëruar të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandimi: Përdorimi i kësaj forme prokurimi detyrimisht duhet të arrij reduktimin e kostove transaksionale, përmirësimin e vazhdueshëm në harkun e marrëdhënieve afat-gjatë ndërmjet AK dhe Operatorëve Ekonomik, në interes të konsumatorit, në rastin konkret përmirësimin e Shërbimit të ujit për qytetarët.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i

Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 13.1,

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi.*

13.2. Rekomandimi: Nga autoriteti kontraktor të merren masa që në dokumentet e tenderit dhe në kontratat/minikontratat e lidhura të përcaktohet se mallrat/pajisjet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 *“Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 13.2, Rekomandimi është në proces vlerësimi.*

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *i pranuar dhe në proces zbatimi.*

14. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 06.10.2018-03.03.2021, Shoqëria ka kryer aktivitet pa qenë e licencuar nga Enti Rregullator i Ujit (ERU). Për këtë periudhë kjo shoqëri ka qenë në proces licencimi, duke shkëmbyer dokumentacion shkresor të njëpasnjëshëm me ERU. Pas datës 04.03.2021 kjo shoqëri është pajisur me Licencë me nr. 19, miratuar me vendim nr. 40, datë 06.10.2017 (afati 06.10.2017-05.10.2018), Licenca nr. 2 miratuar me vendim nr. 84, date 04.03.2021 me afat 04.03.2021 deri me 03.03.2023; Licenca nr. 2, miratuar me vendim nr. 150, date 01.04.2022 me afat 01.04.2022 deri me 03.03.2023. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, neni 15 dhe VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të liçensimit dhe procedurave për aplikim për licencë”, pika I/a/b/c (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1. Rekomandimi: Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale, rinovimit në kohë të licencave përkatëse sipas objektit të veprimtarisë saj brenda zonës së Shërbimit që ushtron aktivitet.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria “Ujësjetës Kanalizime Tiranë” sh.a është licencuar për një afat 4 vjeçar me Vendimin e KKRRU-së nr.5, datë 22.02.2023, me afat nga data 22.02.2023-21.02.2027. Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 *“Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka*

hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 14.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

15. Gjetje nga auditimi: Në vendim të Entit Rregullator i Uji nr. 84, date 04.03.2021 është përcaktuar drejtues ligjor E. K dhe drejtues teknik E. O dhe E. C, me licencim të shoqërisë me kategori A”, “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”, kategoria B “Për përpunimin e ujit për konsum publik” dhe kategorinë C”, “Për largimin e ujërave të ndotura. Deri 30.11.2022, datë që përfundon auditimi drejtuesit teknik të shoqërisë Enton Osmani, Edgar Cani dhe Elda Muçi me detyrë drejtor i departament të shitjes, nuk zotërojnë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tyre, sipas detyrës që ushtrojnë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura.

Këtë certifikatë nuk e kanë dhe 456 punonjësit që merren me menaxhimin e ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 2972 prot., datë 08.10.2019, i ka kërkuar listën e punonjësve subjekt certifikimi dhe formularët e deklaramit të punësimit dhe arsimit të Shoqërisë “Ujësjellës kanalizime Tiranë” Sha.

Shoqëria me shkresën nr. K-2355/1 prot, datë 11.09.2019 dhe shkresën nr. K-2645/1 prot, datë 21.10.2019, ka dërguar listën emërore të punonjësve, diplomën/dëftesë e noterizuar ose e njësuar me vulën e institucionit dhe formularin e deklaramit.

Që nga data 21.10.2019 deri më 30.11.2022 datë që përfundoj auditimi, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, nuk ka dërguar asnjë certifikim. Veprim në kundërshtim me Statutin e Shoqërisë i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 1, datë 08.01.2019, neni 19/c “Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit teknik” dhe Udhëzimi i MIE nr. 660, datë 28.09.2018 “Për krijimin dhe zbatimin e programit Kombëtar të Trajnimit dhe Certifikimit bazuar në testimin në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura”, neni 5 pika 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë ti prezantohet/kërkohet zyrtarisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë pajisjen me certifikatat përkatëse për aftësimin specifik profesional të stafit menaxherial si dhe për 456 punonjësit, sipas detyrës që ushtrojnë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura, ose të lëshimit nga kjo Ministri të vërtetimit për pamundësinë objektive për pajisjen me këto certifikata.

Brenda datës 30.06.2023

Komenti i subjektit: UK Tiranë është në pritje të nxjerrjes së udhëzimeve nga ana e MIE dhe rekomandimi është i pranuar dhe në proces zbatimi.

Komenti i audituesve: Për sa më sipër rekomandimi është *pranuar dhe në proces zbatimi*, do të verifikohet në vazhdimësi.

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “W...” shpk, me objekt “Blerje elektropompa”, viti 2019, në vlerën 14,383,998 lekë, viti 2019, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, mungesë e cila nuk mundëson grupin e auditimit të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e elektropompave. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690, UMF nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35, Ligjin nr. 10489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin

dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1. Rekomandimi: Nga autoriteti kontraktor të merren masa që në dokumentet e tenderit dhe në kontratat/minikontratat e lidhura të përcaktohet se mallrat/pajisjet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Në kontratat e lidhura janë përcaktuar specifikimet përkatëse në përputhje me udhëzimet e APP-së.

Komenti i audituesve: Për sa më sipër rekomandimi është i pranuar dhe në proces zbatimi në vijimësi.

17. Gjetje nga auditimi: Për përdorimin e objektit/ndërtesës Shoqëria ka lidhur me qiradhënësin kontratën nr.5554 rep, nr.3559 koleksioni, datë 21.09.2022, me Shoqërinë “K...” Shpk.

Në nenin 4, pika 4.6, përcaktohet se: “Qiradhënësi ka të drejtë të siguroj pronën objekt qiraje, pronë një shoqërie të licencuar sigurimi nga humbja ose dëmtimi nga rreziqet e siguruar për një shumë të vlerësuar nga qiradhënësi si kosto e plot e rindërtimi. Rreziqet e Siguruara: Humbja dhe dëmi nga zjarri, rrufetë, shpërthimi, goditja e objekteve fluturuese dhe pjesëve apo ngarkesave të tyre, tërmeti, stuhitë, përmytjet, shpërthimi ose dëme nga uji, shembje dhe çdo rrezik tjetër kundër të cilit Qiradhënësi vendos të sigurohet herë pas herë (nga të cilat përjashtohen kufizimet dhe përjashtimet e vendosura nga siguruesit) dhe Rrezik i Siguruar është secili prej tyre”. Deri më 30.11.2022 që përfundoj auditimi, Polica e sigurimit nuk është pjesë përbërëse e kontratës, siç përcaktohet në nenin 4, pika 4.6. Pavarësisht se palët kanë vendosur me vullnet të lirë në kontratë detyrimin e palës Qiradhënëse për sigurimin e pronës objekt i kontratës së qirasë, ky detyrim kontraktual dhe ligjor nuk është përmbushur. Qiradhënësi nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, nenet 801-825 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1. Rekomandimi: Organet Drejtuese të Shoqërisë, të marrin masa për të negociuar me Shoqërinë ”K...” Shpk për të siguruar pronën objekt qiraje, në një shoqëri të licencuar sigurimi nga humbja ose dëmtimi nga rreziqet e siguruar. Në rast mos sigurimi të pronës të zgjidhet kontrata e qirasë.

Brenda datës 30.06.2023

Komenti i subjektit: Me qiramarrësin e godinës është lidhur kontrata Nr. 17003/1 Prot. datë 22.09.2022, neni 4 pika 4.6 është përcaktuar edhe sigurimi i ambjeteve të mara me qira nga UK Tiranë ku citohet “ Qiradhënësi ka detyrimin të siguroj pronën objekt kontrate “duke përjashtuar zotrimet, përmirësimet ose ndryshimet e pa miratuara të qiramarrësit ose të vizitorëve të tjerë” pranë një shoqërie të licencuar sigurimi me reputacion të mirë nga humbja ose dëmtimi nga rreziqet e siguruar për një shumë të vlerësuar nga qiradhënësi, si kosto e plotë e rindërtimit.....”

Komenti i audituesve: Referuar kontratës së qirasë rekomandimi është i pranuar dhe në proces zbatimi.

18. Gjetje nga auditimi: Investimi (Depo uji Shkozë viti 2018 dhe godinë Shoqëria“, është kryer pa leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 29, neni 39 pika 1, VKM nr. 408, datë 13.5.2015,

“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar neni 9 dhe 11, Ligji nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, neni 14 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1. Rekomandimi: Nga Shoqëria të merren masa për të korigjuar këtë praktikë për ndërtimet dhe rikonstruksionet e objekteve, me qëllim jo vetëm kryerja e tyre të bëhet me leje ndërtimi, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 18.1, Rekomandimi është pranuar dhe në proces zbatimi sipas rastit.

Komenti i audituesve: Për sa më sipër rekomandimi është në proces zbatimi ku UKT do të kerkojë leje para kryerjes së investimit.

19. Gjetje nga auditimi: Departamentet Inxhinierik/Operacional nuk kanë zbatuar plotësisht rregulloren e UKT SHA në lidhje me formalizimin e veprimtarisë së përditshme operationale të strukturave të tyre sipas organigramës të Shoqërisë. Konkretisht nga këta departamente është vepruar në kundërshtim me kërkesat rregullatore dhe në mosbatim të detyrave funksionale sipas hierarkisë të përcaktuara në këtë Rregullore.

Kjo vërehet në projektet/preventivat, situacionet, urdhrat, akt kolaudimet, marrjet në dorëzim, korrespondenca ku delegimi/autorizimi/urdhri për zbatim të veprimeve operationale është kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme nga Drejtorët e Departamenteve në instanca specifike të vartësisë pa respektuar hierarkinë institucionale dhe në raste të veçanta dhe anasjelltas. Kjo krijon risk të lart në mos rakordancë të ndërveprimit zyrtar të zhvilluar ndërmjet tyre lidhur me: Zbatimin, raportimin, monitorimin, duke mos sjellë në vëmendje pranë strukturave të këtyre Departamenteve dhe Titullarit të Shoqërisë, mos realizmin e detyrimeve dhe përgjegjësiive ligjore të punonjësve të ngarkuar sipas rregullores. Veprim në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të UKT SHA me Nr. U-44/1 prot., datë 05.02.2021, të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, datë 12.12.2016, Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 1, datë 24.01.2018, nr. 9, datë 30.04.2019, nr.1, datë 27.01.2021 dhe nr.7, datë 29.06.202, Ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II-“Përgjegjshmëria menaxheriale”, neni 8 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1. Rekomandimi: Nga drejtorët e Departamentit Inxhinierik/Operacional të merren masa për të korigjuar këtë praktikë në lidhje me caktimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e detyrave të punonjësve në veprimtarinë e përditshme operationale, me qëllim jo vetë kryerja e tyre të bëhet sipas hierarkisë institucionale, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të Departamentit, për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i

Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 7.1, Rekomandimi pranohet dhe zbatohet në vijimësi, pasi praktikat shkresore kalojnë dhe nënshkruhen nga punonjësit sipas shkallës së hierarkisë sipas rregullores së brendshme dhe strukturës organizative.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

20. Gjetje nga auditimi: Shoqëria Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a funksionon me një strukturë pagash të miratuar nga organet drejtuese të saj nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.17, datë 12.12.2016 dhe nr.1, datë 24.01.2018 dhe Asambleja e Aksionarëve me Vendimin nr.18, datë 14.12.2016.

Në këtë strukturë vendosja e nivelit të pagës për secilin pozicion nuk është vlerësuar bazuar në kriteret të mirë përcaktuar si arsimimi (niveli i diplomës si master shkencor, master profesional, bachelor apo diplomë e shkollës së mesme), kualifikimi (njohuritë nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet etj) përgjegjësia (shkalla e përgjegjësisë në funksion të riskut që mund të ketë puna që kryhet) etj.

Niveli i pagave në aneksin B të Rregullores së brendshme ka përcaktuar një sistem pagash sipas ndarjes së klasave dhe niveleve të kualifikimit duke i ndarë ato në dy shkallë ku kategorizohet paga pa vendosur kriteret të mirë përcaktuara. Tabela përbëhet nga pesë klasë (klasifikim) KL, KN, A, B,C. Këto klasa nuk janë të ndara më me nënklasa por vetëm me nivele kualifikimi me nga dy shkallë page. Kriteret e përcaktuara në relacionin shpjegues janë: Eksperiencia në profesione; Niveli i diplomës dhe i Master-it; Liçencat; Vështirësitë e vendit të punës dhe Gradat shkencore. Këto kriteret nuk janë specifikuar për secilin pozicion pune në tabelën e pagave për të bërë diferencën mes niveleve të pagave. Si shembull marrim një specialist të burimeve njerëzore që është përcaktuar tek kategoria KN/2, nëndarja 1, me shkallë page minimale 62,500 lekë/muaj dhe maksimale 65,500 lekë/muaj dhe një specialist të Sektorit të Projekteve të Huaja që përcaktohet tek kategoria KN/2, nëndarja 2, me pagë minimale 60,000 lekë/muaj dhe maksimale 62,500 lekë/muaj. Kjo diferencë vihet re edhe ndërmjet pozicioneve ku një Përgjegjës Sektori në Njësi (faturimi) kategorizohet me nivel page më të ulët se një Specialist i Burimeve Njerëzore. Po kështu konstatohet se në tabelën e pagave ka përcaktime të tilla si specialist i parë, specialist i dytë, specialist i tretë, specialist i kualifikuar në detyrë. Për këto ndarje nuk janë vendosur kriteret që duhet të plotësojë një punonjës që të paguhet si i tillë. Ndërkohë që një punonjës të kategorizohet si “Specialist i parë” duhet minimalisht të ketë përfunduar master shkencor, për nivelin e “specialist i dytë” punonjësi duhet që punonjësi të ketë përfunduar master profesional dhe specialist i tretë punonjësi duhet të ketë përfunduar bachelor-in. Po kështu edhe për “Specialist të kualifikuar në detyrë” duhet të ishin vendosur kriteret të tilla si eksperiencia e gjatë në të njëjtin vend pune etj.

Brenda një Drejtorie, Përgjegjësit e Sektorit që përbëjnë këtë drejtori nuk kanë të njëjtën shkallë page. Kjo vërehet në rastin e Drejtorisë Juridike ku Përgjegjësi i Sektorit të Aseteve dhe Përgjegjësi i Sektorit të Përfaqësimit Ligjor paguhet me pagë bazë 69,500 lekë/muaj ndërkohë që Përgjegjësi i Sektorit të Asistencës Ligjore paguhet me pagë 76,500 lekë/muaj. Në Drejtorinë e Prokurimeve, specialistët nuk paguhet sipas kategorisë së vendosur në tabelë, KN/1, nëndarja 2, me pagë minimale 65,500 dhe pagë maksimale 69,500, por me pagë më të ulët. Ky veprim bien ë kundërshtim me tabelën e miratuar të pagave. Nga krahasimi i pagave ndërmjet departamenteve

rezulton se specialistët e Departamentit të Shitjes kanë paga më të ulëta se specialistët e departamenteve të tjerë. Edhe ky diferencim nuk është i argumentuar me kritere objektive (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20.1. Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të Shoqërisë të rishikohen dhe llogariten nivelet e pagave të punonjësve duke u bazuar në kritere të mirë përcaktuar si arsimimi (niveli i diplomës si master shkencor, master professional, bachelor apo diplomë e shkollës së mesme), kualifikimi (njohuritë nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet etj) përgjegjësia (shkalla e përgjegjësisë dhe vështirësisë në funksion të riskut që mund të ketë puna që kryhet) etj, duke shmangur pagesat me diferenca të konsiderueshme për punonjësit me natyrë të njëjtë pune dhe duke synuar motivimin e tyre.

Brenda datës 30.06.2023

Komenti i subjektit: Rekomandimi është pranuar dhe zbatuar. Tabela e pagave të punonjësve të shoqërisë është ndryshuar dhe miratuar me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë nr.13, datë 29.12.2022.

Komenti i audituesve: Referuar Vendimit të Asamblesë Nr. 13, datë 29.12.2022 rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i zbatuar*.

21. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” SHA ushtron veprimtarinë e saj me Seli në adresën Rruga “Kavajës”. Për përdorimin e objektit/ndërtesës Shoqëria ka lidhur me qiradhënësin, kontratën e qirasë nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019, kontratë e ndryshuar me kontratën nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021.

Në nenin 9, paragrafi 9.2 të Kontratës së qirasë 2, Palët janë të detyruar që në fillim të çdo viti, të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta, për realizimin e detyrimeve në derdhjet e pagesës, në nivelin e investimit dhe kamatat ose gjobat (kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate. Aktet e rakordimit janë pjesë e dosjes së qiradhënies.

Në nenin 6, paragrafi 6.5 të Kontratës së qirasë nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019 të ndryshuar me nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021 dhe nr.5553 rep, nr.kol 3558, datë 21.09.2022 është përcaktuar se: 6.5 Qiramarrësi duhet të marre masat e nevojshme që Sendit t’i mund të behet një mirëmbajtje e zakonshme në terma ditore, javore, mujore dhe vjetore, duke përfshirë zëvendësimin e pjesëve të këmbimit në rast dëmtimi nga përdorimi. Për këtë qëllim Qiramarrësi duhet t’i dorëzojë Qiradhënësit një plan mirëmbajtje vjetore të asetit, godinës dhe sistemeve që janë pjesë e godinës (mure, sisteme, oborr, pemë, gjelbërim etj).Plani duhet të përmbajë të detajuar mirëmbajtjen e të gjithë asetëve dhe sistemeve përbërëse të objektit. Qiramarrësi duhet t’i dërgojë çdo muaj procesverbalet e mirëmbajtjes Qiradhënësit, sipas procesverbalit tip bashkëngjitur kësaj shtese kontrate, si Aneksi 3.

Nga verifikimi i dosjes së zbatimit të kontratës së qirasë rezulton se nuk është mbajtur asnjë akt rakordim ndërmjet palëve (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa që në zbatim të detyrimeve kontraktuale të mbajnë me qiradhënësin akt-rakordime dy palëshe për evidentimin e derdhjeve të qirasë mujore, investimet e kryera dhe kompensimin financiar të tyre nga qiradhënësi, realizimin e planit të mirëmbajtjes së objektit, kamatat ose gjobat nëse ka.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i

Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 21.1, Grupi i punës ka kryer rakordimet sipas kontratave përkatëse.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *i pranuar dhe i zbatuar.*

22. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Administrimit nuk ka analizuar raportin për ecurinë e shoqërisë, raport që administratori duhet ta paraqesë një herë në muaj në këshill, si dhe nuk ka kryer verifikim dhe kontroll të llogarive vjetore të shoqërisë brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar. Veprim në kundërshtim me VKM nr.63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë Shoqërian e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” neni 18, pika 7, gërma ç (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

22.1. Rekomandimi: Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrës të analizojë një herë në muaj raportin e ecurinë së shoqërisë për realizuar performancën/objektivat në terma vjetorë të parashikuar.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Rekomandimi është zbatuar. Departamentet e shoqërisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike kanë kaluar një herë në muaj raportin mujor të treguesve të shoqërisë në Këshillin e Administrimit të shoqërisë (sipas Vendimeve të Këshillit të Administrimit nr.4, datë 28.02.2023 “Për miratimin e analizës së treguesve ekonomik financiarë të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, për muajin Janar 2023”, nr.6, datë 31.03.2023 “Për miratimin e analizës së treguesve ekonomik financiarë të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, për muajin Janar 2023-Shkurt 2023”, nr.7, datë 05.05.2023 “Për miratimin e analizës së treguesve ekonomik financiarë të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, për muajin Janar 2023-Mars 2023”, nr.10, datë 31.05.2023 “Për miratimin e analizës së treguesve ekonomik financiarë të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, për muajin Janar 2023-Prill 2023”, nr.14, datë 12.07.2023 “Për miratimin e analizës së treguesve ekonomik financiarë të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, për muajin Janar 2023-Maj 2023”, nr.15, datë 12.07.2023 “Për miratimin e analizës së treguesve ekonomik financiarë të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, vitin 2022”, nr.17, datë 31.07.2023 “Për miratimin e analizës së treguesve ekonomik financiarë të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, për muajin Janar 2023-Qershor 2023”, nr.19, datë 30.08.2023 “Për miratimin e analizës së treguesve ekonomik financiarë të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, për muajin Janar 2023-Korrik 2023”, nr.20, datë 28.09.2023 “Për miratimin e analizës së treguesve ekonomik financiarë të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, për muajin Janar 2023-Gusht 2023”, nr.26, datë 31.10.2023 “Për miratimin e analizës së treguesve ekonomik financiarë të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, për 9 mujorin e vitit 2023”.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i zbatuar.*

22.2. Rekomandimi: Nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrës të merren masa për të bërë verifikimin dhe kontrollin e llogarive vjetore të shoqërisë brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 22.2, Rekomandimi pranohet dhe është në proces vlerësimi.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *i pranuar dhe në proces zbatimi.*

23. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Aksionarëve nuk kanë miratuar brenda afatit 6 mujor nga data e mbylljes së vitit financiar rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe destinimin e fitimit. Veprim në kundërshtim me Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar neni 33/1, pika 1 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23.1.Rekomandimi: Nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrës dhe Asambleja e Aksionarëve të merren masa për të miratuar brenda afatit 6 mujor nga data e mbylljes së vitit financiar, rezultatit financiar të vitit paraardhës dhe destinacionin e fitimit.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 23.1, rekomandimi është i pranuar dhe po zbatohet sipas legjislacionit në fuqi ku ai i më parshmi është shfuqizuar.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi.*

24. Gjetje nga auditimi: Niveli i pagave është miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 1, datë 30.01.2019, por jo nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve (Bashkia Tiranë).

Këshilli i Administrimit dhe Drejtori i Përgjithshëm e kanë quajtur të ezauruar miratimin e nivelit të pagave për periudhën kohore 01.09.2018-31.10.2022, referuar Vendimit të Assamblesë së përgjithshme nr. 18, datë 14.12.2016, si dhe me miratimin e programit ekonomik të çdo viti, ku pjesë e tij është edhe fondi i pagave. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” i ndryshuar, neni 6, pika 11 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

24.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit në të ardhmen të merren masat për miratimin e nivelit të pagave nga Asambleja Aksionare (Bashkia Tiranë) duke zbatuar në këtë mënyrë detyrimet ligjore në mirë organizimin dhe mirëfunksionimin e Shoqërisë.

Brenda datës 30.06.2023

Komenti i subjektit: Rekomandimi është zbatuar. Tabela e klasifikimit të pagave është miratuar Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë nr.13, datë 29.12.2022.

Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 24.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i zbatuar.*

25. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “UK Tiranë” sha nuk operon me Drejtor Tregtar, pasi detyrat e tij kryhen nga Drejtoria Ekonomike dhe Departamenti i Shitjes. Veprim në kundërshtim me Nenin 20, pika 2/c të VKM nr.63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë Shoqërian e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, ku citohet: “Drejtori Tregtar harton planbuxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv” dhe Nenin 20, pika 2/c në Statutin e “UKT” sha me nr. 08/2 prot., datë 13.12.2021, ku citohet: “Drejtori Tregtar harton planbuxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1. Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të Shoqërisë të bëhet unifikimi i strukturës organizative me statutin e Shoqërisë dhe VKM nr. 63, datë 27.01.2016.

Brenda datës 30.06.2023

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 25.1. Rekomandimi është në proces vlerësimi pasi pozicionet sipas strukturës së miratuar bazuar në legjislacion egzistojnë por duhet ndryshuar emërtimi i tyre.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi.*

26. Gjetje nga auditimi: Referuar strukturës organizative të “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sha, të miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 20, datë 29.09.2022 “Për miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative të shoqërisë, për vitin 2021” janë punësuar 1382 punonjës dhe ndër ta 105 punonjës janë pompistë/pompist klorinues, 6 prej tyre nuk janë të pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, neni 9, pika 1, gërma “a” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa për pajisjen e punonjësve me profesion elektrikistë/elektropompist me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, në përputhje sipas dispozitave ligjore.

Brenda datës 30.06.2023

Komenti i subjektit: Rekomandimi është pranuar dhe zbatuar referuar listës së punonjësve të cilët janë pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

Komenti i audituesve: Referuar dëshmimeve të vendosura në dispozicion rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

27. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2018-26.11.2021, periudhë para miratimit të “Manualit të procedurave të Drejtorisë së Burimeve të shoqërisë “UK Tiranë” sha” me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 25, datë 26.11.2021, u konstatua se mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Evidentohet në disa raste mungesa e deklaratimeve për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Tiranë, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira. Evidentohen që për të njëjtin pozicion pune nuk janë të njehësura kriteret e nevojshme për punësim. Ndërsa gjatë periudhës 26.11.2021-31.10.2022, u konstatua se Manuali i procedurave të Drejtorisë së Burimeve nuk parashikon procedura mbi shpalljen e vendeve vakante. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë Shoqërianë e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, Statuti dhe Rregullorja e brendshme e UK Tiranë Sh.a (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të bëhen parashikime të detajuara statutores dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.

Brenda datës 31.08.2023

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 27.1, Rekomandimi pranohet dhe është në proces vlerësimi.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar në vijimësi*.

27.2. Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë të përcaktohet në deklaratimet për pozicione të lira pune, edhe afati brenda të cilit të interesuarit për pozicionin e punës duhet të shprehin interesin dhe paraqesin dokumentacionin e nevojshëm provues.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 27.2, Rekomandimi është në proces vlerësimi dhe po zbatohet nga drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar në vijimësi*.

28. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi janë shpërblyer punonjësit në vlerën 126,056,093 lekë.

Shpërblimet janë dhënë me Urdhër të Brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm, dhe jo me miratim nga Këshilli i Administrimit, pasi janë konsideruar të ezauruara me miratimin e programit ekonomik sipas viteve: Me vendim të Këshillit të Administrimit nr.18, datë 12.12.2018 është miratuar Buxheti i shoqërisë, për vitin 2019, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 16, datë 13.12.2018; me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 24, datë 19.12.2019 është miratuar Buxheti i shoqërisë, për vitin 2020, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr.11, datë 20.12.2019; me vendim të Këshillit të Administrimit nr.9, datë 04.11.2020 është miratuar Buxheti i shoqërisë, për vitin 2021, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 7, datë 05.11.2020 dhe me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 24, date 26.11.2021 është miratuar Buxheti i shoqërisë për vitet 2022”, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendimi nr.10, datë 13.12.2021. Veprim në kundërshtim me - Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, i ndryshuar, neni 6, pika 1, gërma b, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 160 “Shpërblimi”, pika 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

28.1. Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese t’i kushtohet vëmendje e duhur Institucionale shpërblimit të punonjësve.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 28.1, Rekomandimi është në proces vlerësimi.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *në proces zbatimi*.

29. Gjetje nga auditimi: Ka mospërputhje midis kontratës kolektive dhe kontratës individuale të punës në lidhje me shkallëzimin (klasifikimin) e masave disiplinore.

Konkretisht në kontratën individuale të punës, Neni 13 “Masat disiplinore”, të cilat shkallëzohen në: prerje e pagës për ditë pune kur nuk respektohet orari i punës ose largohesh pa leje, vërejtje

me shkrim, gjobë nja jo më pak se 1000 (një mijë) lekë deri në një pagë mujore, vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna, transferim nga vendi i punës dhe caktimi në një vend tjetër me pagë më të ulët deri në 6 muaj, pushim nga puna”.

-Në kontratën kolektive, Neni 22 “Masat disiplinore”, pika , “Për të garantuar zbatimin e plotë të kontratës së punës dhe për të siguruar një veprimtari sa më normale e ligjore të marrëdhënieve të punës, për shkeljet e ndryshme të disiplinës dhe për moszbatim të kushteve të kontratës palët ranë dakord të përcaktohen këto masa disiplinore:

Vërejtje me shkrim; Mbajtja e pagës kur punëmarrësi largohet pa leje nga vendi i punës; Transferim nga vendi i punës dhe caktim në një vend tjetër me pagë më të ulët deri në 6 muaj; Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna; Largim nga puna” .

Në manualin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk është e cituar tek llojet e masave disiplinore: “gjobë nja jo më pak se 1000 (një mijë) lekë deri në një pagë mujore”, ndërkohë që në kontratën individuale të punës është një nga llojet e masave disiplinore. Veprim në kundërshtim me Kontratën kolektive e lidhur midis Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” Sha dhe Sindikatës, me nr. 7720/4 prot., datë 16.07.2018e UKT sha, në Nenin 4 “Fusha e zbatimit”, pika 3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

29.1.Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa për të bërë unifikimin e kontratës kolektive dhe kontratës individuale të nëpunësve në lidhje me klasifikimin (shkallëzimin) e masave disiplinore.

Brenda datës 30.09.2023

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 29.1,

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se vlerësimet e performancës së punonjësve ruhen jashtë dosjeve të personelit dhe në asnjë nga rastet e kontrolluara nuk ishin të firmosura nga Drejtori i Përgjithshëm i UKT sha. Veprime në kundërshtim me manualin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të shoqërisë së “UK Tiranë” sha, pika 1.11 “Vlerësimi i performancës në punë”, faqe 38 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

30.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që vlerësimet e performancës në punë të punonjësve të bëhen çdo vit dhe të firmosen nga Eprori Direkt dhe Drejtori i Përgjithshëm, pasi ato janë tregues mjaft të rëndësishëm për performancën e shoqërisë.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të

KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 30.1, Rekomandimi pranohet dhe është në proces vlerësimi dhe zbatimi.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i zbatuar*.

31. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2019 dhe 2020 nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit të Administrimit dhe Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve. Konkretisht: Për vitin 2019 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr.18, datë 12.12.2018 "Mbi miratimin e Buxhetit të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a, për vitin 2019". Ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim nr. 16, datë 13.12.2018 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve.

Për vitin 2020 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 24, datë 19.12.2019 "Mbi miratimin e Buxhetit të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a, për vitin 2020".

Ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim nr. 11, datë 20.12.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

31.1. Rekomandimi: Organet Drejtuese të Shoqërisë të miratojnë në kohë programin ekonomik financiar (buxhetin vjetor) për një menaxhim me një efektivitet më të lartë të shoqërisë.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 "*Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë "Ujësjiellës Kanalizime Tiranë" sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023*", Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 31.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i zbatuar*.

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i hartimit, shqyrtimit, zbatimit dhe raportimit të programit ekonomik-financiar u konstatua se ka zëra të cilët kanë patur mosrealizim të vlerave të miratuara. Konkretisht zërat: -Arkëtimi nga shërbimet e tjera për vitin 2018 është planifikuar 4,780.18 mln lekë dhe është realizuar 4,546.40 mln lekë, pra kemi një realizim në masën 95.1% kundrejt planifikimit vjetor; për vitin 2019 është planifikuar 4,841.26 mln lekë dhe është realizuar 4,312.24 mln lekë, pra kemi një realizim me 89.07%; për vitin 2020 është planifikuar 4,772.17 mln lekë dhe është realizuar 4,176.69 mln lekë, pra kemi një realizim me 87.52% kundrejt planifikimit vjetor.

-Zëri Roje Objektiv: për vitin 2018 Plani 489.28 mln lekë, fakti 518.34 mln lekë ose realizuar në masën 105.94 %; për vitin 2019 Plani 489.28 mln lekë, fakti 518.34 mln lekë ose realizuar në masën 105.94%; për vitin 2021 Plani 45.70 mln lekë, fakti 286.45 mln lekë ose realizuar në masën 626.8%.

-Zëri Qira zyra: për vitin 2018 Plani 27.82 mln lekë, fakti 34.66 mln lekë ose realizuar në masën 124.59%.

-Zëri Konsulencë tekniko-ekonomike: për vitin 2018 Plani 37.35 mln lekë, fakti 76.34 mln lekë ose realizuar në masën 204.39%; për vitin 2019 Plani 23.35 mln lekë, fakti 45.11 mln lekë ose realizuar në masën 193.16%; për vitin 2020 Plani 13.20 mln lekë, fakti 18.15 mln lekë ose realizuar

në masën 137.48%; për vitin 2021 Plani 12.15 mln lekë, fakti 16.58 mln lekë ose realizuar në masën 136.46%.

-Zëri Shpenzime postare: për vitin 2018 Plani 0.30 mln lekë, fakti 0.33 mln lekë ose realizuar në masën 109.33%; për vitin 2020 Plani 0.2 mln lekë, fakti 0.22 mln lekë ose realizuar në masën 109.59%; për vitin 2021 Plani 0.2 mln lekë, fakti 0.27 mln lekë ose realizuar në masën 135%.

-Zëri Shpenzime të përgjithshme: për vitin 2018 Plani 4.5 mln lekë, fakti 184.58 mln; për vitin 2019 Plani 38.68 mln lekë, fakti 153.87 mln lekë ose realizuar në masën 397.8%; për vitin 2020 Plani 18.05 mln lekë, fakti 65.86 mln lekë ose realizuar në masën 364.9%; për vitin 2021 Plani 19.8 mln lekë, fakti 77.24 mln lekë ose realizuar në masën 390.1%.

-Zëri taksa vendore dhe pasurie: për vitin 2018 Plani 3 mln lekë, fakti 3.73 mln lekë ose realizuar në masën 124.33%; për vitin 2021 Plani 3 mln lekë, fakti 5.98 mln lekë ose realizuar në masën 199.3%.

-Zëri Gjoha penalitete dhe dëmshpërblime: për vitin 2018 Plani 38.01 mln lekë, fakti 73.77mln lekë ose realizuar në masën 194.08%; për vitin 2019 Plani 22.59 mln lekë, fakti 52.09 mln lekë ose realizuar në masën 230.54%; për vitin 2020 Plani 40 mln lekë, fakti 51.02 mln lekë ose realizuar në masën 127.55%.

Mosrealizimi i treguesve ekonomik në raport me programin tregon se shoqëria nuk ka arritur të plotësojë objektivat e saj (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

32.1. Rekomandimi: Organet Drejtuese të Shoqërisë të marrin masa në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të programit ekonomik, për hartimin e një programi real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 32.1, Rekomandimi pranohet dhe është në proces vlerësimi.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i zbatuar*.

32.2. Rekomandimi: Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e programeve ekonomike paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet sipas zërave përkatës.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 32.2, Rekomandimi pranohet dhe është në proces vlerësimi.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

33. Gjetje nga auditimi: Për periudhën e auditimit, përqindjet e arkëtimit vjetor total krahasuar me faturimin vjetor, janë në rritje nga viti në vit krahasuar me vitin 2018 (fillimi i periudhës së auditimit). Megjithatë arkëtimi korrent është ai që tregon arkëtimin e faturimit të viteve përkatëse, dhe në fakt pavarësisht rritjes progresive është nën normat e konsideruara të pranueshme nga ERRU etj. Për sa i përket arkëtimit të debive të prapambetura, shoqëria ka akoma një vlerë të konsiderueshme të debisë për të mbledhur, pavarësisht përpjekjeve të saj për lidhjen e aktmarrëveshjeve me debitorët apo dërgim në përmbarim. Shoqëria duhet të ketë në konsideratë se norma e arkëtimit është një nga treguesit më të rëndësishëm të shoqërisë e cila lidhet me qëndrueshmërinë financiare të Shoqërisë dhe me aftësinë e saj paguese.

Konkretisht në vitin 2018 arkëtimet totale janë në vlerën 3,580,578.7 lekë, ku arkëtimet korrente janë në vlerën 3,050,137.19 lekë ose 85.19% dhe arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 530,441.51 lekë ose 14.81%. Në vitin 2019, arkëtimet totale janë në vlerën 3,677,567.58 lekë, ku arkëtimet korrente janë në vlerën 3,285,232.98 lekë ose 89.33% dhe arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 392,724.88 lekë ose 10.67%. Në vitin 2020, arkëtimet totale janë në vlerën 3,294,391.56 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 3,127,150.78 lekë ose 94.92%, ndërsa arkëtimet e prapambetura në vlerën 167,240.78 lekë ose 5.08%. Në vitin 2021, arkëtimet totale janë në vlerën 3,617,808.51 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 3,226,312.65 lekë ose 89.18%, ndërsa arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 391,495.87 lekë ose 10.82 %. Në periudhën 01.01.2022-31.10.2022, arkëtimet totale janë në vlerën 3,054,052 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 2,793,901.41 lekë ose 91.48 %, ndërsa arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 260,150.59 lekë ose 8.52 % Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e Shërbimit të UK”, pjesa II pika 4, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, neni 1, Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, pika 6, Kontratën e Shërbimeve Ujësjiellës Kanalizime, miratuar me vendim të KKRR Nr. 25, datë 08.07.2015 “Kontratë për shërbime Ujësjiellës-Kanalizime e përditësuar” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

33.1. Rekomandimi: Organet Drejtuese të Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” SHA, (Drejtori i Përgjithshëm, Këshilli i Administrimit, Asambleja e Përgjithshme) të marrin masa për rritjen e arkëtimeve duke reduktuar humbjet menaxheriale të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve germa B, pika 33.1, Rekomandimi pranohet dhe është në proces vlerësimi.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

34. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i regjistrave të parashikimit dhe realizimit për periudhën objekt auditimit konstatohet se në 80% të rasteve fondi limit i parashikuar që në hartimit e regjistrat ka qenë 800,000 lekë, pra në kufirin maksimal të lejimit të zhvillimit të kësaj

procedure, çka tregon se nuk kemi një planifikim nevojë të mirëfilltë i cili duhet të vijë nga nevoja konkrete. Gjithashtu konstatohet se ka një copëzim fondesh me qëllim e përdorimit të procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla duke anashkaluar procedurat e tjera. Veprim në kundërshtim me VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 1,2 dhe 3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 65-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

34.1. Rekomandimi: UKT Sha dhe njësia përkatëse e planifikimit të procedurave të prokurimit të marrin masa që në të ardhmen të parashikojnë saktë dhe përzgjedhin procedurat e duhura duke rritur konkurrencën dhe përdorimin me efektivitet të fondeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 34.1, Rekomandimi pranohet dhe zbatohet në vijimësi.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i zbatuar*.

35. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha kontratat e audituara, nga dokumentacioni i administruar në dosjet teknike, konstatohet se; të gjitha proces verbalet për punimet e maskuara nuk janë të shoqëruara me pamje fotografike, për secilin prej tyre, siç kërkohet në kontratat e mbikëqyrjes së punime civile. Materiali fotografik, që ndodhet në dosje, është i përgjithshëm pa përcaktuar pika referimi se në cilën pjesë të projektit janë kryer këto punime. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe Kontratat e Mbikëqyrjes së punimeve, pika 5.2 (në të gjitha kontratat e audituara) (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 92- 181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

35.1. Rekomandimi: Shoqëria UK Tiranë gjatë marrjes në dorëzim të dosjeve teknike, për kontratat e përfunduara, të kryej një kontroll më të detajuar që këto dosje të jenë të plotësuara në përputhje me kërkesat e kontratës që të bëhet e mundur verifikimi i punimeve të maskuara edhe në një periudhë të mëvonshme nga ana e niveleve të kontrollit.

Menjëherë e në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 35.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i zbatuar*.

36. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “UKT Tiranë” SHA është penalizuar në vlerën 34,992,188 lekë nga mos zbatimi i procedurave gjyqësore me përfitues Y.V po në të njëjtën vlerë, për mos

respektim të afatit të ankimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, veprim në kundërshtim Ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i procedurës civile i Republikës së Shqipërisë neni 443 dhe 450/1/a. Ky konflikt gjyqësor është krijuar nga përdorimi i pasurisë së paluajtshme e llojit “Pyll” me sipërfaqe 2200 m² ndodhur në Zonën Kadastrale 2380, me nr.pasurisë.11/21/163 në Lanabregas Tiranë.

Ekzekutimi i Vendimit nr. 6133, datë 20.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga përmbartuesi është kryer pasi veprimet procedurale të Drejtorisë Juridike janë kryer me vonesë, duke sjellë ekzekutimin e vendimit pa ushtruar detyrimin ligjor për ndjekjen e çështjes në të gjitha shkallëve të gjykimit. Për rrjedhojë mosparaqitja në afat e ankimit në Gjykatën e Apelit i ka dhënë mundësi Paditësit të ekzekutojë vendimin. UKT pavarësisht se ka ekzekutuar detyrimin përmbartimor për këtë çështje ka depozituar ne gjykate kërkesë për disponim ankimi dhe kërkesë për rishikim vendimi. Te dy çështje janë në proces në Gjykatën e Apelit.

Në këtë mënyrë, edhe nëse gjykata do të pranojë rishikimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë, kthimi i shumës së ekzekutuar do të ishte me risk, pasi do të duhej një kohë e gjatë nga përfundimi i procesit për rishikimin e vendimit deri në kërkimin e kthimit të shumës me një tjetër padi dhe çështje gjyqësore (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 92- 181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

36.1. Rekomandimi: Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale, ndjekjes me përgjegjësi të gjitha procedurat gjyqësore, me përfaqësim tekniko-juridik me profesionist me eksperiencë për minimizuar dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i vendimeve në jo në favor të Shoqërisë.

Shoqëria “UKT Tiranë” SHA të analizojë vlerësoj çështjen në tërësi, për të zbatuar në mënyrë vullnetare dhe në marrëveshje me subjektin detyrimin e krijuar, si dhe të lidhet kontrata, me qëllim uljen e kostove financiare të cilat mund të krijohen nga vendimi gjyqësor dhe shpenzimet përmbartimore. Në marrëveshje/kontratë të përcaktohen edhe klauzolat në rast të ndryshimit të vendimit gjyqësor duke krijuar garancitë ligjore përkatëse për institucionin.

Menjëherë e në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 36.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

37. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “Ujësjetllës- Kanalizime Tiranë” Sh.a, nuk ka zbatuar dhe realizuar në mënyrë të plotë rekomandimet e KLSH-së të dhëna nga auditimet e mëparshme. Konkretisht janë rekomanduar 9 masa organizative, janë pranuar 9, prej të cilave 5 janë zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht, dhe 3 masa janë në proces zbatimi.

Janë rekomanduar 4 masa për shpërblim dëmi me vlerë totale 603,629 lekë, nga të cilat nuk janë pranuar dhe zbatuar 2 masa në vlerën 218,388 lekë, 1 masë në vlerën 42,000 lekë është pranuar dhe nuk është zbatuar, 1 masë në vlerën 343,241 lekë e cila është zbatuar pjesërisht.

Për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike janë rekomanduar 4 masa në vlerën 11,911,884 lekë, prej të cilave nuk janë pranuar dhe zbatuar

2 masa në vlerën 2,619,880 lekë, janë pranuar 2 masa në vlerën 9,292,000 lekë, të cilat janë zbatuar plotësisht.

Janë rekomanduar 2 masa për dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi me vlerë totale 26,712,000 lekë nga të cilat 1 masë në vlerën 9,110,000 lekë është pranuar dhe zbatuar plotësisht dhe 1 masë në vlerën 17,602,000 lekë është pranuar dhe është në proces zbatimi. Theksojmë se për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera 78,400,727 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 26-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

37.1. Rekomandimi: Nga Shoqëria “Ujësjiellës- Kanalizime Tiranë” Sh.a, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat nga auditimet kanë rezultuar të pazbatuara, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

Menjëherë e në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma B, pika 37.1.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” SHA ushtron veprimtarinë e saj me Seli në adresën Rruga “Kavajës”. Ndërtesa ku është vendosur Selia e UKT SHA është marrë në përdorim/me qira nga pronari i objektit G.J. Ndërtesa 133, kodi postar 1027, Njësia Administrative nr.6, Tiranë, me sipërfaqe truall 2131 m² dhe sipërfaqe ndërtese 2252 m². Vlera e Kontratës është 1.826.320 lekë në muaj.

Për përdorimin e objektit/ndërtesës Shoqëria ka lidhur me qiradhënësin, kontratën e qirasë nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019, kontratë e ndryshuar me kontratën nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021 dhe nr. 5554 rep, nr. 3559 koleksioni, datë 21.09.2022. Për investimet dhe mirëmbajtjen e pronës së marrë me qira, në kontratën e qirasë nr.7 Rep dhe nr.5 Kol, datë 04.01.2019, në nenin 5 “Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit”, pika 5.1, 5.5 dhe 5.8 dhe nenin 8 “Përgjegjësitë e palëve”, janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve me referencë ligjore në nenet 801-825 të Kodit Civil.

Sipas kushteve të kontratës së qirasë të rena dakort nga palët është parashikuar se: Qiramarrësi ka të drejtë, që sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë në qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë (neni 5, pika 5.1) Qiradhënësi nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga qiramarrësi (neni 5, pika 5.5). Nga UKT është shpenzuar vlera 19,000,000 lekë investime në këtë objekt të marr me qira për kamera survejimi etj, nga këto mund të merren në përfundimin e kontratës pajisje survejimi në vlerën 7,755,400 lekë. Referuar kushteve të kontratës së bashku e amendimin, kjo vlerë mbetet për llogari (pronë) të Qiradhënësit. Investimi është kryer në kamera survejimi.

-Në kontratën nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019 nuk është parashikuar nga palët, detyrimi për sigurimin e pronës në rastet e rreziqeve të shkaktuara nga zjarri, rrufetë, tërmeti, stuhitë, përmytjet, shpërthimi ose dëme nga uji, shembje dhe çdo rrezik tjetër të parashikuar nga ligji. Me amendamentin nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021 sigurimi i objektit nga rreziqet është parashikuar si e drejte e Qiradhënësit, po policia e sigurimit nuk është pjesë përbërëse e kontratës, siç përcaktohet në nenin 1, pika 1.5, paragrafi i dytë. Pavarësisht se palët kanë vendosur me vullnet të lirë në kontratë detyrimin e palës Qiradhënëse për sigurimin e pronës objekt i kontratës së qirasë, ky detyrim kontraktual dhe ligjor nuk është përmbushur. UKT SHA në cilësinë e qiramarrësit nuk rezulton të ketë mbajtur komunikim shkresor me qiradhënësin për investimet dhe mirëmbajtjen sipas kushteve të vendosura në kontratë.

Sa i përket sigurimit të pronës nga rreziqet Qiradhënësi nuk ka vënë në dispozicion të Qiramarrësit Policën e sigurimit të objektit nga një shoqëri e licencuar sigurimi. Kontratat e sigurimit rregullohen nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (Kreu XXIII – Sigurimi), Ligji nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Në qershor të vitit 2022 në UKT për shkak shkëndijës elektrike ka rënë zjarr duke krijuar dëm të llogaritur në **vlerën 28,986,607 leke**. Për shkak të mos pasjes së policës së sigurimit nga zjarri kjo vlerë (shpenzim) është përballuar nga UKT, nga këto mund të merren në përfundimin e kontratës pajisje kompjuterike & mobilje në vlerën **11,931,600 lekë**.

Për shkak të mos pasjes së policës së sigurimit nga zjarri kjo vlerë është përballuar nga UKT. Nga sqarimet e kërkuara ne UKT, termi ka të drejtë, nuk është konsideruar si një e drejt detyimore e Qiradhënësit, por si një e drejtë evazive (Polica e sigurimit mund të jetë/ose mund të mos jetë pjesë përbërëse e kontratës).

Referuar doktrinën juridike, kodit civil, në rastin konkret (përmbajta e kontratës) termi ka të drejtë duhet të konsiderohet si një e drejt detyimore e Qiradhënësit, dhe jo si një e drejtë evazive (Polica e sigurimit mund të jetë/ose mund të mos jetë pjesë përbërëse e kontratës). Pra policia e sigurimit duhet të jetë pjesë e kontratës dhe vlera 28,986,607 lekë dhe duhet të likuidohej nga shoqëria e sigurimit.

Nga investimi i kryer në vlerën 47,986,607 lekë respektivisht në vlerat 19,000,000 dhe 28,986,607 leke, pajisjeve survejimi, kompjutera, mobile etj të zhmontueshme janë në vlerën 19,657,000 lekë. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” nenet 801-825 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Organet Drejtuese të Shoqërisë, të marrin masa për të rinegociuar kontratën/marrëveshjen me Qiradhënësin për të bërë amendimet përkatëse me qëllimin e rikuperimit të **vlerës 28,329,607 lekë** për investimet e kryera por të pa kthyeshme (47,986,607 lekë gjithsej-19,657,000 lekë që mund të merren= 28,329,607 lekë), vlerë që t’i mbesë qiradhënësit kundrejt kthimit të shpenzimeve, dhe me të drejtën e marrjes nga “UKT Tiranë” SHA të inventarit ekonomik (pajisjeve kompjuterike, kamera survejimi, mobileri, etj) në vlerën 19,657,000 lekë pas përfundimit të kontratës. Në rast se qiradhënësi nuk do të pranojë këto dy kushte duhet të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e **vlerës 47,986,607 lekë**, ose për diferencë sipas realizimit të kushteve.

Brenda datës 30.06.2023

Komenti i subjektit: Në kohën e investimit të kryer për shkak të zjarrit ambjenti i marrë me qira nga UKT kishte pronar tjetër. Në vazhdimësi ndryshoj pronësia e godinës dhe në përfundim të

kontratës do të negociohet për vlerën e investimit të kryer me pronarin e ri për rikuperimin e vlerës së investuar.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe pa zbatuar*.

2. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “UKT” Tiranë” Sh.a ka lidhur kontratë nr. 10728 prot., datë 12.06.2019 me subjektin K.Q me objekt “Marrja me qira e tokës mbi të cilën është ndërtuar depo uji me vendodhje në Fshatin Surel, njësia administrative Dajt” me sipërfaqe 511.65 m² për përdorim toke. Kohëzgjatja 1 vjeçare me të drejt rinovimi me vlerë qiraje 173,961 lekë në muaj. Në këtë përfshihet tatimi mbi qiranë që do ti mbahet qiradhënësit çdo muaj sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Rrethimi i depos ujit të ujësjellësit (Depo uji, pusëtë dhe objekt të Shërbimit (sistem kamera, manovrator etj) është 401.5 m², sipërfaqe sipas planimetrisë së kontratës është 511 m², diferenca =109.5 m² x 340 lekë m²/muaj =37,230 lekë në muaj x 41.5 muaj (12.06.19 data e lidhjes kontratës deri më 30.11.22 që përfundon auditimi = 1,545,045 lekë përfituar tepër.

Vlera 1,545,045 lekë përbënë dëm ekonomik për Shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” Sha dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga përfituesi. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, nenet 801-825 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i **vlerës 1,545,045 lekë** nga K.Q. Kjo është përfituar padrejtësisht nga qiradhënësi, si pasojë e diferencës ndërmjet planimetrisë së kontratës së qirasë dhe sipërfaqes sipas planimetrisë në fakt.

Brenda datës 30.06.2023

Komenti i subjektit: Me shkresën nr.11395 prot, datë 09.08.2023, është njoftuar Z.Kujtim Qefalia për përmbushjen vullnetare të detyrimit të përcaktuar në Rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Kontrata e qirasë nuk është rinovuar nga data 12.06.2023 dhe nga kjo datë (për shtatë muaj) nuk është kryer asnjë pagesë qiraje për përdorimin e truallit të Z.K.Q dhe në vazhdim. Pasi të rikuperohet vlera e lënë për tu arkëtuar do të bëhet kontrata e re.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar*.

3. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Zhblllokim pusetash”, viti 2022, për vlerën 19,994 mijë lekë, projekt përfshin edhe fond rezervë 5 % në vlerën 952,076 lekë. Ky fond rezervë ka rritur në mënyrë artificiale vlerën e përlllogaritjes, duke rënduar koston e këtij Shoqëria, në vlerë 960,984 lekë, pasi nuk ka të bëjë me punime ndërtimi të ndërtesave por me shërbim, pasi nuk ka projekt të hartuar nga projektues të licencuar, nuk ka të caktuar mbikëqyrës të punimeve, preventivi nuk ka të përcaktuar vlerën e pastrimit të pusetave duke u bazuar në numrin e pusetave x çmimin/puset, vlerën e zhblllokimit të kanaleve kesoni duke u bazuar në numrin/metrat linear x çmimin/kanal etj. Veprim në kundërshtim me Analizat teknike për punimet e ndërtimit të ndërtesave “Ministria e Ndërtimit” maj 1992, Manualin e preventivimit “Udhëzime dhe kritere dhe analiza ndihmëse vëllimi i I (1976-1980).

Vlera 960,984 lekë është përfituar padrejtësisht nga Shoqëria Shoqërisë “O...” Shpk, si pasojë përlllogaritjeve të gabuara dhe përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” Sha dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga kjo Shoqëri, referuar të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655, ku është shprehur në mënyrë eksplite se “përcaktohet se: “Personi që pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet

pasurore që ka pësuar brenda caqeve të begatimit pa shkak” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **960,984 lekë**, nga Shoqëria “O.....” Shpk për shkeljet konstatuara në kontratën me objekt “Zhbllokim pusetash”, viti 2022, për arsye se janë rritur në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht shpenzimet në fazën e hartimit të preventivit dhe të zbatimit të kësaj kontrate, duke rënduar padrejtësisht koston e Shërbimit në vlerën 960,984 lekë, vlerë e cila për Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” Sha dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik. Dëmshpërblimi mbështet në Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655 dhe neni 32.

Brenda datës 30.06.2023

Komenti i subjektit: Me shkresën nr.11394 prot, datë 09.08.2023, është njoftuar shoqëria Onyx shpk për përmbushjen vullnetare të detyrimit të përcaktuar në Rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Me shkresën nr.11394/1 prot, datë 07.09.2023 shoqëria “O...” ka kërkuar vënien në dispozicion të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Me shkresën nr.11394/2 prot, datë 13.09.2023 i është dërguar shoqërisë O.... shpk pjesë nga Raporti përfundimtar i KLSH në të cilën përcaktohen detyrimet që duhet të përmbushen nga kjo shoqëri.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i pa zbatuar*.

4. Gjetje nga auditimi: Në objektin “V.N.” - Depo 4000 m³ në Yzberisht” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UK Tiranë sh.a dhe BOE “B...S” sh.p.k & “E....” sh.p.k me Nr.16975/9Prot datë 19.10.2018 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 184,114,778 lekë pa TVSH ose 220,937,734 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 4 mua, nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezultuan se; në librezat dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt për 3 (tre) zëra punimesh të cilat janë të pa verifikueshme në terren pasi janë punime të maskuara, në shumën 262,100 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3.;- Kontratën e Shërbimit Nr.18824/35 Prot. datë 11.10.2018 me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin, ‘Ndërtim linjë transmetimi ujësjetllës nga rruga ‘Vangjel Noti’ - Depo 4000m³ në Yzberisht”, Neni 7 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e arkëtimin e vlerës **262,100 lekë** pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve BOE “B...S” sh.p.k & “E....” sh.p.k me të cilin është realizuar kontrata Nr.16975/9Prot datë 19.10.2018 për zbatimin e punimeve civile.

Brenda datës 30.06.2023

Komenti i subjektit: Me shkresën nr.11396 prot, datë 09.08.2023, është njoftuar shoqëria BE-IS shpk dhe Ergi shpk për përmbushjen vullnetare të detyrimit të përcaktuar në Rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Me shkresën nr.11396/1 prot, datë 14.08.2023, shoqëria “B...S” ka

kërkuar vënien në dispozicion të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe janë vendosur në dispozicion.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i pa zbatuar*.

5. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Spostim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime, sheshi Shqiponja, Loti 1” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UK Tiranë sh.a dhe OE “S....” sh.p.k me Nr.14332/8Prot datë 22.10.2020 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 227,953,868 lekë pa TVSH ose 273,544,642 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 6 muaj, nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezultuan se; në librezat dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt për 5 (pesë) zëra punimesh të cilat janë të pa verifikueshme në terren pasi janë punime të maskuara, në shumën 10,490,433 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3.; - Kontratën e Shërbimit Nr.15784/10 Prot. datë 22.10.2020 me objekt “Mbikëqyrje të objektit, “Spostim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime, sheshi Shqiponja, Loti 1”, Neni 7 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 10,490,433 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve OE “S....” sh.p.k me të cilin është realizuar kontrata Nr.14332/8Prot datë 22.10.2020 për zbatimin e punimeve civile.

Brenda datës 30.06.2023

Komenti i subjektit: Me shkresën nr.11397 prot, datë 09.08.2023, është njoftuar shoqëria S.... shpk për përmbushjen vullnetare të detyrimit të përcaktuar në Rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Me shkresën nr.11397/1 prot, datë 17.08.2023 shoqëria “S....” ka kërkuar vënien në dispozicion të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Me shkresën nr. 11397/2 prot, datë 12.09.2023 i është dërguar shoqërisë “S....” shpk pjesë nga Raporti përfundimtar i KLSH në të cilën përcaktohen detyrimet që duhet të përmbushen nga kjo shoqëri. Me shkresën nr.1195 prot, datë 04.10.2023 depozituar në UKT sh.a me nr.11397/3 prot, datë 04.10.2023, shoqëria “S....” shpk ka dërguar kundërshtimet e saj lidhur me Rekomandimet e KLSH-së. Me shkresën Nr.6613/2 prot, datë 10.10.2023, UKT sh.a ka dërguar në KLSH, shkresën/observacionin nr.1195 prot, datë 04.10.2023 të shoqërisë S.... shpk.

Meqenëse projekti “Spostim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime, sheshi Shqiponja, Loti 1” mbivendoset me punimet e Unazës së Madhe do të bëhet edhe një herë verifikim i dokumentacionit në dosjen teknike përkatës në bashkëpunim me supervizorin.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar pjesërisht dhe i pa zbatuar*.

6. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion rrjet ujësjellësi Dn-426mm, Dn-200mm në rrugën ‘Xhanfize Keko’” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UK Tiranë sh.a dhe OE “B....” sh.p.k me Nr.10098/2Prot. datë 17.08.2019 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 50,406,959 lekë pa TVSH ose 60,488,350.8 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 30 ditë, nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezultuan se; në librezat dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt për 5 (pesë) zëra punimesh si

diferencë e krahasimit të projektit fillestar dhe atij të propozuar të cilat janë të pa verifikueshme në terren pasi janë punime të maskuara, në shumën 3,064,212 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.; - Kontratën e Shërbimit Nr.10087/42Prot. datë 05.08.2019 me objekt ““Mbikëqyrje të objektit, ‘Rikonstruksion rrjet ujësjellësi Dn-426mm, Dn-200mm në rrugën ‘Xhanfize Keko’, Neni 7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: UK Tiranë të kryej verifikimin e zbatimit të projektit si dhe të llogarisë diferencat midis projektit fillestar dhe atij të propozuar në rast se janë kryer këto ndryshime ku sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion janë në vlerën 3,064,212 lekë pa TVSH e cila deri na këtë fazë konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shoqërisë.

Brenda datës 30.06.2023

Komenti i subjektit: Nga dokumentacioni i dosjes teknike rezultoi se propozimet e kontraktorit nuk janë miratuar nga ana e UKT pasi bashkia nuk pranoi këto ndryshime dhe për rrjedhojë u zbatua projektit fillestar.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

7. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depo Kombinat” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UK Tiranë sh.a dhe BOE “A...” sh.p.k & “V...E” sh.p.k me Nr.9525/14 Prot. datë 07.08.2019 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 63,913,231.36 lekë pa TVSH ose 76,695,877.63 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 3 muaj, nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezultuan se; në librezat dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt për 4 (katër) zëra punimesh të cilat janë të pa verifikueshme në terren pasi janë punime të maskuara, në shumën 776,032 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.;- Kontratën e Shërbimit Nr.10087/59Prot. datë 08.08.2019 me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin, “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depo Kombinat”, Neni 7 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **776,032 lekë** pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve BOE “A....” sh.p.k & “V... E” sh.p.k me të cilin është realizuar kontrata Nr. 9525/14 Prot. datë 07.08.2019 për zbatimin e punimeve civile.

Brenda datës 30.06.2023

Komenti i subjektit: Nga ana e UKT nuk është njoftuar pasi punimet kanë qenë në periudhën e garancisë dhe nuk është likuiduar plotësisht vlera e kontratës. në momentin e çlirimit të garancisë do të mbahet edhe vlera përkatëse.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i pa zbatuar*.

8. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri, Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet i Nxënësive” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UK Tiranë sh.a dhe BOE “K.” sh.p.k & “S.” sh.p.k & “L...” sh.a & “A..T-2..0” sh.p.k me Nr.6068/9 Prot. datë 02.07.2020 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 381,811,507.02 lekë pa TVSH ose 458,173,808.43 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 4 muaj, nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezultuan se; në librezat dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt për 4 (katër) zëra punimesh të cilat janë të pa verifikueshme në terren pasi janë punime të maskuara, në shumën 864,749 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.;- Kontratën e Shërbimit Nr.7904/24Prot. datë 02.07.2020 me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin, “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri , Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet i Nxënësive”, Neni 7 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Të kërkohe në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **864,749 lekë** pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve BOE “K.” sh.p.k & “S.” sh.p.k & “L...” sh.a & “A..T-2..0” me të cilin është realizuar kontrata Nr.6068/9 Prot. datë 02.07.2020 për zbatimin e punimeve civile.

Brenda datës 30.06.2023

Komenti i subjektit: Nga ana e UKT nuk është njoftuar pasi punimet kanë qenë në periudhën e garancisë dhe nuk është likuiduar plotësisht vlera e kontratës. në momentin e çlirimit të garancisë do të mbahet edhe vlera përkatëse.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i pa zbatuar*.

D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICËNCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Në kontratën me objekt “Ndërtim rrjet kanalizimi rruga e Durrësit”, nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konkretisht, projekti fillestar dhe preventivi i marrë për bazë për llogaritjen e fondit limit konstatohet se poshtë tubave të kanalizimeve është vendosur si zë i veçantë nënshtresë zhavorri dhe shtresë beton C7/10. Referuar manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit për vendosjen e tubave B/A me diametra të ndryshëm nënshtresa e zhavorrit dhe shtresa e betonit janë të përfshira në furnizim vendosjen e tyre, kjo e pasqyruar në analizën e çmimit të manualeve teknike. Pra përfshirja e këtyre dy zërave në preventivin fillestar ka rritur fondin limit në vlerën 1,057,792 lekë pa TVSH. Gjithashtu referuar preventivit konstatohet se në të është përfshirë puseta e sistemit të ujësjellësit Nr.2 për ndërtim me vlerë totale 684,186 lekë pa TVSH pasi është e përfshirë edhe në projektin e sistemit të ujësjellësit në rrugën e Durrësit, pra përfshirja në projektin e kanalizimeve rit për llogaritjen e vlerës së fondit limit. **Vlera 1,741,978 lekë** pa TVSH konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të shprehura në nenin 5; VKM Nr.914 datë

29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndryshuar, neni 59 pika 2; dhe VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Shoqëria UK Tiranë të marrë masat e nevojshme për projektet që janë në proces dhe në të ardhmen duke bërë një analizë më të detajuar të llogaritjes së vlerës së fondit limit duke shmangur kështu kostot shtesë të projekteve.

Menjëherë e në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma D, pika 1.1.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

2. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Vangjel Noti” - Depo 4000 m³ në Yzberisht” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UK Tiranë sh.a dhe BOE “B..S” sh.p.k & “E...” sh.p.k me Nr.16975/9Prot datë 19.10.2018 u konstatua se pesha specifike e tubit çelik Ø (1016x8.8 mm) i h/izoluar në fabrikë sipas certifikatës së prodhimit është 10 kg/ml më shumë se ajo e projektuar dhe e kërkuar në specifikimet teknike, kështu që nga llogaritjet ka rritur koston e projektit, për gjithë gjatësinë e tubit 2186.65 ml në vlerën 3,672,480 lekë pa TVSH (21,86 Ton x168,000 lekë/ton), e cila në gjykimin e grupit të auditimit shpenzim i fondeve të shoqërisë pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me parimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të shprehura në nenin 5 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Shoqëria UK Tiranë në bashkëpunim me mbikëqyrësit e punimeve të kryej një kontroll më të detajuar të specifikimeve teknike të kërkuara, të materialeve në realizimin punimeve civile, duke shmangur në këtë mënyrë rritjen e kostove të projekteve në proces dhe atyre që do të zbatohen në vazhdimësi.

Menjëherë e në vijimësi

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma D, pika 2.1 Rekomandimi është në proces vlerësimi.

Komenti i audituesve: Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

E. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Kontratës kolektive nr. 7720/4 prot, datë 16.07.2018, e amenduar me nr. 5166/3 prot,

datë 28.04.2019, neni 22, kontratave individuale të punës neni 13, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë, marrjen/ose jo të masave disiplinore ndaj personelit duke marrë në konsideratë shkeljet ligjore dhe përgjegjësit respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të performancës së punës së tyre.

Komenti i subjektit: Me urdhrin nr.150, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar nga Grupi i Auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Nr.447/13 prot, datë 03.05.2023, protokolluar pranë shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a, me nr.6613 prot, datë 04.05.2023”, Titullari ka ngritur Grupin e punës për marrjen e masave mbi Rekomandimet e lëna në Raportin përfundimtar të KLSH-së. Grupi i Punës ka hartuar Planin e Veprimeve nr.U-150 prot, datë 17.05.2023 që është dërguar në KLSH me shkresën nr.6613/1 prot, datë 18.05.2023. Në bazë të Planit të Veprimeve gërma E, Rekomandimi është në proces vlerësimi.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *i pranuar* dhe *pa zbatuar pasi është akoma në proces vlerësimi*.

4. AUDITIM I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE NË SUBJEKTIN PORTI DETAR SARANDË SHA

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Portin Detar Sarandë sh.a** me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023” për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 – 31.10.2022, të përcjella nga KLSH me shkresën Nr.1080/8Prot. datë 16.06.2023.

Cështjet kryesore që janë trajtuar gjatë auditimit janë verifikimi i hartimit nga subjekti të programeve (plan veprimeve), vlerësimi i ecurisë dhe i nivelit të zbatimit të rekomandimeve, përcaktimi i statusit të tyre, rikërkimi për zbatim i rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimi i punës për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi. Gjithashtu është trajtuar nxjerrja nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

- a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
- b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
- c. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e për të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjekt u mbajt Akt Verifikimi nr. 1, datë 24.01.2024, administruar në Sh.A Porti Detar Sarandë me nr. 69 prot, datë 25.01.2024, për të cilin nuk është paraqitur observacion nga ana e subjektit. Pas dërgimit të Projektraportit të Auditimit, nga ana e subjektit janë paraqitur observacione.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Autoriteti Rrugor Shqiptar ka respektuar këtë afat pasi ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor të përcaktuar shkresën nr.459 prot. datë 10.07.2023.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”. Raportimi është bërë me shkresën nr.750/1 prot. datë 13.12.2023.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr.1080/8 Prot. datë 16.06.2023, janë rekomanduar gjithsej:

a. 9 masa organizative;

b. 4 masa për shpërblim dëmi në vlerën 1,153,112 lekë;

c. 7 masa për përdorimin të fondeve publike jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit në shumën 17,026,481 lekë;

d. masa disiplinore mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, kontratat individuale të punës, ku i është kërkuar Administratorit të SHA “Portit Detar” Sarandë, referuar gjetjeve të auditimit, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe në varësi të tyre të japë masat disiplinore për ata punonjës që atakohen në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr.1080/8 Prot. datë 16.06.2023 dhe në Portin Detar Sarandë me Nr. 253/2 Prot. datë 20.06.2023 statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar (nga PD Sarandë)	Pa pranuar
1	Organizative	9 masa	9 masa	-
2	Shpërblim dëmi	4 masa 1,153,112 lekë	4 masa 1,153,112 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	7 masa 17,026,481 lekë	7 masa 17,026,481 lekë	-
4	Masa Disiplinore	-	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmblëdhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	9 masa	2		7	-
2	Shpërblim dëmi	4 masa 1,153,112 lekë	-	-	4 masa 1,153,112 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	7 masa 17,026,481 lekë			7 masa 17,026,481 lekë	-
4	Masa Disiplinore	1	1	-	-	-
		21	3	0	18	-

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të

rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 1047/1 Prot. datë 29.12.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. S.H, (Përgjegjës grupi)
2. E.K

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr.1080/8 Prot. datë 16.06.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Porti Detar Sarandë sh.a, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr.1080/8Prot. datë 16.06.2023, rezulton se nga 21 masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi dhe 3-E, disiplinore*), janë pranuar nga subjekti 21 masa ose 100 %. Nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 3 masa, ose 14% e tyre, nuk ka masa të zbatuara pjesërisht, janë në proces zbatimi 18 masa ose 86 % e masave të rekomanduara.

Nga sa shikohet niveli i realizimit është në masën 14%, gjë e cila tregon se Porti Detar Sarandë SHA nuk e ka vlerësuar si duhet procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	9 masa	2		7	-
2	Shpërblim dëmi	4 masa 1,153,112 lekë	-	-	4 masa 1,153,112 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	7 masa 17,026,481 lekë			7 masa 17,026,481 lekë	-
4	Masa Disiplinore	1	1	-	-	-
		21	3	0	18	-

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 14%, kurse ai i atyre në proces zbatimi është 86 %, nivele këto të cila tregojnë vlerësimin pjesërisht të këtij procesi si dhe domosdoshmërinë që ka ndjekja e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Autoriteti Rrugor Shqiptar, ka respektuar këtë afat pasi nuk kthyer përgjigje.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit").

-Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të nenit 15 shkronja "j" të ligjit 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së, Sh.A Porti detar Sarandë ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën me nr. 205 datë 26.03.2018 "Informacion për marrjen e masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH" për secilën masë organizative, shpërblim dëmi, është nxjerr urdhër respektiv nga administratori për zbatimin e detyrave të rekomanduara është hartuar plani i veprimit në zbatim të detyrave për ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga KLSH plan i cili është miratuar me vendimin nr. 9 datë 18.05.2018 nga këshilli mbikëqyrës. Në zbatim të pikës "2" neni 30 të ligjit nr.154 viti 2014 "Për Organizimin e KLSH-së", SHA Porti Detar Sarandë, nuk ka kthyer përgjigje pranë KLSH-së mbi zbatimin e rekomandimeve brenda afatit 6 mujor (*Trajtuar më hollësisht në faqen nr.5, pika.1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandim: Administratori i SHA "Porti Detar" Sarandë, të marrë masa që në të ardhmen, të raportohet pranë KLSH-së brenda afateve të përcaktuara mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna sipas përcaktimeve ligjore.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 prot. datë 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot. datë 27.06.2023. Miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 datë 06.07.2023.

Komenti i audituesve: Me shkresën Nr.459 Prot. datë 10.07.2023 është raportuar në KLSH. Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i zbatuar*.

2. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë sintetike "Të drejta të arkëtueshme" në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 43,955,522 lekë, e cila përbëhet nga:

-Gjendja e llogarisë "Klientë" në vlerën 15,493,546 lekë, e cila përbëhet nga 71 klientë të krijuar për më shumë se një vit ku pjesën më të madhe e zënë detyrimet e klientëve në vitet e kaluara prej 10,223,646 lekë.

-Gjendja e llogarisë "Të tjera të arkëtueshme", në fund të vitit 2021 është në vlerën 28,461,979 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se pjesa më e madhe e kërkesave përfaqëson detyrimet e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve për rimbursimin e tatim fitimit të parapaguar në vlerën 5,967,917 lekë, 2,879 lekë ndalesë për diferencë page, në vlerën 13,544,581 lekë, përfaqëson kalimin e fondit nga SHA "Porti Detar" Sarandë, në llogarinë e shoqërisë "Duhan Cigare", Shkodër, si dhe vlerën 8,946,602 lekë, që i përket TVSH-së mbartur për tu rimbursuar prej vitit 2014 e pasqyruar në llog 445 "TVSH për tu marrë". Vlera e llogarisë 445, nga 8,946,602 lekë në fund të vitit 2022 është

rritur me 496,496 lekë. Vlera e TVSH për tu rimbursuar deri në fund të vitit 2022, është 9,433,098 lekë. Me gjithë korrespondencat e vazhdueshme me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Sarandë, kjo vlerë ende nuk është rimbursuar, në kundërshtim me Ligjin 25/2018, datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Ligjin nr. 92/2014, datë 28.08.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 12. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr.52, pika 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori Ekonomik, të marrin masa duke ndjekur procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të të tretëve ndaj shoqërisë, si “Klientë” në vlerën 15,493,546 lekë dhe “të drejtave të tjera të arkëtueshme”, në vlerën 28,461,979 lekë (rimbursim TVSH dhe detyrimi i shoqërisë “Duhan Cigare” Shkodër), me qëllim mbledhjen e të ardhurave dhe përmirësimin e situatës financiare.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 prot. datë 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot. datë 27.06.2023. Miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 datë 06.07.2023.

Komenti i audituesve: Verifikimi i detajuar do të realizohet në auditimin e radhës. Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

3. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2019, me Urdhrin e Brendshëm nr.122, datë 14.12.2020, Drejtori i SHA “Portit Detar” Sarandë, në mbështetje të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 20, datë 11.10.2019 dhe vendimit të Asamblesë nr.17874, datë 15.10.2020, është vendosur shpërndarja e shpërblimit për punonjësit e shoqërisë një pagë mujore pas daljes së rezultatit vjetor të vitit 2019. Drejtoria e Shoqërisë ende nuk ka shpërndarë masën e shpërblimit si pasojë e mbylljes nga Pandemia Covid-19, në kundërshtim me Kodi i Punës, neni 114 - Shpërblimi (ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996) dhe Ligjin nr. 10405 datë 24.03.2011 “Për kompetencat e përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve” neni 6 pika b (Trajtuar më hollësisht në faqen nr.43, pika 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrin masa që shpërndarja e shpërblimeve për punonjësit të kryhet në bazë të rezultatit ekonomik-financiar të shoqërisë, me qëllim motivimin e punonjësve për arritjen e rezultateve pozitive në punë, respektimin e kërkesave të Kodit të Punës duke ndikuar në rritjen e performancës pozitive të treguesve ekonomik-financiar të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 prot. datë 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot. datë 27.06.2023. Miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 date 06.07.2023.

Drejtoria e “Porti Detar” Sh.A Sarandë, për shpërndarjen e shpërblimit te vitit 2019 ka nxjerr urdher nr.300 datë 25.05.2023 për shpërndarjen e shpërblimit për punonjësit e Shoqërisë.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

4. Gjetje nga auditimi: Baza ligjore e përdorur për përcaktimin e niveleve referuese të pagave për pozicionet e punëve mbështetëse nga viti 2018-2022, janë VKM nr. 589, datë 17.07.2013 dhe VKM nr. 717, datë 23.06.2009. Kjo bazë ligjore përdoret për përcaktimin e niveleve referuese të pagave në institucionet buxhetore dhe “Portit Detar” Sha Sarandë, nuk është institucion buxhetor,

pra në këto kushte nuk mund të përdorë lidhjet e përcaktuara në këtë legjislacion, vendimet nuk korrespondojnë me natyrën e shoqërisë.

-Struktura dhe niveli i pagave paraqitet me pozicione pune për 49 të punësuar. Struktura jep të dhëna në vlerë për shtesën për vjetërsi e cila i korrespondon personave të punësuar në shoqëri.

Nga auditimi i kontratave individuale të punës për vitet 2018-2022, rezultoi se nuk janë përcaktuar në kontratë të gjithë elementët përbërës të pagës por vetëm paga bruto e punonjësit.

-Për vitin 2021, janë miratuar 8 punonjës me kontratë të përkohshme (punëtorë sezonal), me pozicion pune sanitare dhe punonjës për sistemim arkive (kërkesë e DPA dhe Forcës së Sigurisë). Punonjësit me kontratë të përkohshme (punëtorë sezonal), nuk janë miratuar me akt të veçantë të Këshillit Mbikëqyrës, por janë miratuar me vendimet e miratimit të Planit të Zhvillimit dhe buxhetit vjetor të shoqërisë. Viti 2021, rezultoi me tejkallim 4-5 punonjës, si pasojë e rekrutimit të punonjësve me kontratë në periudhën e verës.

-Struktura nuk ka të përcaktuar profesionin, megjithëse është kërkuar në formatin e pozicioneve të punës është përcaktuar vetëm për 5 pozicione pune, po kështu edhe struktura e miratuar me vendimin nr.20, datë 28.12.2022, përveç nivelit arsimor nuk pasqyron kërkesat mbi profesionin sipas vendit të punës, niveli arsimor është përcaktuar vetëm për 5 pozicione pune dhe për forcën e sigurisë ku kërkohet sipas udhëzimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin nr. 791 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, neni 21 “Forma e kontratës së Punës”, pika 3, gërma (h) si dhe Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” neni 6, pika 1, gërma (a) si dhe VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes dhe regjistrin të personelit”. (*Trajtuar më hollësisht në faqen nr.43, pika 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë dhe Dega e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, të marrin masa për përcaktimin në strukturë të nivelit arsimor të çdo kategorie punonjësish sipas kërkesave të vendit të punës, me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe realizimin e objektivave të shoqërisë në nivele cilësore.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 prot. datë 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot, datë 27.06.2023. Miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 datë 06.07.2023.

Me vendim nr.17 datë 28.12.2023 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë është miratuar Struktura Organizative e Shoqërisë për vitin 2024 të ku janë përcaktuar niveli arsimor për çdo vend pune.

Komenti i audituesve: Nga auditimi i Struktura Organizative e Shoqërisë për vitin 2024, miratuar me vendimkin nr. 17, datë 28.12.2023 të KMSH, u konstatua se në këtë dokument është përcaktuar niveli arsimor për çdo vend pune, rekomandimi konsiderohet si *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

5. Gjetje nga auditimi: Programi ekonomik dhe financiar i shoqërisë, megjithëse ka ndjekur procedurat dhe afatet përcaktuar në udhëzimin përkatës, nuk ka pasqyruar tregues të harmonizuar mirë midis tyre dhe nuk ka pasur planifikim të saktë të treguesve ekonomikë dhe financiar të bazuar në rezultatet e viteve paraardhëse si edhe në mundësitë reale të shoqërisë.

Investimet për vitin 2018, janë realizuar në masën 72 %, për vitin 2019, janë realizuar në masën 30.8 % dhe për vitin 2020, janë realizuar në masën 73.5 %. Investimet për vitin 2021, nuk janë realizuar megjithëse janë programuar në vlerën 6,200 mijë lekë. Investimet për vitin 2022, janë realizuar në masën 29.7 %, nivel i ulët i realizimit të investimeve flet për punë të pamjaftueshme nga strukturat drejtuese për realizimin e investimeve të programuara. Shoqëria në aspektin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i programit dhe detyrimet e tjera tregtare dhe ato mbështetëse, nuk ka bërë një punë të vlerësueshme në realizimin e tyre, niveli i realizimit të shpenzimeve duhej

ndjekur me përgjegjësi si për zërat me devijime nga plani ashtu edhe për shpenzimet të cilat janë në masën 100% me planifikimin, pasi shpenzimet duhet të kryhen vetëm për qëllime të domosdoshme të aktivitetit, në kundërshtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Programi ekonomik (treguesit e programuar). (Trajtuar më hollësisht në faqen nr.30, pika 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandim: Administratori i SHA "Porti Detar" Sarandë dhe Dega e Programim Investimeve dhe Teknikës, të marrin masa për hartimin e programeve ekonomike bazuar në treguesit e realizuar në vitet e mëparshëm, në mundësitë dhe kapacitetet reale të shoqërisë dhe analizave ekonomike, të nivelit të investimeve, nivelit të shpenzimeve, numrit të punonjësve, etj, zëra të cilët duhen rishikuar dhe analizuar referuar uljes së volumit të punës, pasi shoqëria nuk kryen përpunim mallrash por vetëm pasagjerë, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara për drejtimin e shoqërisë.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 prot. datë 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot. datë 27.06.2023. Miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 date 06.07.2023.

Komenti i audituesve: Nga auditimi i Struktura Organizative e Shoqërisë për vitin 2024, miratuar me vendimkin nr. 17, datë 28.12.2023 të KMSH, u konstatua se në këtë dokument është përcaktuar niveli arsimor për cdo vend pune, rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, rezultoi se Administratori i SHA "Porti Detar" Sarandë, nuk ka ndërmarrë hapa për implementimin në rregulloren e shoqërisë të miratuar me vendimin nr. 6, datë 28.04.2016 të Këshillit Mbikëqyrës, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, ku si parësore është caktimi i nëpunësit autorizues, neni 8, pika 2, si dhe atij zbatues, neni 12. Në shoqërinë Porti Detar SHA Sarandë, nga Administratori i Shoqërisë, nuk është caktuar ende nëpunësi autorizues dhe zbatues, e konstatuar kjo gjetje edhe në auditimet e mëparshme të KLSH-së. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr.102, pika 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandim: Administratori i SHA "Porti Detar" Sarandë, të marrë masat e duhura për implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 prot. datë 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot, datë 27.06.2023. Miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 datë 06.07.2023.

Komenti i audituesve: Nga auditimi i Struktura Organizative e Shoqërisë për vitin 2024, miratuar me vendimkin nr. 17, datë 28.12.2023 të KMSH, u konstatua se në këtë dokument është përcaktuar niveli arsimor për cdo vend pune, rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për inventarizimin për vitet 2018-2022, u konstatua se komisioni për vlerësimin e mallrave jashtë përdorimit përbëhet nga 3 anëtarë dhe komisioni i asgjësimit është i njëjti i përbërë nga 3 anëtarë, ndërsa referuar legjislacionit në fuqi komisioni i vlerësimit duhet të përbëhet nga 5 anëtarë dhe asgjësimit nga 7 anëtarë.

Për vitin 2022 u konstatua se komisioni inventarizimit është i njëjti me komisionin e vitit 2021. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr.62, pika 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandim: Administratori i SHA "Porti Detar" Sarandë, të marrë masa për përcaktimin e drejtë të komisioneve të inventarizimit duke respektuar edhe numrin e tyre sipas legjislacionit në

fuqi, me qëllim arritjen e rezultateve të sakta të inventarizimit dhe pasqyrim të drejtë të rezultateve në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 prot. datë 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot, datë 27.06.2023. Miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 datë 06.07.2023.

Komenti i audituesve: Nga auditimi i Struktura Organizative e Shoqërisë për vitin 2024, miratuar me vendimkin nr. 17, datë 28.12.2023 të KMSH, u konstatua se në këtë dokument është përcaktuar niveli arsimor për cdo vend pune, rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, komisionet e blerjeve të vogla nuk kanë argumentuar nevojën e blerjes së mallrave/materialeve duke mos e krahasuar me sasinë e mallrave në magazinë ose konsumin mesatar mujor. Konkretisht për procedurat me objekte, “Blerje kancelari”, “Blerje goma”, “Blerje veshmbathje”, “Blerje karburant”, “Blerje materiale hidraulike”, “Blerje materiale elektrike”, etj, të zhvilluara për periudhën objekt auditimi, në praktikat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua mungesë dokumentacioni dhe argumentimi lidhur me nevojat reale të SHA Porti Detar Sarandë për sasi të mallrave ose materialeve të prokuruar. Në kërkesat e bëra në hartimin e nevojave, ishte përlllogaritur dhe fondi limit në të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë të vogël. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.84, pika 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, komisionet e prokurimit për blerje të vogla, në të ardhmen të marrin masa që përpara zhvillimit të procedurave me vlera të vogla të argumentojnë dhe dokumentojnë nevojat e materialeve/mallrave që do të prokurohen duke i krahasuar ato me gjendjen aktuale në magazinë konform ligjeve dhe rregullave në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 prot. datë 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot, datë 27.06.2023. Miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 date 06.07.2023.

Komenti i audituesve: Nga auditimi i Struktura Organizative e Shoqërisë për vitin 2024, miratuar me vendimkin nr. 17, datë 28.12.2023 të KMSH, u konstatua se në këtë dokument është përcaktuar niveli arsimor për cdo vend pune, rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

9. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2018-2022, Shoqëria “Porti Detar Sarandë” SHA, ka dhënë me qira një bar-verandë dhe 13 ambiente (zyra) subjekteve private, bazuar në kriteret e përcaktuara në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si dhe nenet 801/825 të Kodit Civil dhe vendimeve të këshillit mbikëqyrës. Për vitin 2018, janë lidhur 8 kontrata qiraje. Për vitin 2019, janë lidhur 11 kontrata qiraje. Për vitin 2020, janë lidhur 5 kontrata qiraje dhe për vitin 2022, janë lidhur 6 kontrata qiraje. Nga auditimi i dosjeve lidhur me procedurat e ndjekura për dhënien e ambienteve me qira tek të tretët, rezultoi se në asnjë dosje nuk gjendet procesverbali ku të përfshihet gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira, sipas llogarive financiare të vitit paraardhës, apo pamje fotografike të momentit. Për dhënien me qira të ambienteve, Porti Detar SHA Sarandë, ka lidhur kontrata qiraje bazuar vetëm tek kërkesa e ardhur nga palët e treta. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.98, pika 9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrë masa që në të ardhmen, të plotësohen dosjet respektive për procedurat e dhënies me qira të ambienteve, me dokumentacionin përkatës, konform ligjeve dhe rregullave në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 prot. datë 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot, datë 27.06.2023. Miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 datë 06.07.2023.

Komenti i audituesve: Nga auditimi i Struktura Organizative e Shoqërisë për vitin 2024, miratuar me vendimkin nr. 17, datë 28.12.2023 të KMSH, u konstatua se në këtë dokument është përcaktuar niveli arsimor për cdo vend pune, rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së zbatimit të punimeve sipas kontratës me objekt “Rikonstruksion i Godinës së Administratës”, datë 22.07.2019 të lidhur midis “N...” SHPK dhe SHA Porti Detar Sarandë, u konstatua se: Afati i ekzekutimit të punimeve, është 30 ditë nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, është me datë 22.07.2019. Me vendimin nr. 1285/1 Prot., datë 26.07.2019, KPP ka dërguar pranë PDS SHA, kërkesën për vënien në dispozicion të dokumentacionit për procedurën e prokurimit të mësipërme. Me shkresën nr. 586 Prot., datë 30.07.2019, Titullari i AK, nxjerr urdhrin e brendshëm për pezullimin e procedurës deri në marrjen e vendimit nga KPP. Me shkresën nr. 671 Prot., datë 13.09.2019, NJP e PDS SHA, vihet në dijeni për vendimin e marrë nga KPP dhe njofton Titullarin e AK për anulimin e pezullimit të procedurës dhe vazhdimin e punimeve. Punimet kanë rifilluar pas ardhjes së përgjigjes nga KPP, pra në datën 18.09.2019, sipas procesverbalit të mbajtur nga Mbikëqyrësi i punimeve. Procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur në datën 13.10.2019. Sa më sipër, nga data 22.07.2019 deri në datën 30.07.2019, janë 9 ditë pune të kryera nga operatori ekonomik “N...” SHPK. Nga data 18.09.2019 deri në datën 13.10.2019, janë 25 ditë pune të kryera nga operatori ekonomik “N...” SHPK. Në total, operatori ekonomik “N...” SHPK, ka punuar 34 ditë pune dhe jo 30 ditë sa është afati i ekzekutimit të kontratës. Pra punimet kanë përfunduar me 4 ditë vonesë. Referuar kontratës së lidhur midis Portit Detar Sarandë SHA dhe operatorit ekonomik “N...” SHPK, asaj me nr. 550 Prot., datë 22.07.2019, tek neni 3 “Kohëzgjatja”, cilësohet se: *“Kontrata do të konsiderohet e përfunduar me kalimin e 30 ditë kalendarike nga dorëzimi i sheshit”*. Nga auditimi i dosjes së zbatimit të punimeve, nuk u konstatua të jetë miratuar midis AK dhe operatorit ekonomik ndonjë amendament kontrate në kuptim të nenit 13 të kontratës së lidhur. Si rezultat, punimet janë ekzekutuar me 4 ditë vonesë dhe në këtë rast duhej të ekzekutohej neni 15 i kontratës *“Penalitet”*. Vlera përfundimtare e punimeve është 1,683,526 lekë. Referuar nenit 15 të kontratës së lidhur, operatorit ekonomik “N...” SHPK, duhej ti mbahej penaliteti për vonesa në ekzekutimin e kontratës në vlerën e kalkuluar sipas formulës $1,683,526 \text{ lekë} \times 4/1000 \times 4 \text{ ditë vonesë}$ ose 269,365 lekë. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.77, pika 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

1.1.Rekomandim: Nga Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori i Financës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **269,365 lekë**, nga “N...” SHPK, si vlerë që i përket penalitetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve ligjore.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 prot. datë 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot. datë 27.06.2023. Miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 datë 06.07.2023. Me shkresën nr.415 prot. datë 27.06.2023 nga drejtori i Portit i është kërkuar Shoqërive “N...” sh.p.k, me NIPT K.... paraqitjen në Portin Detar Sarandë për likuidimin vullnetar të detyrimeve. Porti Detar Sarandë me shkresën nr. 716 prot. datë 13.11.2023 është bërë kërkesë padia në Gjykatën e Rrethi Gjyqësor Sarandë pasi kontraktori nuk ka pranuar rekomandimet e lëna.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në terren lidhur me punimet e kryera, sipas kontratës me nr. 550 Prot., datë 22.07.2019 dhe objekt “*Rikonstruksion i Godinës së Administratës*”, u konstatua se nga “N...” SHPK, nuk është ekzekutuar zëri nr.28, An 2.404/1, “Bojë hidroplastike importi, cilësia e I-rë” me vlerë 361,680 lekë me TVSH. Si rezultat, vlera totale e punimeve të pa kryera është 361,680 lekë. (*Trajtuar më hollësisht në faqen nr.77, pika 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandim: Nga Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori i Financës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **361,680 lekë**, nga “N...” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar dhe likuiduar por të pa kryer nga OE.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 prot. datë 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot. datë 27.06.2023. Miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 date 06.07.2023. Me shkresën nr.415 prot. datë 27.06.2023 nga drejtor i Portit i është kërkuar Shoqërive “N....” sh.p.k, me NIPT K.... paraqitjen në Portin e Detar Sarande për tu njohur me rekomandimet e KLSH-se dhe masat e lëna. Me shkresën nr.456 prot. datë 10.07.2023 nga drejtor i Portit i është kërkuar Shoqërive “N....” sh.p.k, paraqitjen në Portin Detar Sarandë për likuidimin vullnetar të detyrimeve. Porti Detar Sarandë me shkresën nr. 716 prot. datë 13.11.2023 është bërë kërkesë padia në Gjykatën e Rrethi Gjyqësor Sarandë pasi kontraktori nuk ka pranuar rekomandimet e lëna.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së zbatimit të punimeve sipas kontratës me objekt “Kabinë elektrike 20 kV”, datë 21.06.2019 të lidhur midis “A...P” SHPK dhe SHA Porti Detar Sarandë, u konstatua se: Afati i ekzekutimit të punimeve, është 30 ditë nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Nga auditimi në terren i punimeve të kryera, u konstatua se kablli i aluminit AL 20 kV x 240/25mm iz.XLPE, ishte më i shkurtër se gjatësia e deklaruar në situacionin përfundimtar. Nga matja e distancës midis kabinës së montuar brenda ambienteve të Portit Detar SHA Sarandë dhe kabinës së OSHEE të vendosur mbi zonën e Portit, rezultoi se kishte një diferencë 90 metra më tepër të deklaruar në situacionin përfundimtar. E matur në fakt dhe me google-map, distanca është 150 metra linear. Në total janë shtrirë: 150 m (kabëll) x 5 (kablllo)=750 m Kabëll AL 20 kV 1x240/25mm² iz.XLPE dhe jo 840 metra sa deklarohet në situacionin përfundimtar. Si rezultat janë deklaruar 90 metra kabëll më shumë ose në vlerë 90 metra kabëll x 990 lekë/metri = 106,920 lekë me TVSH të deklaruara më shumë në situacionin përfundimtar. Edhe për punëtorinë, janë deklaruar të njëjtat metra me çmim 90 lekë shtrimi i 1 metri linear. Si rezultat 90 metra shtrim * 90 lekë/metri = 9720 lekë me TVSH. Në total, vlera e faturuar më tepër në situacionin përfundimtar dhe që duhet të dëmshpërblehet nga OE “A...P” SHPK, është 116,640 lekë. (*Trajtuar më hollësisht në faqen nr.83, pika 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori i Financës, të kërkojnë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **116,640 lekë**, nga “A...P” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar dhe likuiduar por të pa kryer nga OE.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 date 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot, datë 27.06.2023. Miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 date 06.07.2023. Me shkresën nr.416 prot, datë 27.06.2023 nga drejtor i Portit i është kërkuar Shoqërive “A...P” sh.p.k. me NIPT J6...K paraqitjen në Portin Detar Sarandë për tu njohur me rekomandimet e KLSH-se dhe masat e lëna. Me shkresën nr.456/2 prot, datë 10.07.2023 nga drejtor i Portit i është kërkuar Shoqërisë “A...P” sh.p.k, paraqitjen në Portin Detar Sarandë për likuidimin vullnetar të detyrimeve. Porti Detar Sarandë me shkresën nr. 715 prot. datë 13.11.2023 është bërë kërkesë padia në Gjykatën e Rrethi Gjyqësor Sarandë pasi kontraktori nuk ka pranuar rekomandimet e lëna.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i zbatuar.*

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve me objekt “Ndërtimi i tualeteve në kalatë” sipas kontratës me datë 17.02.2020, të lidhur midis OE “A...P” SHPK dhe Portit Detar SHA Sarandë, u konstatuan mangësi në zëra punimesh dhe konkretisht:

-Punime ndërtimi:

1. Nr. 24, An 2.404/1, Bojë hidroplastike importi cilësi e I-rë, në vlerën 73.905 lekë pa TVSH.
2. Nr. 28, An 2.209, Ulluk shkarkimi me llamarinë xingat në vlerën 1.701 lekë pa TVSH.

-Punime elektrike:

3. Nr. 16, An 2.a-133, Ndriçues elektrik tavanor 1x 18 Ë, copë 5, në vlerën 7.250 lekë pa TVSH.
4. Nr. 22, An, Zëri F.V Aparat matës për EE, elektronik i përdorshëm me kartë në vlerën 150,000 lekë pa TVSH.
5. Nr. 23, An, Zëri Aparat matës për ujin elektronik i përdorshëm me kartë (përfshi lexuesin elektronik) në vlerën 105,000 lekë pa TVSH. Vlera totale e punimeve të pa kryera, është 405,427.2 lekë. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.73, pika 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik dhe Sektori i Financës, të kërkojnë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **405,427 lekë**, nga “A...P” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar dhe likuiduar por të pa kryer nga OE.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 prot. datë 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot, datë 27.06.2023. Miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 date 06.07.2023. Me shkresën nr.416 prot, datë 27.06.2023 nga drejtor i Portit i është kërkuar Shoqërisë “A...P” sh.p.k, me NIPT J....2K paraqitjen në Portin Detar Sarandë për tu njohur me rekomandimet e KLSH-se dhe masat e lëna. Me shkresën nr.456/2 prot. datë 10.07.2023 nga drejtor i Portit i është kërkuar Shoqërisë “A...P” sh.p.k, paraqitjen në Portin Detar Sarandë për likuidimin vullnetar të detyrimeve. Porti Detar Sarandë me shkresën nr. 715 prot, datë 13.11.2023 është bërë kërkesë padia në Gjykatën e Rrethi Gjyqësor Sarandë pasi kontraktori nuk ka pranuar rekomandimet e lëna.

Komenti i audituesve: Nisur nga na më sipër rekomandimi konsiderohet *i pranuar dhe i zbatuar.*

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, është larguar nga puna z. G. Xh., me detyrë prerës biletash ky punonjës ka hapur proces gjyqësor për të cilin është marrë 1 vendim i formës së prerë në vitin 2019, për dëmshpërblim në shumën 556,300 lekë, vlerë e cila përbën efekt negativ financiar për shoqërinë, në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar më hollësisht në faqen nr.43, pika 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës i SHA Portit Detar Sarandë, të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive lidhur me largimet e padrejta nga puna të punonjësve nga Strukturat Drejtuese.

Menjëherë

1.2.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë dhe Dega e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, të marrin masa për rekrutimin e punonjësve bazuar në kërkesat e vendit të punës, me qëllim shmangien e efekteve negative financiare që shkaktohen nga dëmshpërblimi si pasojë e vendimeve gjyqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 prot. datë 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot. datë 27.06.2023.

Miratur nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 datë 06.07.2023.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, konstatohet se nga shoqëria janë paguar në 2 raste gjopa ndaj tatim Taksave në shumën 25,000 lekë, për deklaram të vonuar të vendimit të ortakëve dhe deklarime në QKB, në kundërshtim me Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. (*Trajtuar më hollësisht në faqen nr.84, pika 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë dhe Sektori i Financës, të marrin masa për të deklaruar brenda afateve ligjore detyrimet në QKB, Tatime, etj, me qëllim eliminimin e gjobave në të ardhmen.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 prot. datë 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot. datë 27.06.2023. Miratur nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 datë 06.07.2023.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *i pranuar dhe në proces zbatimi*.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i transfertave të kryera nëpërmjet bankës nga SHA “Porti Detar” Sarandë, u konstatua se nëpërmjet bankës “C.”, janë kryer 3 (tre) transfertat, në favor të shoqërisë “D. C.” Shkodër, në shumën 13,544,581 lekë. Shuma e mësipërme është likuiduar bazuar në 3 (tre) vendime të Asamblesë, si më poshtë:

a) Vendimi i Asamblesë nr.49, datë 19.06.2019 “Për kalim fondi” ku është vendosur kalimi i fondit 1,778,079 lekë, nga shoqëria “Porti Detar” Sarandë në favor të shoqërisë “D. C.” Shkodër. Fondi

do të përdoret për likuidimin e detyrimeve për paga dhe sigurime shoqërore proporcionalisht për 6 punonjës.

b) Vendimi i Asamblesë nr.62, datë 30.07.2019 “Për kalim fondi”, ku është vendosur kalimi i fondit 9,766,502 lekë, nga shoqëria “Porti Detar” Sarandë në favor të shoqërisë “D. C.” Shkodër. Fondi do të përdoret për përballimin e detyrimeve sipas shkresës nr.31, datë 23.07.2017 të Administratores së shoqërisë.

c) Vendimi i Asamblesë nr.3, datë 09.01.2020 “Për kalim fondi”, ku është vendosur kalimi i fondit 2,000,000 lekë, nga shoqëria “Porti Detar” Sarandë në favor të shoqërisë “D. C.” Shkodër. Fondi do të përdoret për likuidimin e detyrimeve për paga dhe sigurime shoqërore deri në muajin Mars 2020.

Referuar Vendimeve të Asamblesë, nga Drejtoria e SHA “Porti Detar” Sarandë, janë nxjerrë Urdhrat e Brendshëm nr.64, datë 24.06.2019, nr.82, datë 08.08.2019 dhe nr.2, datë 14.01.2020 për kalimin e fondit sipas vendimeve të Asamblesë. Në vendimet e Asamblesë citohet baza ligjore neni 102, pika 4, Kushtetuta e Shqipërisë dhe Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “Porti Detar” Sarandë dhe aksionarit mazhoritar të shoqërisë “D. C.” Shkodër.

Transferimi i shumës në favor të shoqërisë “D. C.” Shkodër (në proces likuidimi), është kryer në kundërshtim me Kreun I “Asambleja e Përgjithshme” neni 135, pika 4, të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Statutin e shoqërisë, miratuar në 15.06.2012, Kreu III “Asambleja e Përgjithshme”, neni 11 “Të drejtat dhe detyrimet”, në të cilat nuk ka të përcaktuar transferim fondesh për shpenzime, duke mos marrë në analizë situatën ekonomike të SHA “Porti Detar” Sarandë, e cila në vitet 2020-2021 ka paraqitur vështirësi financiare. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr.52, pika 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, Sektori Juridik në bashkëpunim me Sektorin e Financës, të kërkojnë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (në cilësinë e Aksionarit Mazhoritar), kthimin në llogari të SHA “Porti Detar” Sarandë, të shumës prej **13,544,581 lekë**, shumë kjo e miratuar në mënyrë të kundraligjshme nga Aksionari Mazhoritar dhe përfituar padrejtësisht nga shoqëria “D. C.” Shkodër në vitin 2020, për të likuiduar detyrimet e pagave ndaj punonjësve të saj.

Menjëherë

3.2.Rekomandim: Ministria e Financave, në cilësinë e Aksionarit Mazhoritar të SHA “Porti Detar” Sarandë, të nxjerrë përgjegjësitë, lidhur me efektin financiar negativ të krijuar në buxhetin e SHA “Porti Detar” Sarandë, në shumën prej **13,544,581 lekë**, të konstatuar nga KLSH si pasojë e 3 vendimeve të kundraligjshme, të marra nga Asambleja e SHA “Porti Detar” Sarandë, me qëllim garantimin e zbatimit të ligjshmërisë në përdorimin e fondeve publike.

Menjëherë

3.3.Rekomandim: Ministria e Financave, Drejtoria e Inspektimit Financiar, të ushtrojë kontroll në shoqërinë “D. C.” Shkodër, mbi destinacionin e përdorimit të fondit prej **13,544,581 lekë** dhe përfituesve duke bërë me dije Kontrollin e Lartë të Shtetit, mbi rezultatet e kontrollit nga Drejtoria e Inspektimit Financiar. Gjithashtu, të përcillet në KLSH, edhe lista emërore e përfituesve si dhe pozicionet e tyre përkatëse, në shoqërinë “D. C.” Shkodër.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 prot. datë 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot. datë 27.06.2023. Miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 datë 06.07.2023.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *i pranuar* dhe në *proces zbatimi*.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje materiale të nevojshme për mbrojtje personale dhe higjieno-sanitare për mbrojtje nga Covid-19*” zhvilluar në vitin 2020, me vlerë kontrate 4,920,000 lekë me TVSH, u konstatua se sasi të materialeve për mbrojtjen personale anti Covid, nuk ishin nxjerrë në bazë të nevojave reale të Shoqërisë. Konkretisht, janë kërkuar 5000 copë Maska të thjeshta kirurgjikale, 2500 copë Maska mbrojtëse Kn95 FFP2 dhe 11000 copë Doreza mbrojtëse. Sasi të mësipërme janë të ekzagjeruara krahasuar me nevojat e një stafi të reduktuar por mbi të gjitha edhe për arsye të mos kryerjes së aktivitetit të transportit detar për shkak të situatës të shkaktuar nga Covid-19. Vlera prej 2,925,600 lekë me TVSH që korrespondon me vlerën e materialeve të mësipërme, konsiderohet si vlerë e investuar në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficensës së fondeve publike. Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit, nuk u konstatua dokumentacioni i plotë lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së fondit limit të procedurës. Përlllogaritja e vlerës së fondit limit për procedurën e prokurimit me objektin e mësipërm nuk i referohet mesatares së 3 (tre) ofertave të marra nga tregu por njësisia e prokurimit është bazuar për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit, vetëm tek 1 (një) ofertë ekonomike. (*Trajtuar më hollësisht në faqen nr.66, pika 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1.Rekomandim: Administratori i SHA “Porti Detar” Sarandë, të marrë masat që në të ardhmen në procedurat e prokurimit, njësisia e prokurimit ti referohet minimumi tre ofertave të tregut dhe në të njëjtën kohë, të argumentohet dhe dokumentohet nevoja e sasive të mallrave që do të prokurohen, duke i krahasuar ato me të dhënat reale të Shoqërisë me qëllim shmangien e investimeve me pasoja negative financiare për shoqërinë.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Është hartuar Programi i Masave nr.459/1 prot. datë 10.07.2023 për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.414 prot. datë 27.06.2023. Miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nr. 7 datë 06.07.2023.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *i pranuar* dhe në *proces zbatimi*.

E. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, kontratat individuale të punës, kërkojmë nga Administratori i SHA “Portit Detar” Sarandë, referuar gjetjeve të auditimit, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe në varësi të tyre të japë masat disiplinore për ata punonjës që atakohen në këtë Raport Auditimi.

Komenti i subjektit: Drejtori i Shoqërisë me vendim nr. 6, datë 26.07.2023 ka dhënë masa disiplinore, *tërheqje vëmendje*, për të gjithë personat e përmendur në Raportin Përfundimtar të Rekomandimeve dhe masat e lëna te KLSH-së. Konkretisht për punonjësit ; K.B, L.E, K. S, D. K, T. T, F.J, S.A.

Komenti i audituesve: Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

1. SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SHA

Në përfundim të procesit të auditimit, KLSH ka dërguar në subjektin Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA, rekomandimet e auditimit me shkresën Nr.825/15 Prot., datë 03.05.2023. Subjekti ka vijuar procesin e zbatimit të rekomandimeve, situata e të cilave, pas përfundimit të auditimit të zbatimit të rekomandimeve, në mënyrë të përmbledhur është si vijon:

Nga 28 masa të rekomanduara në total (organizative, shpërblim dëmi, 3-E, disiplinore), janë pranuar në masën 100 %, prej të cilave janë zbatuar plotësisht 17 masa, ose 61% e tyre, janë zbatuar pjesërisht tre masa ose 11 %, janë në proces zbatimi pesë masa ose 18 % dhe nuk janë zbatuar tre masa ose 10% e tyre.

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga KLSH i janë rekomanduar subjektit Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime, Durrës SHA 10 masa organizative, të cilat janë pranuar 100%.

Prej tyre është zbatuar plotësisht 1 masë, janë në proces zbatimi 3 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa, nuk janë zbatuar 3 masa organizative.

Nga KLSH kërkohet që Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime SHA Durrës të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si vijon:

1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë UK Durrës SHA, të marrë të gjitha masat për të ngritur një sistem eficient të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, krijimin e regjistrit të riskut dhe funksionimin e grupit të menaxhimit strategjik.

Hartuesit e programit ekonomiko-financiar duhet të mbështeten në analiza të plota me bazë risku si edhe të orientuar nga prioritetet të përcaktuara më parë, me qëllim evidentimin dhe korrigjimin e shkaqeve që ndikojnë në mosrealizimin e objektivave të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Rekomandimi: Shoqëria të marrë masa për njoftimin e KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, me qëllim përmirësimin e funksionimit të shoqërisë.

Në vijimësi

3. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë ose personi i autorizuar dhe personi përgjegjës i prokurimeve, të marrin të gjitha masat që në hartimin e regjistrit të prokurimeve të parashikohen të gjitha procedurat e blerjes së mallrave, punëve dhe shërbimeve, që do të prokurohen në vlerë të vogël, me qëllim që të shmangë përdorimin e paplanifikuar dhe të parregulluar të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë UK Durrës SHA të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë, në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike, në lidhje me km e përshkruara të automjeteve dhe vitin e prodhimit si dhe për komisionin e marrjes në dorëzim të mallit në lidhje me makinën teknologjike APV, që rezultoi të jetë me timon në krahë të djathtë.

Menjëherë

5. Rekomandimi: UK Durrës SHA në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Rekomandimi: UK Durrës SHA në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, përmbajtjen e tij duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapurndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Në vijimësi

2. AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Në përfundim të procesit të auditimit, KLSH ka dërguar në subjektin Autoriteti Rrugor Shqiptar rekomandimet e auditimi me shkresën Nr.1201/19 Prot. datë 02.08.2023. Subjekti ka vijuar procesin e zbatimit të rekomandimeve, situata e të cilave, pas përfundimit të auditimit të zbatimit të rekomandimeve, në mënyrë të përmbledhur është si vijon:

Nga 36 masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi, 3-E, disiplinore*), janë pranuar nga subjekti 36 masa, ose në masën 100 %. Nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 14 masa, ose 39 % e tyre, janë në proces zbatimi 17 masa ose 47 % dhe nuk janë zbatuar 5 masa ose 14% e masave të rekomanduara.

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga KLSH i janë rekomanduar subjektit Autoriteti Rrugor Shqiptar 29 masa organizative, të cilat janë pranuar 100%.

Prej tyre janë zbatuar plotësisht 10 masa, janë në proces zbatimi 15 masa, nuk janë zbatuar 4 masa organizative.

Nga KLSH ri kërkohet që për masat organizative, Autoriteti Rrugor Shqiptar të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara, si vijon:

1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive Rajonale të marrin masa lidhur me ndjekjen e hapave ligjorë të menjëhershëm për regjistrimin e pasurive të paluajtshme në ZVRPP/ ASHK, me qëllim pajisjen me dokumentacionin e plotë hipotekor.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, në cilësinë e nëpunësit autorizues, të marrë të gjitha masat e nevojshme për rishikimin e rregullores së brendshme, në të cilën të përfshihen me detaje proceset kryesore të veprimtarisë së ARRSH dhe me këtë rast, veprimtaritë e domosdoshme parandaluese të kontrollit. Gjithashtu, të marrë të gjitha masat e nevojshme për funksionimin e një sistemi të shëndoshë financiar dhe të kontrollit, duke siguruar menaxhimin sistematik të risqeve që cenojnë veprimtarinë e ARRSH, si edhe funksionimin sistematik dhe të nevojshëm të grupit të menaxhimit strategjik (GMS).

Në vijimësi

3 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, të marrë të gjitha masat e nevojshme për krijimin dhe funksionimin e marrëveshjes me ministrinë e linjës MEI, për administrimin e programit “*Transporti Rrugor*”, me qëllim përcaktimin e përgjegjësive përkatëse menaxheriale të secilit institucion pjesëmarrës.

Në vijimësi

4. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, të marrë të gjitha masat e nevojshme për kalimin e auditit të brendshëm jashtë strukturës ekzekutive të ARRSH, me qëllim sigurimin e funksionit të decentralizuar të auditimit të brendshëm, si një veprimtari e pavarur funksionalisht dhe që raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Bordi.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga KLSH i është rekomanduar subjektit Autoriteti Rrugor Shqiptar 1 masë shpërblim dëmi, e cila është pranuar pjesërisht dhe është e pa zbatuar.

Nga KLSH ri kërkohet që për një masë për shpërblim dëmi të pa zbatuar, Autoriteti Rrugor Shqiptar të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të kësaj mase, si vijon:

1. Rekomandimi: ARRSH në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës **12,131,741 lekë pa TVSH** që përbën dëm ekonomik, në situacionet pasardhës deri në atë përfundimtar, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve OE "A..B..", me të cilin është lidhur kontrata nr. 1130 prot. datë 03.02.2021 për zbatimin e punimeve.

Menjëherë

2.1. AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR PËR PROJEKTIN “MIRËMBAJTJE DHE SIGURI RRUGORE BAZUAR NË REZULTATE”.

Në përfundim të procesit të auditimit, KLSH ka dërguar në subjektin Autoriteti Rrugor Shqiptar rekomandimet e auditimit me shkresën Nr.827/19 prot. datë 02.06.2023. Subjekti ka vijuar procesin e zbatimit të rekomandimeve, situata e të cilave, pas përfundimit të auditimit të zbatimit të rekomandimeve, në mënyrë të përmbledhur është si vijon:

Nga **16** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi, 3-E, disiplinore*), janë pranuar nga subjekti në masën 100 %. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, janë zbatuar pjesërisht 2 masa ose 13 % e tyre, janë në proces zbatimi 12 masa ose 75 % e tyre dhe nuk janë zbatuar 2 masa ose 12 %.

Nga KLSH kërkohet që Autoriteti Rrugor Shqiptar të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të 2 rekomandimeve të pa zbatuara për shpërblim dëmi, si vijon:

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Rekomandimi: ARRSH të marri masa, për arkëtimin e shumës 35,600 Euro pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “I..E S.r.l & S.. S.p.a & S.. S.p.a” me të cilin është lidhur kontrata Nr. 9999 Prot. datë 05.12.02016, për monitorimin dhe konsulencën e katër kontratave të mirëmbajtjes.

Menjëherë

2. Rekomandimi: ARRSH të marri masa, për arkëtimin e shumës 33,360 Euro pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “I..E S.r.l & S.. S.p.a & S.. S.p.a” me të cilin është lidhur kontrata Nr. 9999 Prot. datë 05.12.02016, për monitorimin dhe konsulencën e katër kontratave të mirëmbajtjes.

Menjëherë

3. UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SHA

Në përfundim të procesit të auditimit, KLSH ka dërguar në subjektin Ujësjellës Kanalizime SHA Tiranë, rekomandimet e auditimi me shkresën Nr.447/13 Prot. datë 03.05.2023. Subjekti ka vijuar procesin e zbatimit të rekomandimeve, situata e të cilave, pas përfundimit të auditimit të zbatimit të rekomandimeve, në mënyrë të përmbledhur është si vijon:

Nga 53 masa të rekomanduara (organizative, shpërblim dëmi dhe 3-E, disiplinore), janë pranuar nga subjekti 52 masa ose 98 %. Nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 18 masa, ose 35 % e tyre, është zbatuar pjesërisht 1 masë ose 2%, janë në proces zbatimi 27 masa ose 52 % dhe nuk janë zbatuar 6 masa ose 11%.

Nga KLSH ri kërkohet Ujësjellës Kanalizime SHA Tiranë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Rekomandimi: UK Tiranë të ngrejë një grup pune me specialist të fushës, i cili të kryej një verifikim më të detajuar të dosjes teknike në bashkëpunim me supervisorin për kontratën Nr.14332/8Prot datë 22.10.2020 për zbatimin e punimeve civile, pasi ky projekt mbivendoset me punimet e Unazës së Madhe, duke analizuar volumet për zërat e konstatuara gjatë auditimit dhe vlerësimin e tyre. Në përfundim të kryerjes së këtij procesi të njoftojë KLSH për konkluzionet e këtij verifikimi.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Rekomandimi: Organet Drejtuese të Shoqërisë, të marrin masa për të rinegociuar kontratën/marrëveshjen me qiradhënësin për të bërë amendimet përkatëse me qëllimin e rikuperimit të vlerës **28,329,607** lekë për investimet e kryera por të pa kthyeshme (47,986,607 lekë gjithsej-19,657,000 lekë që mund të merren= 28,329,607 lekë), vlerë që t'i mbesë qiradhënësit kundrejt kthimit të shpenzimeve, dhe me të drejtën e marrjes nga "UKT Tiranë" SHA të inventarit ekonomik (pajisjeve kompjuterike, kamera survejimi, mobileri, etj) në vlerën 19,657,000 lekë pas përfundimit të kontratës. Në rast se qiradhënësi nuk do të pranojë këto dy kushte duhet të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **47,986,607 lekë**, ose për diferencë sipas realizimit të kushteve.

Në vijimësi

2. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **960,984 lekë**, nga Shoqëria "O..." Shpk për shkeljet konstatuara në kontratën me objekt "Zhblllokim pusetash", viti 2022, për arsye se janë rritur në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht shpenzimet në fazën e hartimit të preventivit dhe të zbatimit të kësaj kontrate, duke rënduar padrejtësisht koston e shërbimit në vlerën 960,984 lekë, vlerë e cila për Shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime Tiranë" Sha dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik. Dëmshpërblimi mbështet në Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 655 dhe neni 32.

Menjëherë

3. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **262,100 lekë** pa TVSH nga

sipërmarrësi i punimeve BOE "B..S" sh.p.k & "E..." sh.p.k me të cilin është realizuar kontrata Nr.16975/9Prot datë 19.10.2018 për zbatimin e punimeve civile.

Menjëherë

4. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **776,032 lekë** pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve BOE "A..." sh.p.k & "V... E" sh.p.k me të cilin është realizuar kontrata Nr. 9525/14 Prot. datë 07.08.2019 për zbatimin e punimeve civile.

Menjëherë

5. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **864,749 lekë** pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve BOE "K..." sh.p.k & "S...j" sh.p.k & "L..." sh.a & "A.T 2..0" sh.p.k me të cilin është realizuar kontrata Nr.6068/9 Prot. datë 02.07.2020 për zbatimin e punimeve civile.

6. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **1,545,045 lekë** nga K. Q. Kjo është përfituar padrejtësisht nga qiradhënësi, si pasojë e diferencës ndërmjet planimetrisë së kontratës së qirasë dhe sipërfaqes sipas planimetrisë në fakt.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, Kontratës kolektive nr. 7720/4 prot, datë 16.07.2018, e amenduar me nr. 5166/3 prot, datë 28.04.2019, neni 22, kontratave individuale të punës neni 13, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë, marrjen/ose jo të masave disiplinore ndaj personelit duke marrë në konsideratë shkeljet ligjore dhe përgjegjësit respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të performancës së punës së tyre e cila deri në përfundim të auditimit për zbatimin e rekomandimeve nuk ishte kryer.

4. PORTI DETAR SARANDË SHA

Në përfundim të procesit të auditimit, nga Porti Detar Sarandë ShA për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, paraqitur me shkresën Nr.1080/8 Prot. datë 16.06.2023 (*administruar në subjekt me Nr. 253/2 Prot. datë 20.06.2023*), konstatohet se rekomandimet janë pranuar në masën 100%, prej të cilave janë zbatuar plotësisht 3 masa, ose 14% e tyre, nuk ka masa të zbatuara pjesërisht, janë në proces zbatimi 18 masa ose 86 % e masave të rekomanduara.

Përsa më sipër **rikërkojmë** përshpejtimin e punës për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi, sipas raportit përfundimtar të auditimit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ANEKSE

Aneksi 1. Shoqëria Rajonal Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr. %	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	10	-	10	-	-	-	100	-	1	-	3	-	3	-	-	-	3	-	-	-
2	Masa shpërblim dëmi	3	790.6	3	790.6	-	-	100	790.6	2	385.7	-	-	1	404.9	-	-	-	-	-	-
3	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	4	30,789.5	7	30,789.5	-	-	100	30,789.5	3	29,389.6	-	-	1	1,339.8	-	-	-	-	-	-
	Nga të cilat pa kontabilizuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
4	Masa Disiplinore	11	-	11	-	-	-	100	-	11	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
5	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
TOTALI		28	-	28	31,580.1	-	-	100	31,580.1	17	29,775.3	3	-	5	1,744.7	-	-	3	-	-	-

Pasqyra e Masave Organizative

Nr	Rekomanduar		Pa pranuar		Pranuar		Nga të pranuarat							
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
							Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	10	-	-	-	10	-	1	-	3	-	3	-	-	3

Pasqyra e Masave Shpërblim Dëmi

Në 000/lekë

Nr. Rekomandimesh	Emri shkelësit	Vlera Rekomanduar lekë	Pranuar	Nuk pranohen nga subjekti	Nga të pranuarat						
					Zbatuar		Në proces		Mbetja	Pa zbatuar	Në proces gjyqësor
					Nr/datë	Vlerë	Nr/Datë	Vlera			
3	-	790.6	790.6	-	2	385.7	1	404.9	-	-	-

Aneksi 2. Autoriteti Rrugor Shqiptar

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr. %	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	29	-	29	-	-	-	100	-	11	-	-	-	15	-	-	-	4	-	-	-
2	Masa shpërblim dëmi	1	12,131.7	1	12,131.7	-	-	100	12,131.7	-	-	-	-	-	-	-	-	1	12,131.7	-	-
3	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	5	477,246	5	477,246	-	-	100	477,246	3	384,839	-	-	2	92,407	-	-	-	-	-	-
4	Masa Disiplinore	1	-	1	-	-	-	100	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI		36	489,377.8	36	489,377.8	-	-	100	489,377.8	15	384,389	-	-	17	92,407	-	-	5	12,131.7	-	-

Pasqyra e Masave Organizative

Nr	Rekomanduar		Pa pranuar		Pranuar		Nga të pranuarat							
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
							Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	29	-	-	-	29	-	11	-	-	-	15	-	-	3

Pasqyra e Masave Shpërblim Dëmi

Në 000/lekë

Nr. Rekomandimesh	Emri shkelësit	Vlera Rekomanduar lekë	Pranuar	Nuk pranohen nga subjekti	Nga të pranuarat							
					Zbatuar		Në proces		Mbetja	Pa zbatuar	Në proces gjyqësor	
					Nr/datë	Vlerë	Nr/Datë	Vlera				Vlera
1	-	12,131.7	12,131.7	-	-	-	-	-	-	-	12,131.7	-

Aneksi 3. ARrSh Projekti "Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate"

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në Euro

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuar												
		Nr.	Vlera Euro	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr. %	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq		
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	
1	Masa organizative	12	-	12	-	-	-	100	-	-	-	-	-	12	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Masa shpërblim dëmi	2	68,960	2	68,960	-	-	100	68,960	-	-	-	-	-	-	-	-	2	68,960	-	-	
3	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	2	783,875	2	783,875	-	-	100	783,875	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
	Nga të cilat pa kontabilizuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
4	Masa Disiplinore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
5	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
TOTALI		16	-	16	842,835	-	-	100	842,835	-	-	-	-	12	783,875	-	-	2	68,960	-	-	

Pasqyra e Masave Organizative

Nr	Rekomanduar		Pa pranuar		Pranuar		Nga të pranuarat							
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
							Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	10	-	-	-	10	-	-	-	-	-	12	-	2	-

Pasqyra e Masave Shpërblim Dëmi

Në Euro

Nr. Rekomandimesh	Emri shkelësit	Vlera Rekomanduar lekë	Pranuar	Nuk pranohen nga subjekti	Nga të pranuarat							
					Zbatuar		Në proces		Mbetja	Pa zbatuar	Në proces gjyqësor	
					Nr/datë	Vlerë	Nr/Datë	Vlera				Vlera
2	-	68,960	68,960	-	-	-	-	-	-	-	68,960	-

Aneksi 4. Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuar												
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr. %	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq		
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	
1	Masa organizative	42	-	42	-	-	-	100	-	17	-	-	-	25	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Masa shpërblim dëmi	8	65,932	7	55,441.7	1	10,490.4	87.5	55,441.7	1	3,064.2	1	1,545	-	-	-	-	5	50,832.5	-	-	
3	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	2	5,415.4	2	5,415.4	-	-	100	5,415.4	-	-	-	-	2	5,415.4	-	-	-	-	-	-	
	Nga të cilat pa kontabilizuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
4	Masa Disiplinore	1	-	1	-	-	-	100	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	
5	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
TOTALI		53	71,347	52	60,856.2	-	-	98	60,856.2	18	3,064.2	1	1,545	27	5,415.4	-	-	6	50,832.5	-	-	

Pasqyra e Masave Organizative

Nr	Rekomanduar		Pa pranuar		Pranuar		Nga të pranuarat							
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
							Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	42	-	-	-	42	-	17	-	-	-	25	-	-	-

Pasqyra e Masave Shpërblim Dëmi

Në 000/lekë

Nr. Rekomandimesh	Emri shkelësit	Vlera Rekomanduar lekë	Pranuar	Nuk pranohen nga subjekti	Nga të pranuarat						
					Zbatuar		Në proces		Mbetja	Pa zbatuar	Në proces gjyqësor
					Nr/datë	Vlerë	Nr/Datë	Vlera			
8	-	65,932	55,441.7	10,490.4	1	3,064.2	1	1,545	-	50,832.5	

Aneksi 5. Porti Detar Sartandë Sh.A

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr. %	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtu ar	Mbetja	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	9	-	9	-	-	-	100	-	2	-	-	-	7	-	-	-	-	-	-	-
2	Masa shpërblim dëmi	4	1,153.1	4	1,153.1	-	-	100	1,153.1	4	1,153.1	-	-	-	-	-	-	-	-	4	1,153.1
3	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	7	17,026.5	7	17,026.5	-	-	100	17,026.5	-	-	-	-	7	17,026.5	-	-	-	-	-	-
	Nga të cilat pa kontabilizuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Masa Disiplinore	1	-	1	-	-	-	100	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI		21	18,179.6	21	18,179.6	-	-	100	18,179.6	7	1,153.1	-	-	14	17,026.5	-	-	-	-	4	1,153.1

Pasqyra e Masave Organizative

Nr	Rekomanduar		Pa pranuar		Pranuar		Nga të pranuarat							
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
							Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	9	-	-	-	9	-	2	-	-	-	7	-	-	-

Pasqyra e Masave Shpërblim Dëmi

Në 000/lekë

Nr. Rekomandimesh	Emri shkelësit	Vlera Rekomanduar lekë	Pranuar	Nuk pranohen nga subjekti	Nga të pranuarat							
					Zbatuar		Në proces		Mbetja	Pa zbatuar	Në proces gjyqësor	
					Nr/datë	Vlerë	Nr/Datë	Vlera				Vlera
4	-	1,153.1	1,153.1	-	-	1,153.1	-	-	-	-	-	1,153.1